

15 QERSHOR 2026

HEJZA



295512788

Buron Kaceli, piktor

**PIKTUROJ GJURMËN
QË BOTA LË NË SHPIRT**

hejza.com

KISHA NJË DËSHIRË, TË DESHIFROJA ERRËSIRËN QË MË KAFSHONTE SHPIRTIN



Arsyeja e vetme pse ekziston letërsia është sepse për krijuesin është i pamjaftueshëm realiteti, pavarësisht se çfarë realiteti është ai, ashtu siç është e pamjaftueshme edhe jeta me tërë kompleksitetin që ajo ka. Unë shkruaj poezi për t'u mbrojtur nga jeta, nga dhimbjet që më shkakton ajo; shkruaj sepse nuk më pëlqen realiteti. Meqë nuk mund ta ndryshoj atë, atëherë përpigem të mbrohem nga ai përmes artit, përmes

poezisë. Periudha nëpër të cilën po kalojmë aktualisht ne si popull, ka nevojë për vështrimin kritik të poetit, realiteti ynë ka nevojë të shohë imazhin e vet në poezi. Ata që mendojnë se janë poetë, por që qëndrojnë në margjina të jetës së njeriut apo të kombit, me plot bindje them se të njëjtit ende nuk e kanë kuptuar se çfarë është poezia.

(Nga intervista botuar post-hum në HEJZA, 1 prill, 2023)

TIPAT E HESHTJES DHE TË QËNDRIMIT



Problemi nuk është sa intelektualë kemi, por çfarë lloj intelektualësh kemi. Sepse numri nuk garanton cilësi, as titulli nuk garanton karakter. Një shoqëri mund të ketë universitete të mbushura dhe të jetë ende e varfër në mendim

Avni HALIMI

Në hapësirën shqiptare, një nga keqkuptimet më të mëdha publike ka qenë trajtimi i intelektualit si një kategori e paprekshme, homogjene dhe pothuajse mitike. Mjaftonte një diplomë, një titull akademik, një pozitë universitare apo një prani e vazhdueshme në jetën publike, dhe njeriu vendosej automatikisht në raftin e intelektualëve, pa kaluar nëpër filtrin më të rëndësishëm: atë të përgjegjësisë morale dhe të funksionit shoqëror. Kështu, për dekada me radhë, në të njëjtin kosh u futën mendimtari dhe përsëritësi, krijuesi dhe imituesi, njeriu i qëndrimit dhe njeriu i servilizmit, intelektual i mirë-

filltë dhe mediokri i dekoruar me tituj. Ky barazim artificial nuk ishte gabim terminologjik, por, simptomë e një çrregullimi më të thellë kulturor. Një shoqëri që nuk di të dallojë intelektualin nga imituesi i tij, rrezikon ta humbasë vetë aftësinë për të ndërtuar orientim moral dhe kritik. Sepse intelektual i nuk është vetëm prodhues dijesh; ai është, ose duhet të jetë, një pikë orientimi në kohë konfuzioni. Dhe kur orientimi ngatërrohet me zhurmën, shoqëria mbetet pa busull.

Institucionet tona nacionale rrallëherë janë marrë seriozisht me analizimin e intelektualit si figurë publike dhe me tipologjinë e tij. Është folur shumë për arsimin, për akademitë, për universi-

HEJZA

tetet, për diplomat dhe për gradat, por shumë pak për karakterin intelektual. Është harruar se dija, në vetvete, nuk e prodhon automatikisht intelektualin. Dija mund të prodhojë specialistë, teknikë, funksionarë të zotë, madje edhe manipulues të sofistikuar. Intelektuali lind vetëm aty ku dijes i shtohet vetëdija morale dhe përgjegjësia publike. Bota e qytetëruar e ka kuptuar herët këtë dallim. Për këtë arsye, ajo nuk e ka trajtuar intelektualin si një figurë uniforme, por ka ndërtuar tipologji të qarta, duke u mbështetur kryesisht në dy kriteret themelore. Kriteri i parë lidhet me sistemin e vlerave: me bindjet, me besimin, me raportin ndaj së vërtetës, me mënyrën e veprimit dhe me guximin moral. Kriteri i dytë lidhet me fushën e angazhimit: me lëndën me të cilën merret intelektual, me mënyrën si ai e prodhon dijen dhe me raportin që ndërton me botën përmes kësaj dijeje.

Kjo tipologji nuk ka funksion katalogues, por analitik. Ajo nuk synon të fusë njerëzit në kuti të ngurta, por të ndihmojë në kuptimin e strukturës së tyre morale dhe publike. Sepse nuk ekziston një intelektual "i pastër", i ndarë në mënyrë absolute nga të tjerët. Te çdo intelektual mund të gjenden elemente të tipeve të ndryshme. Një njeri mund të jetë kritik në një rrethanë dhe konformist në një tjetër; mund të ketë bindje të forta dhe njëkohësisht dobësi pragmatike. Por gjithsesi, zakonisht ekziston një bosht dominues që e përcakton fytyrën e tij publike. Intelektuali i mirëfilltë është ai që nuk e sheh dijen si pronë personale, por si detyrim etik. Ai nuk interesohet vetëm për prodhimin e asaj që krijon, por edhe për pasojën morale të asaj krijimtari. Ai nuk shkruan vetëm për të qenë i lexuar, por për të qenë i vërtetë. Nuk mendon vetëm për të ndërtuar famë, por për të ruajtur integritetin. Në këtë kuptim, intelektual i vërtetë është gjithmonë një njeri i shqetësimit, jo i rehatisë. Ai nuk përshtatet lehtë me padrejtësinë, sepse ndërgjegjja e tij nuk e lejon komoditetin e



heshtjes. Fuqia e njohurive të tij nuk matet me sasinë e informacionit, por me kulturën morale që e mbështet atë dije. Sepse njohuria pa etikë prodhon vetëm teknikë pa shpirt. Dhe teknika, kur shpëputet nga përgjegjësia, mund të bëhet po aq e rrezikshme sa injoranca.

Pikërisht mbi këtë bazë mund të flasim për tipat e intelektualëve që përcaktohen nga vlerat dhe nga mënyra e veprimit. Këtu shfaqet intelektual kritik, ai që nuk e sheh mendimin si dekor, por si mjet për të sfiduar padrejtësinë dhe për të vënë në pyetje pushtetin. Ai është i pakëndshëm për sistemin, sepse nuk pranon të jetë pjesë e skenografisë së miratimit publik. Pranë tij qëndron intelektual luftëtar, ose revolucionar, i cili nuk mjaftohet me kritikën teorike, por e sheh veten si pjesë aktive të ndryshimit historik. Ai shpesh rrezikon të kalojë

nga mendimi në dogmë, por pa dyshim mbetet figurë e angazhimit të fortë. Në anën tjetër gjendet intelektual i partiak, ai që mendimin e vendos në shërbim të strukturës politike. Për të, e vërteta nuk është kategori morale, por pozicion organizativ. Ai nuk pyet çfarë është e drejtë, por çfarë i shërben vijës së grupit. Ky tip është veçanërisht i përhapur në shoqëritë tona, ku shpesh universiteti dhe partia kanë ndarë të njëjtën tavolinë.

Po aq i pranishëm është intelektual i konformist, figura më e heshtur dhe më e rrezikshme. Ai nuk bën zhurmë, nuk polemizon, nuk rrezikon. E quan këtë maturi, por shpesh është vetëm frikë e rafinuar. Ai e ka kthyer heshtjen në strategji dhe neutralitetin në mbijetesë. Pastaj vjen intelektual i pragmatik, i cili e mat çdo qëndrim me leverdinë që prodhon. Ai nuk ka domosdoshmërisht mungesë inteligjence, por mungesë boshti. Për të, parimi është i vlefshëm vetëm për aq sa nuk pengon interesin personal. Një figurë tjetër është intelektual i salloneve, ai që jeton më shumë në estetikën e pranisë sesa në substancën e mendimit. Ai është i dukshëm, i artikuluar, i pranishëm në çdo panel, por shpesh mungon aty ku kërkohet qëndrim real. Ai e ka kthyer dijen në elegancë sociale dhe mendimin në aksesor prestigji. Po kështu, ekziston edhe intelektual i nacionalist, i cili raportin me kombin e ka bosht identitar dhe moral. Në formën e tij më të lartë, ai është mbrojtës i dinjitetit kolektiv; në formën e tij të deformuar, ai mund të rrëshqasë në retorikë boshe dhe folklor politik.

Krahas kësaj ndarjeje sipas vlerave, ekziston edhe tipologjia sipas fushës së dijes. Këtu dallohen, në mënyrë të përgjithshme, intelektualët humanistë dhe ata shkencorë-technikë. Të parët merren me njeriun, historinë, gjuhën, filozofinë, artin dhe etikën; ata ndërtojnë kuptim dhe interpretojnë botën morale të shoqërisë. Të dytët merren me strukturat teknike të realitetit: shkencën, matematikën, teknologjinë, sistemet e matshme dhe funksionale. Asnjëri nuk është më i rëndësishëm se tjetri. Një shoqëri e shëndetshme ka nevojë për të dy. Por kriza fillon kur specialisti teknik paraqitet si autoritet moral pa e pasur atë formim, ose kur humanisti kërkon të sundojë realitetin pa disiplinën e faktit. Problemi nuk është fusha, por vetëdija për kufijtë dhe përgjegjësitë e saj.

Në përgjithësi, problemi nuk është sa intelektualë kemi, por çfarë lloj intelektualësh kemi. Sepse numri nuk garanton cilësi, as titulli nuk



garanton karakter. Një shoqëri mund të ketë universitete të mbushura dhe të jetë ende e varfër në mendim. Mund të ketë akademi dhe të jetë ende e zbrazët në moral publik. Intelektuali nuk provohet në qetësi, por në çastin kur e vërteta bëhet e pakëndshme. Aty ndahet mendimtari nga funksionari i dijes. Aty shihet kush e ka dijen si mision dhe kush si dekor. Dhe ndoshta, pikërisht aty fillon nevoja jonë më e madhe: jo të prodhojmë më shumë tituj, por të dallojmë më qartë karakterin. Sepse shoqëritë nuk shpëtohen nga shumë intelektualë, por nga ata pak që nuk pranojnë ta shesin ndërgjegjen si pragmatizëm. Kohëve të fundit, po na shfaqet edhe rimorkio me intelektualë të dekoruar nga do shoqata matrapazësh e demagogësh që marrin për detyrë dhe mision imponimin e demagogëve si dhe të analfabetëve funksionalë si "vlerë kombëtare".

FJALA E BUKUR SI URË BASHKËPUNIMI

Në kemi nevojë për ura mirëkuptimi dhe bashkëpunimi që i rezistojnë kohës. Ndërtimin e tyre e ndihmon edhe fjala e bukur artistike, e cila nuk njeh kufij

Neviana SHEHI / ITALI

Përvoja ka treguar se letërsia jo vetëm që është një mjet i fuqishëm komunikimi mes popujve dhe kulturave të ndryshme, por edhe një urë e fortë mirëkuptimi, duke afuar njerëzit dhe duke ndihmuar në shkëmbimin e vlerave shpirtërore e kulturore.

Një shembull i rëndësishëm i këtij bashkëpunimi kulturor që ka një histori të gjatë e të pasur është edhe lidhja midis shkrimtarëve shqiptarë dhe italianë. Duhet theksuar se Shqipëria dhe Italia janë dy vende fqinje, të lidhura jo vetëm nga afërsia gjeografike, por edhe nga marrëdhëniet historike, kulturore dhe artistike.

Një ndër figurat më të njohura të letërsisë arbëreshe, Jeronim De Rada, duke jetuar në truallin italian, me angazhimin e tij të jashtëzakonshëm ndihmoi në forcimin e identitetit kombëtar shqiptar. Ai ndërthuri elemente të kulturës shqiptare dhe italiane, duke dëshmuar se letërsia mund të bashkojë dy botë të ndryshme në një harmoni të vetme artistike. Përmes veprave të tij, De Rada u bë një urë lidhëse mes dy popujve.

Natyrisht, edhe në kohët e tanishme ky bashkëpunimi, pra mes shqiptarëve dhe italianëve, vazhdon të jetë i rëndësishëm. Projektet e ndryshme të përbashkëta kanë forcuar e forcojnë edhe më shumë këtë bashkëpunim. Këto aktivitete krijojnë mundësi që autorët të shkëmbejnë ide, përvoja dhe vizione artistike, duke ndikuar në pasurimin e letërsisë së të dy vendeve.

Së fundi na erdhi edhe një vepër që është fryt i bashkëpunimit shqiptaro - italian. Bëhet fjalë për antologjinë poetike me poetë shqiptarë dhe italianë të titulluar VARGJE RREZATUESE/ VERSI IRRADIANTI, e cila u përgatit nga bashkautorët Valbona Jakova dhe Anitta Di Mineo. Kjo vepër natyrisht se ka sa domethënie të rëndësishme aq



edhe simbolike, sepse është një përpjekje konkrete për forcimin e lidhjeve shpirtërore mes dy popujve.

Projektet e këtilla mund dhe duhet të realizohen edhe në vendet tjera ku jetojnë e veprojnë shqiptarët: në Gjermani, Zvicër, Britani të Madhe, në Shtetet Skandinave, në Holandë, Belgjikë, në shtet përtej Atlantikut etj., ku gjithsesi ka pasur dhe ka bashkëpunime të tilla, por të cilat, për arsye të ndryshme do të duhet të intensifikohen sa më shumë e që realisht, për brezat e rinj (shqiptarë), do të ishin nxitje për t'u mos u zbehur identiteti kombëtar.

Nxjerrja në pah e vlerave tona shpirtërore është një impuls jo vetëm për të na njohur bota, por edhe për ta njohur veten brezat e rinj, të cilët fatkeqësisht, rrallë e më rrallë, e ndjejnë pasurinë shpirtërore të atdheut të prindërve të tyre.

Në kemi nevojë për ura mirëkuptimi dhe bashkëpunimi që i rezistojnë kohës. Ndërtimin e tyre e ndihmon edhe fjala e bukur artistike, e cila nuk njeh kufij. Këtë me projektin e tyre e dëshmuar edhe Valbona Jakova e Anitta Di Mineo.

DESTIMULIMI I DRAMËS SHQIPE NGA TEATROT SHQIPTARE!

Destimulimi i dramës shqipe nga teatrot shqiptare, sidomos në Maqedoninë e Veriut, nuk është rezultat i një shkaku të vetëm, por i një sërë faktorëve: mungesës së besimit, mungesës së mbështetjes, mungesës së bashkëpunimit dhe mungesës së kritikës

Shkëlzen HALIMI

Teatri është një nga format më të gjalla të artit. Është një hapësirë ku fjala, trupi dhe emocioni bashkohen për të pasqyruar realitetin shoqëror. Kur bëhet fjalë për teatrin, në kontekstin shqiptar, vihet re një dukuri shqetësuese: teatrot shpesh nuk e mbështesin, madje aktualisht e dekurajojnë dramën shqipe. Kjo sjell një varfërim të zërit artistik kombëtar dhe ngre shumë pyetje mbi rolin e këtij institucioni kulturore, por edhe më gjerë.

Një nga arsyet kryesore ka të bëjë me mungesën e besimit të dramaturgët shqiptarë bashkëkohorë. Edhe drejtuesit e teatrove në Maqedoninë e Veriut, tashmë kanë betonuar një praktikë të përçudnuar dhe në skenë vënë vetëm vepra të huaja ose ato klasike të njohura botërisht, duke i konsideruar më të sigurta për sukses.

Është e qartë se në këtë drejtim mungon bashkëpunimi mes dramaturgëve dhe regjisorëve. Kur regjisorët nuk janë të hapur ndaj teksteve të reja, atëherë drama shqipe mbetet vetëm në letër, pa asçfarë mundësie të komunikojë me publikun. Ndaj dhe shtrohet pyetja: a kanë nevojë teatrot shqiptare në Maqedoninë e Veriut për dramën shqipe dhe kush është ai që vendos për ngjitjen e teksteve në skenë? Ose pse në teatrot maqedonase gjendja është e kundërt: dominojnë tekstet e autorëve maqedonas?

Habit qetësia e komunitetit të aktorëve, të cilët duket se janë bërë vetëm zbatues të devotshëm të dëshirave të drejtorëve e regjisorëve për ta mbaj-



tur sa më larg dramën shqipe. Ata, pra aktorët, nuk ndjejnë asnjë "presion të brendshëm" për ta promovuar dramën shqipe. Të jemi të qartë, tashmë kemi një realitet tjetër dhe publiku shqiptar gjithnjë e më pak provokohet me autorët e huaj, sepse dramat e Shekspirit, Ibzenit, Brehtit e shumë të tjerëve, mund t'i shijojë sa herë që të ketë nevojë e të dojë (të interpretuar në skena të ndryshme botërore), bie fjala, në platformën youtube.

Destimulimi i dramës shqipe nga teatrot shqiptare, sidomos në Maqedoninë e Veriut, nuk është rezultat i një shkaku të vetëm, por i një sërë faktorëve: mungesës së besimit, mungesës së mbështetjes, mungesës së bashkëpunimit dhe mungesës së kritikës.

Gjendja do të kthehet në binaret e vërteta vetëm nëse imponohet një qasje e re, e cila në qendër e vendos krijuesin shqiptar dhe e sheh dramën shqipe si një pasuri të kulturës, artit dhe letërsisë tonë. Vetëm kështu teatri shqiptar mund të bëhet një pasqyrë autentike e shoqërisë shqiptare.

PIKTUROJ GJURMËN QË BOTA LË NË SHPIRT



Ka artistë që pikturojnë botën siç duket dhe artistë që pikturojnë gjurmën që ajo lë në shpirt. Kujtesa e transformon realitetin në përjetim, ndërsa piktura lind pikërisht në atë hapësirë ku koha, emocioni dhe heshtja bëhen një, shprehet Mjeshtri i Madh, Kaceli.

Avni HALIMI

Në historinë e artit shqiptar ka familje që nuk kanë prodhuar thjesht artistë, por kanë ndërtuar vetë një traditë të të menduarit dhe të të parit estetikisht botën. Njëra prej tyre është familja Kaceli, emër që lidhet ngushtë me themelimin e pikturës moderne shqiptare dhe me formësimin e një gjuhe vizuale që ka shoqëruar dekada të tëra të historisë kulturore të vendit. Në këtë vazhdimësi, figura e Buron Kaceli shfaqet jo vetëm si trashëgimtar i një emri të madh, por si një zë që ka kërkuar gradualisht të ndërtojë indi-

vidualitetin e vet brenda një hapësire ku kujtesa dhe ndikimi janë të pashmangshëm.

I formuar në një mjedis ku arti nuk ishte vetëm profesion, por mënyrë jetese, Buron Kaceli u rrit në një studio ku prania e babait të tij, Sadik Kaceli, ishte njëkohësisht shkollë e parë, referencë estetike dhe horizont i vazhdueshëm dialogu. Në vend që të qëndronte vetëm si figurë autoritare e së kaluarës, studioja familjare u shndërrua në një hapësirë të gjallë të transmetimit të disiplinës, të përkushtimit ndaj ngjyrës dhe të një etike të fortë pune artistike.

Në këtë kontekst, rruga e Buron Kacelit nuk mund të lexohet vetëm si biografi individuale, por si një proces i gjatë negociimi mes trashëgimisë dhe nevojës për vetë-përcaktim. Piktura e tij, e ndërtuar kryesisht mbi gjuhën figurative, peizazhin dhe motivet e jetës shqiptare, ruan një lidhje të dukshme me traditën e pikturës klasike, por njëkohësisht përpiket të artikulojë një ndjeshmëri personale, më intime dhe më reflektuese ndaj kohës dhe kujtesës.


Ekspozitat e tij në Shqipëri dhe jashtë vendit e kanë vendosur Kacelin në një dialog të vazhdueshëm me historinë e pikturës shqiptare, por edhe me pyetjen më të gjerë mbi fatin e artit figurativ në kohën bashkëkohore, ku imazhi digital, koncepti dhe eksperimentimi vizual shpesh e sfidojnë telajon tradicionale. Në këtë tension ndërmjet vazhdimësisë dhe ndryshimit, ndërmjet trashëgimisë dhe individualitetit, vendoset edhe vetë kuptimi i punës së tij artistike.

Pikërisht mbi këto shtresa - mbi kujtesën familjare, mbi studion si hapësirë formimi, mbi raportin me një emër të madh të artit shqiptar dhe mbi përpjekjen për të ndërtuar një zë të vetin në pikturë - HEJZA zhvillon këtë bisedë me Buron Kacelin. Një intervistë që nuk synon vetëm të rrëfejë një rrugë artistike, por të hyjë në mënyrën se si trashëgimia bëhet përvojë e brendshme krijuese dhe si arti vazhdon të jetë një dialog i hapur midis kohës, kujtesës dhe individualitetit.

HEJZA: Ka studio që janë thjesht vende pune dhe ka studio që mbajnë brenda tyre kohë, kujtesë dhe frymëmarrje artistike të disa brezave. Në muret e tyre nuk qëndrojnë vetëm tablo, por edhe heshtje, ndikime, ngjyra të trashëguara dhe dialog të pashqiptuar ndërmjet brezave të artit. Në raste të tilla, artisti nuk hyn vetëm në studio për të punuar, por edhe për të bashkëjetuar me një kujtesë krijuese që vazhdon të jetë e pranishme. Si e keni përjetuar ju studion e të madhit Sadik Kaceli: si hapësirë pune, si trashëgimi shpirtërore apo si një dialog të pandërprerë me artin dhe kohën?

BURON KACELI: Për mua studioja e Sadik Kacelit nuk ka qenë kurrë vetëm një vend pune. Ajo ka qenë një prani e gjallë shpirtërore dhe artistike. Në atë hapësirë nuk ndodheshin vetëm telajo, ngjyra dhe penela, por edhe një mënyrë të menduarit, një etikë pune dhe një trashëgimi krijuese që ndihej vazhdimisht.

Që në fëmijëri e kam përjetuar atë studio si një univers më vete. Drita që hynte aty, aroma e



ngjyrave dhe vajrave, heshtjet e gjata gjatë punës - të gjitha këto krijojnë ndjesinë se arti nuk ishte thjesht profesion, por një mënyrë jetese.

Me kalimin e viteve kam kuptuar se trashëgimia më e madhe nuk janë vetëm veprat, por fryma krijuese që mbetet në një studio të tillë. Edhe sot, kur punoj, shpesh e gjej veten në një dialog të heshtur me kohën, me kujtesën dhe me atë disiplinë artistike që ai përfaqësonte.

Atë studio nuk e kam përjetuar thjesht e vetëm si një hapësirë pune, por si organizëm të gjallë kujtese artistike. Aty bashkëjetonin koha, heshtja, puna dhe prania e një brezi që vazhdon të komunikojë përmes artit.

HEJZA: Jo rrallë ndodh që trashëgimia artistike të jetë njëkohësisht edhe dhuratë, edhe sprovë. Të rritesh pranë një personaliteti të madh të artit do të thotë të hysh herët në botën e ngjyrës, të studios dhe të disiplinës krijuese, por edhe të jetosh nën praninë e vazhdueshme të një emri që tashmë i përket historisë së artit. Në këto raste, artisti duhet të ndërtojë jo vetëm veprën e vet, por edhe mënyrën se si do ta dallojë zërin e tij nga jehona e trashëgimisë që e ka formuar. Si e keni përjetuar ju faktin e të qenit biri i Sadik Kacelit, i një prej themeluesve të pikturës shqiptare?

BURON KACELI: Sigurisht me shumë fat. Kaceli për mua ishte babai im i dashur, shoku im, si dhe pedagogu kryesor i imi. Si baba kujdesej të



formonte tek unë njeriun. Që të bëhesh artist, më përsëriste, duhet më parë të jesh njeri. Me njeri kishte parasysh tërësinë e vlerave më të mira morale.

Si shok i imi ndihesha shumë i lirshëm të bise-doja me tim atë, jo vetëm probleme që lidheshin me artin dhe kulturën, por çdo lloj teme të jetës. Si pedagog, kam pas fatin të kisha njërin prej burrave më të kulturuar të kohës, që në vogëli ruaj kujtime nga miqtë e tij të mëdhenj, si Lasgush Poradeci, Pashko Gjeçi, Ramadan Sokoli, Ali Asllani, Dhimitër Pilika, etj.

Në studion e tij kam pas fatin të ndihem pranë shumë artistëve, ndër ta edhe të huaj, si piktori i shquar japonez, Inosuke Hazama, apo piktori belg që shquhej në vendin e tij për portretin si gjini dhe natyrën e qetë, Leo Van Droogenbroeck.

Kaceli, si nxënës i Shkollës Superiore të Arteve të Bukura të Parisit, ku u vlerësua me dy medalje ari dhe një argjendi, pati fatin të kishte si pedagog nxënësin e Gustav Moreau, Fernand Sabatte. Fernand Sabatte ishte bashkënxënës me Henri Matisse, Albert Marquet, Georges Rouault, i të madhit artist, simbolistit dhe neoklasikut të fundit francez Gustave Moreau.

Gustave Moreau me të drejtë shquhet si një pedagog i madh, sepse nxënësit e tij të lartpërmendur u bënë të gjithë të mëdhenj në art dhe me individualitetin e tyre artistik, ndonëse Moreau vetë bënte një pikturë neoklasike, kurse nxënësit e tij zhvilluan artin modern krejt ndryshe nga ai dhe secili sipas individualitetit të tij.

Unë kam pas fatin të edukohesha artistikisht falë kësaj pedagogjie, si nxënësi i nxënësit të nxënësit të Moreau. Asnjëherë im atë nuk ma mori penelin për të më demonstruar se si duhet të pikturoja. Gjithmonë më stimulonte edhe në ndonjë punë të zakonshme timen kur gjente diçka që kishte të bënte me mua, me natyrën time duke bërë që të arrija të flisja me gjuhën time në pikturë.

Unë mendoj që ruaj shumë nga trashëgimia artistike e babait të cilën e vlerësoj mjaft, siç besoj, gjë që ma vënë në dukje edhe të tjerët, kam dhe reflektoj natyrën dhe kërkesat individuale në pikturë.

HEJZA: Në art, ndikimet më të forta nuk janë gjithmonë ato që artisti dëshiron t'i shmangë. Ka ndikime që bëhen pjesë e kujtesës estetike dhe të



ndjekin natyrshëm në mënyrën e të parit, të ndierit dhe të ndërtimit të figurës. Megjithatë, çdo artist përpiqet të arrijë çastin kur zëri i tij fillon të dëgjohet veçmas. Ku mendoni se mbaron ndikimi i Sadik Kacelit në pikturën tuaj dhe ku fillon Buron Kaceli si individualitet artistik?

BURON KACELI: Artisti i madh, skulptori Antoine Bourdelle, kur u pyet nga pedagogu i tij, Rodini i madh, se pse mu largove, iu përgjigj se, nën hijen e një lisi të madh nuk mund të rritet veç se një manushaqe. T'i shmangesh ndikimit të një mjeshtri të madh, duke qenë vazhdimisht pranë tij, si në rastin tim me tim atë, nuk është e lehtë. Dëshiroj të them se ndikimi i tij vazhdon ende tek unë, por falë pedagogjisë së tij, dhe po ashtu edhe falë natyrës sime, ndryshe nga e tij; ai me një qetësi proverbiale, e unë me natyrën e një temperament ku qetësia vjen e shkon shpesh por nuk më qëndron gjatë. Ajo që vazhdon të më mbajë pranë tij është poezia dhe një farë lirizmi, karakteristike e artit të tij, dashuria për natyrën, çka është trashëguar tek unë dhe besimi i tij i

madh, që ma përsëriste shpesh: "Sensibilite et sincerite" (Ndjeshmëri dhe sinqeritet), që ishte një ndër mësimet më të rëndësishme të pedagogut të tij Fernand Sabatte.

HEJZA: Arti figurativ ka kaluar përmes shumë krizave gjatë shekullit XX dhe XXI. Ajo është sfiduar nga arti konceptual, instalacioni, performanca dhe teknologjitë e reja vizuale. Megjithatë, edhe në epokën e digjitalizimit, piktura vazhdon të mbijetojë sikur të mbartë ende një nevojë të thellë njerëzore për figurën, ngjyrën dhe heshtjen e telajos. Çfarë mendoni se vazhdon ta mbajë gjallë artin figurativ sot?

BURON KACELI: Mendoj se çdo epokë sjell forma të reja shprehjeje dhe kjo është normale. Arti konceptual, instalacioni, apo teknologjitë vizuale kanë zgjeruar mënyrën se si njeriu komunikon artistikisht. Por arti figurativ vazhdon të jetojë, sepse ai lidhet drejtpërdrejt me nevojën e njeriut për të parë veten, tjetrin dhe botën në formë të ndjeshme dhe të prekshme. Arti figura-



tiv mbijeton sepse njeriu ka nevojë të njohë veten në figurë, në dritë dhe në emocion. Moda artistike ndryshon, por nevoja njerëzore për ndjeshmëri mbetet.

HEJZA: Në shumë vepra të krijuesve shqiptarë ndihet një lidhje e fortë me tokën, peizazhin, fytyrën njerëzore dhe kujtesën etnografike. Sikur

piktura të mos ishte vetëm akt estetik, por edhe mënyrë për të ruajtur një botë që po largohet ngadalë nga koha moderne. A mendoni se piktura shqiptare vazhdon të mbajë ende një mision kujtuese?

BURON KACELI: Mendoj që piktura nuk ka qenë dhe nuk është thjesht dhe vetëm një akt estetik. Unë besoj se kujtesa është e pranishme në çdo

vepër arti. Piktura është rezultat i jetës që ka bërë artisti, i asaj që ka parë, ka dashur, ka humbur apo ka admiruar. Të gjitha këto ruhen në nënvetëdije dhe herët a vonë gjejnë rrugën për tu shfaqur në tela. Prandaj edhe kur piktori nuk synon të dokumentojë një epokë apo traditë, ai përsëri bëhet dëshmitar i kohës së vet, sepse kujtesa e jetuar është gjithmonë pjesë e krijimit. Ne artistët shqiptarë aktualisht, në këto kohë ndryshimesh të shpejta ndjejmë edhe si detyrë që përmes veprave tona të trajtojmë edhe fenomene, ngjarje, peizazhe historike, kostume kombëtare që po rrezikohen të zhduken, gjë që është jo thjesht një akt estetik, por edhe një mision kujtese.

HEJZA: Sot arti sikur po prodhohet me ritëm më të shpejtë dhe po konsumohet po aq shpejt. Ekspozitat kalojnë, imazhet qarkullojnë në rrjete sociale dhe publiku lëviz vazhdimisht nga një përvojë vizuale te tjetra. Në këtë lëvizje të pandërprerë, duket sikur po humbet koha e soditjes së qetë dhe e marrëdhënies intime me veprën. A mendoni se publiku i sotëm di ende të "qëndrojë" përballë një pikturë?

BURON KACELI: Mendoj që nuk janë të shumtë ato që dinë të qëndrojnë gjatë para një veprë arti, në intimitet dhe në një komunikim të brendshëm. Jo vetëm lidhur me pikturën por edhe me gjinitë dhe llojet e tjera të artit.

Jeta ka marrë një përshpejtim të jashtëzakonshëm, gjë që arti e ka ndjekur dhe e ka stimuluar atë. Inteligjenca artificiale, robotika dhe zhvillimet teknologjike po ndryshojnë jo vetëm mënyrën si jetojmë, por edhe mënyrën si mendojmë dhe komunikojmë.

Në këtë periudhë tranzicioni, drejt një epoke të re, edhe komunikimi përmes artit do të ndryshojë. Ashtu si çdo kohë ka parë poetët, kompozitorët, piktorët e saj, edhe kjo epokë do të ketë zërat e vet. Arti duket sikur po kalon një periudhë kërkimesh intensive, ku eksperimentimi shpesh është më i dukshëm se sa shfaqja e një vizioni të ri të madh.

Epokat e reja nuk lindin njëherazi me kryeveprat e tyre. Fillimisht lind konfuzioni, pastaj kërkimi, dhe më vonë shfaqen veprat që na bëjnë të kuptojmë se një epokë e re ka filluar. Veprat e reja që do të shfaqen në këtë kuadër do të jenë të tilla, që do të bëjnë njeriun të qëndrojë, të komunikojë e të dialogojë shpirtërisht me veprat e kësaj epoke të re. Një farë largimi nga emocioni i drejtpërdrejtë njerëzor nuk do të mund të mbijetojë. Arti i ndryshon vazhdimisht format e tij, por mbetet i lidhur me njeriun, kujtesën dhe nevojën për t'i

dhënë kuptim përvojës njerëzore. Përfundimisht dëshiroj të them, që për të komunikuar me veprat e artit duhet një farë përgatitje kulturore për të cilën politikat shtetërore për kulturën duhet të bëjnë shumë më tepër. Artet pamore janë "memece", por ato flasin dhe komunikojnë fuqishëm. Duhet të edukohemi për tu mirëkuptuar me to.

HEJZA: Arti bashkëkohor sikur më shumë po e kërkon konceptin, ndërsa piktura vazhdon të mbështetet shumë te ndjeshmëria dhe përjetimi vizual. Në disa raste krijohet përshtypja sikur emocionit estetik po i kërkohet të justifikohet teorikisht për të qenë "modern". A mendoni se arti i sotëm po largohet gradualisht nga emocioni i drejtpërdrejtë njerëzor?

BURON KACELI: Nuk besoj se arti duhet të vendosë konceptin kundër emocionit. Historikisht të dyja kanë qenë pjesë e krijimit artistik, vetëm se në periudha të ndryshme pesha e tyre ka ndryshuar. Arti mund të jetë i thellë në mendim, por nuk duhet të humbasë aftësinë për të prekur; kur humbet emocionin, rrezikon të mbetet vetëm ide; kur humbet mendimin rrezikon të mbetet vetëm efekt. Arti më i qëndrueshëm sipas meje, është ai që i bashkon të dyja.

Arti i sotëm, nganjëherë duket se po i beson më shumë shpjegimit se sa përjetimit. Pë mua, një vepër e madhe është ajo që të prek fillimisht si njeri dhe vetëm më pas të fton të mendosh si kritik. Arti përpara se të jetë teori, është përjetim njerëzor.

HEJZA: Ka artistë që pikturojnë botën dhe ka të tjerë që duket sikur pikturojnë kujtesën e saj. Në veprat tuaja shpesh ndihet një atmosferë lirike, një qetësi që të jep përshtypjen e kohës së ngadalësuar, pothuaj si përpjekje për ta shpëtuar çastin nga zhdukja. Çfarë raporti keni ju me kujtesën në pikturë?

BURON KACELI: Mendoj se piktura ime lëviz midis botës reale dhe kujtesës së saj. Unë nuk përpiqem të riprodhoj atë që shoh, por atë që koha ka lënë brenda meje nga ajo pamje, nga ai njeri, apo nga ajo atmosferë. Kujtesa për mua nuk është arkiv; është emocion i mbijetuar. Ka artistë që pikturojnë botën siç duket, dhe artistë që pikturojnë gjurmën që ajo le në shpirt. Mendoj që i përkas këtij të dytit. Kujtesa e transformon realitetin në përjetim, dhe piktura lind po aty.

HEJZA: Në historinë e artit shqiptar, brezi i Sadik Kacelit mbartte edhe një lloj misioni kul-

HEJZA

turor kombëtar: ndërtimin e identitetit estetik të një vendi të vogël dhe të izoluar. Ndërsa sot artisti jeton në një botë krejt tjetër, më globale, më të hapur dhe njëkohësisht më të fragmentuar. Si e shihni ndryshimin ndërmjet rolit që kishte artisti dikur dhe rolit që ka sot?

BURON KACELI: Brezi i Sadik Kacelit dhe artistëve të atij formimi kishte ndjesinë e të pasurit të një përgjegjësie kulturore kombëtare. Artisti i asaj kohe nuk ishte vetëm një krijues individual; në një mënyrë ai ndjehej edhe përfaqësues i një kulture dhe i një shoqërie. Kjo i jepte artistit një dimension më kolektiv dhe më përfaqësues. Sot bota është krejt tjetër. Artisti jeton në një realitet global, ku kufijtë kulturorë janë më të hapur dhe ku individit ka më shumë liri për të zgjedhur gjuhën e vet artistike. Kjo është një pasuri, por, njëkohësisht kjo sjell edhe fragmentim, shpejtësi dhe ndonjëherë humbje të qendrës shpirtërore. Ndryshimi më i madh është se dikur artisti kërkonte të ndërtonte një identitet kolektiv, ndërsa sot ai shpesh kërkon të mbrojë individualitetin e vet brenda një bote shumë të zhurmshme.

Megjithatë, pavarësisht kohëve të ndryshme, besoj se arti i vërtetë mbetet gjithmonë një përpjekje për të kuptuar njeriun dhe kohën ku jeton. Pa humbur lirinë artistike, ai mbetet gjithsesi pjesë e një kujtese me përgjegjësi kolektive. Kjo nuk do të thotë që arti të humbasë lirinë apo të kthehet në slogan. Përkundrazi, besoj që artisti mund të mbajë brenda vetes një vetëdije kulturore dhe njerëzore; qëndrimi i ndërgjegjshëm, por jo dogmatik, njerëzor, por jo sentimental, kombëtar, por jo i mbyllur ndaj botës.

Në kushtet tona, të një shoqërie ende në zhvillim dhe me probleme kombëtare, artisti vështirë se mund të jetë i shkëputur plotësisht nga fati kulturor dhe historik i kombit.

HEJZA: Në një epokë ku arti shpesh kërkon të tronditë, të provokojë ose të krijojë efekt të menjëhershëm mediatik, arti figurative duket sikur ruan ende një marrëdhënie më të heshur me njeriun. Ajo nuk bërtet; ajo pret shikimin. A mendoni se heshtja është ende pjesë e rëndësishme e artit?

BURON KACELI: Po, sepse heshtja është një formë e thellë e komunikimit artistik. Arti figurativ shpesh nuk kërkon të godasë menjëherë me efekte, por të zgjojë një përjetim që rritet gradualisht brenda shikuesit. Heshtja në art nuk është mungesë por hapësirë për reflektim, për kujtesë dhe për dialog të brendshëm. Arti figurativ për



mua ka një marrëdhënie tjetër me njeriun. Ai nuk i imponohet shikuesit, ai e fton të ndalet.

HEJZA: Kemi piktorë që ndërtojnë një marrëdhënie dramatike me ngjyrën dhe të tjerë që e trajtojnë atë pothuaj si frymëmarrje emocionale. Në pikturat tuaja ngjyra shpesh duket më shumë si atmosferë shpirtërore sesa si element dekorativ. Çfarë është ngjyra për ju: teknikë, emociion apo gjendje e brendshme?

BURON KACELI: Ngjyra së bashku me vizatimin, dritëhijen, tonet, ritmin etj., janë elementë që funksionojnë së bashku në funksion të idesë apo ndjesisë që artisti kërkon të përçojë tek shikuesi. Ndonjëherë ngjyra merr rol kryesor nga elementët e tjerë, por edhe kur është në mbështetje të elementëve të tjerë, ajo ka një rol të pazëvendësueshëm. Është e pazëvendësueshme për fuqinë e saj, por jo si qëllim në vetvete. Ka shpesh keqkuptime në lidhje me ngjyrën. Quhet kolorist një piktor që përdor ngjyra të ndezura, të forta, ngjyra të vjeshtës, ndërkohë që për mendimin tim kolorist është ai piktor, që arrin të përçojë tek shikuesi edhe ndjesinë delikate të dimrit përmes një koloriti tepër fin.

HEJZA: Në vendet tona, arti shpesh vlerësohet më shumë si trashëgimi sesa si debat kulturor i

gjallë. Flitet për emrat e mëdhenj, por më pak për idetë, dilemat dhe proceset që i kanë shoqëruar ata. A mendoni se shoqëria shqiptare di të komunikojë realisht me artin, apo ende e sheh atë më shumë si simbol prestigji kulturor?

BURON KACELI: Arti në shoqëri mendoj se gëzon më shumë respekt, por jo gjithmonë komunikim të thellë. Flasim për emra të mëdhenj me krenari, për veprat dhe trashëgiminë që kanë lënë, por rrallë ndalemi tek idetë, dilemat, kërkimet dhe përpjekjet që qëndrojnë pas krijuesit të tyre. Mendoj se jemi në procesin e ndërtimit të kësaj marrëdhënieje, në procesin e ndërtimit të këtij dialogu. I nderojmë artistët më mirë se sa i dëgjojmë. Arti nuk është thjesht e vetëm trashëgimi; ai është një bisedë që duhet të vazhdojë në çdo brez.


HEJZA: Çdo artist, në një mënyrë ose tjetër, jeton edhe me frikën e përsëritjes së vetvetes. Sidomos piktorët figurativë, të cilët punojnë gjatë me të njëjtën ndjeshmëri estetike, përballen vazhdimisht me nevojën për të ruajtur autenticitetin pa humbur identitetin. Si e lufton një piktor rutinën e vet krijuese?

BURON KACELI: Ka artistë, më tepër mjeshtër zanati, që për të pasur "sukses", në përfitim të të ardhurave financiare, vazhdojnë një rutinë, që e kanë konfirmuar me tregun e një niveli jo të lartë kulturor, por ka edhe nga ata, jo të shumë, por artistë në kuptimin e mirë të fjalës, të cilët kanë përparësi vlerat e vërteta dhe rrezikojnë duke mohuar dhe konfirmuar krijimtarinë e tyre përgjatë procesit krijues. Picasso thoshte, se kur fillonte një pikturë, nuk mund të dinte se si do ta përfundonte atë.

Artisti është gjithmonë në kërkim dhe kërkimi nuk mbaron kurrë. Ticiani, koloristi i madh, para se të ndërronte jetë shprehu keqardhjen se nuk arriti të kuptonte pikturën. Leon Tolstoi në veprën e tij, "Que es el arte" (Çfarë është arti), nuk e di a arriti të kënaqet me një definicion të mundshëm. Në kërkim të së vërtetës në art, artisti vazhdimisht shkon drejt së panjohurës. Është një proces i pandalshëm, që nuk mund ta pranojë rutinën.

Artistët e vërtetë në shpirt zbulojnë gjithmonë diçka nga e panjohura sado të thjeshta dhe të vogla të jenë zbulimet.

HEJZA: Studioja e piktorit është ndoshta një nga vendet e fundit ku koha ende ecën ndryshe. Ndërsa bota jashtë përshejtohet vazhdimisht, piktura kërkon durim, vetmi dhe heshtje. Në njëfarë mënyre, ajo duket si një formë rezistence




ndaj ritmit modern të jetës. A mendoni se të pikturosh sot është edhe një mënyrë për t'i rezistuar shpërqendrimin të kohës moderne?

BURON KACELI: Është një lloj rezistence jo ndaj modernitetit e kohës por ndaj shpejtësisë së tepërt që rrezikon t'i marrë kohën njeriut për të soditur, për të reflektuar e për të qëndruar me veten. Kur hyj në studio kam ndjesinë se ora e botës mbetet jashtë derës. Piktura nuk e njeh ngutjen, sado që influencohet disi prej saj. Ajo kërkon të njëjtën gjë që ka kërkuar gjithmonë: vëmendje, durim dhe heshtje. Piktura është si vendi ku njeriu rifiton kohën e tij të brendshme.

Krijuesi mendoj se ka kohën e vet; nganjëherë kthehet pas, shumë pas në kohë dhe nganjëherë shkon përpara, shumë përpara. Ai shpesh herë ndihet të jetë jashtë kohe. Ka kohën e tij, e jo vetëm kur futet në studio.

HEJZA: Në fund, çdo piktor lë pas jo vetëm tablo, por edhe mënyrën se si e ka parë botën. Disa krijues mbeten në kujtesë për teknikën, disa për stilin, e disa për ndjeshmërinë njerëzore që arrijnë të ruajnë brenda veprës së tyre. Kur një ditë ta shihni krijimtarinë tuaj si një tërësi të përfunduar, çfarë do të dëshironit të mbetesh më së shumti prej Buron Kacelit në kujtesën e artit shqiptar?




AUTOPORTRETI DHE LASGUSHI

BURON KACELI: Së pari, natyrisht që do të dëshiroja që të ndjehej gjurma ime, arti im në kujtesën e artit shqiptar. Se dytise si !? Ndoshta si i përfshirë shpirtërisht në botën e artit, jo thjesht për mënyrën dhe nivelin artistik se si pikturova, por edhe si një artist i këtij vendi me mënyrën dhe qëndrimin tim karshi kohës që jetova.

Lasgushi vinte tek im atë dhe rrinin e bisedonin qetë e gjatë në studio. Një herë, kur kthehem vonë dhe futem në studio, im atë më thotë që kishte qenë Lasgushi dhe kur kishte parë autoportretin tim, nuk kish pushuar se komentuari duke e vlerësuar jashtë mase. Atëherë i them babait që nuk po e vazhdoj, sepse e kisha lënë edhe për një seancë të dytë. Sigurisht, më thotë, im atë. E si do të mund ta vazhdosh.

ZEF SQIRO DI MAXHO



Si rrallë ndonjë krijues tjetër arbëresh, ai është i afirmuar në Itali dhe jashtë saj dhe paraqet një nga personalitetet më të dalluara të bashkësisë arbëreshe të Sicilisë

Nehas SOPAJ

U lind më 11 janar të vitit 1944 në Hora e Arbëreshëve të Sicilisë. Është poet, përkthyes dhe dramaturg i shquar. Ka studiuar në Universitetin e Palermos dhe një kohë ka jetuar në Settimo Torinese, pranë Torinos. Një kohë ka punuar si mësues në vendlindje. Është drejtor i MondoAlbaneses që nga viti 1975 dhe udhëheqës i grupit teatral ku janë shfaqur shumë pjesë teatrale të tij. Si rrallë ndonjë krijues tjetër arbëresh, ai është i afirmuar në Itali dhe jashtë saj dhe paraqet një nga personalitetet më të dalluara të bashkësisë arbëreshe të Sicilisë. Vepra poetike e Zef Di Maxhos ka tone të thella të mallit ndaj Shqipërisë,

Kosovës dhe, në përgjithësi, etnisë shqiptare të shpërndarë gjithandej nëpër botë. Nga rrethi i krijuesve të njohur bashkëkohorë arbëreshë, siç janë V. Ujko, K. Kandreva, Z. Skiro di Maxho, F. Altimari dhe K. Xukaro, tipari i parë kryesor i tyre, që mund ta hetojë lexuesi gjatë leximit, është se ata – edhe pse të shkëputur nga trungu gjeografik i shqipes – si për inat të fatit të tyre të hidhur, që të gjithë, deri në një madje, janë të lidhur fort pas rrënjëve të atdheut të tyre të parë. Në shkrimet e tyre ata janë të lidhur kaq fort pas rrënjëve të të parëve, për traditat e shkrimit shqip të variantit arbëresh, për ngjijtjen e tyre normale me to, kaq sa tani, me interkomunikimin e lirë, ata sikur janë

bërë një me tërësinë e kulturës e të letërsisë së sotme shqipe. Ruajtja e gjuhës është ngritur në kult dhe kjo është veçantia e tyre kombëtare. Gjuha ruhet e gjallë dhe kultivohet nga dashuria e madhe që ndjejnë ata ndaj atdheut të stërlashtë. Kjo shëmbëllen me identitetin e stërlashtë, si diçka e shenjtë, që frymon gjallë akoma, dhe që kohëve të fundit, me përmbysjen e komunizmit, mund shndërrohet në *prekje të lirë të ëndrrave* të tyre, të kënduara me shekuj në këngët popullore – Mëmës, atdheut të stërlashtë. Kjo ëndërr dhe ky mall, që tani shndërrohet në realitet praktik, në përditshmëri, kaq e/i përvëlur, që quhet More, Çamëri, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e qytete të caktuara të trojeve shqiptare, etni shqiptare, mjerisht nganjëherë, gjatë aktit të rinjohjes, atyre u kthehet në zhgënjim të vërtetë. Kjo tragjike historike, e ruajtur në popull si kulturë “bdarjeje”, zhbërjeje ose vaji për rrënjët, për trungun e paraardhësve prej nga qenë çrrënjësor dhunshëm para mëse pesë shekujsh, mbijeton edhe sot me anë të dashurisë ndaj gjuhës dhe mallit për atdheun e stërlashtë. Që këtu, arti letrar arbëresh nuk ndalet së krijuari edhe sot. Mu kur na duket se po tretet dhe po zhbëhet si dikur, kur kishte ndodhur “shqepja e madhe”, mallkimi i çrrënjësjes për shpëtim ose për mbijetesë, mund të vazhdojë edhe tani, kur të gjithë duam të jemi në një familje të përbashkët, që e quajmë Europë, sepse rinjohja i ka problemet e saj të nënkuptueshme.

Në arealin e letërsisë së sotme arbëreshe vazhdon të prijë poezia, gjinia mbi gjinitë dhe llojet e tjera letrare, ndërsa nga sfondi i përgjithshëm i krijuesve që e lërojnë atë shquhen dy grupe të mëdha. Grupin e parë e përbëjnë poetët tashmë të *vjetër*, D. Vetmo, V. Ujko, K. Kandreva etj., në krijimtarinë letrare të të cilëve shquhet dashuria



ndaj arbërishtes (lexo: shqipes) me thekse shumë të forta të këtyre ndjenjave kohezive të lidhur fort pas traditës së vargut deradian, darean dhe serembian etj., por edhe dashuria ndaj atdheut të të parëve, ndaj jetës ejt. Grupin e dytë e përbëjnë poetët e *rinj* në krye me Zef Sqiropi Di Maxhon, Italo Fortinon, Françesko Altamarin, Kate Xukaron etj., te të cilët – krahas dashurisë për gjuhën, për traditat, rrënjët, atdheun, pra kultin koheziv të vazhdimësisë së atij klimaksi të të vjetërve, e hetojmë prirjen e theksuar drejt universalizimit të poezisë arbëreshe me atë shqipe, me poezinë e përbotshme drejt mishërimit të temave, motiveve dhe tërësisë së frymëzimeve të njëjta me “shtimungun” e kohës sonë. Ato tema që tradicionalisht cilësoheshin si

tema të një inercioni të brendshëm artistik, me anë të një procesimi të një introvenoze të kohës më të re, që vjen nga globalizmi, nga tema thjesht kombëtare shndërrohen në tema universale me frekuentime si me të gjitha letërsitë e përbotshme. Po t'u bësh një vështrim paksa më hollë dallimeve të dy gjeneratave letrare të letërsisë bashkëkohore arbëreshe rreth qëndrimit ndaj traditës dhe letërsisë së përbotshme, mund të shohim se "oscilimet" nuk janë kaq të mëdha sa na duken. Ato, madje, nuk dallojnë shumë, sepse "daljet" tematike jashtë qarkut kombëtar janë hetuar edhe më parë, që në kohën e De Radës e këtej, por dallimet e këtyre dy grupimeve megjithatë mund t'i shohim në natyrën e strukturimit të hartimeve poetike, të cilat i prekin aspektet e kërcimit ose të kapërcimit të vlerave, që shihen dukshëm si të ndryshme nga krijuesi në krijues. Kështu, te disa, siç është për shembull Zef Sqiro Di Maxhoos e Kate Xukaro, ato shfaqen më ndryshe në të gjitha pikëpamjet nga gjeneratat e vjetra, por edhe nga vetë krijuesit e tjerë të gjeneratës që i takojnë. Në vlerësimin e hierarkisë së vlerave të njëmendta të gjedhjeve çfarë në përgjithësi zotëron sot letërsia e sotme arbëreshe, më pak se sa t'i reshtemi kësaj gjeografie të vlerave që e përftojmë nga prezantimet tona nëpër antologji, duhet të ndalemi në analizën e disa shfaqjeve të reja, moderne dhe postmoderne, te disa përfaqësues të veçantë të kësaj poezie, më saktë në disonimet estetike të disave prej tyre, që bëjnë standardin tonë të njohur, që është rrafsh i përbashkët i vlerave çfarë dihen nga tradita e shkrimit shqip, që ne e kemi të njohur që nga De Rada, Dara, Serembe etj.

Pa qëllim "shqepjeje" të kësaj poezie nga poezia tjetër shqipe, çfarë me automatizëm mund ta sugjeronte aspekti gjuhësor i tyre, për shkak të statusit real "arkaik" që qëndron larg standardit të shqipes, nga ato krijime, të cilat kemi mundësi t'i lexojmë në gjuhën e normëzuar, që d.m.th. nga ajo që mund t'i shijojmë estetikisht, fitohet përshtypja se krijimet e këtyre krijuesve në vazhdimësi janë me traditën e autorëve të lartpërmendur dhe, sipas vlerave që kanë, lëre që fare pak dallojnë nga poezia jonë, por me disa aspekte na e kalojnë neve, të trungut amë, sepse ato madje janë në nivel dhe në trend të poezisë që shkruhet gjithandej në letërsinë e Europës. Kur e themi këtë, për ilustrim mund ta kemi poezinë e Di Maxhos, tek i cili shihen qartë prirjet e daljes së autorit nga prizmi i qarkut tradicional tematik thjesht kombëtar në arenën dhe në hapësirën letrare pa kufizime, në sferën e letërsisë pa përkatësi "rrethimesh". Pam-

jen dhe "shëndetin" e një poezie kombëtare mund ta mikrofilmojmë nga prizmi i autenticitetit, nga plani tematik dhe nga plani i materializimit me mjetet tipike që janë standard i përgjithshëm në të gjitha letërsitë kombëtare dhe ato duhen parë në lidhjet me traditën dhe me bashkëkohësinë, tek të cilat mund të shihen vlerat e njëmendta me të cilat një krijues mund të shfaqet para botës duke e prezantuar "ekstraktin" e artit të tij të vërtetë. Pa kurrfarë kurtoazie, gojëplot mund të themi se poezia arbëreshe është e njëjtë me poezinë tonë shqipe, me të gjitha atributet e lartpërmendura, dhe ajo fare pak dallon nga kjo e jona, sepse ajo mund të na prezantojë denjësisht para të tjerëve. Ajo paraqet pasqyrën e vërtetë të shpirtit shqiptar, tek e cila më shumë rrezaton lidhja organike e këtij shpirti. Këtë gjë, në përgjithësi, mund ta shohim duke u nisur nga emrat e autorëve D. Vetmo, V. Ujko, K. Kandreva, e duke vazhduar më tej me Z. Skiqo Di Maxhon, K. Xukaron, I. Fortinon etj., tek të cilët mund të nxirret "ekstrakti" teorik i një poezie të pastër shqipe, të cilën mund ta lokalizojmë këtu më poshtë.

Që në fillim duhet t'i përmendim disa aspekte teorike të poezisë së pastër shqipe, të cilat i kam bërë publike edhe në raste të tjera me autorët të cilët i kam analizuar në studimin *Purolirika shqipe*, siç janë poezitë e L. Poradecit, M. Camajt, T. Dervishit, B. Musliut etj., prej të cilëve jorastësisht po e përmend këtu M. Camajn, duke e ditur se ai për shumë vite qe mishëruar me arbëreshët dhe se një pjesë e poezisë së tij frymon me atë ton ngjyrash poetike. Poezia e pastruar nga ideologjizmat, angazhimet e ndryshme, religjionizmat, derivatet e narracionit, sqarimet dhe "kallaballëkun" e fjalomanive që u kanë hije llojeve të tjera letrare, por jo poezisë lirike, poezia e këtillë e ka në substancën e saj matricën e fluiditetit e të materializimit të unit të poetit, pra njeriun në vete, i ka ngjyrat, zërin dhe muzikën e shpirtit të një entiteti, në rasti tonë të shqiptarëve (lexo këtu: të arbëreshëve). Në kohën e globalizimit kur bashkësitë e ndara kombëtare, siç janë arbëreshët, kërcënohen të asimilohen në kushte të një ndryshimi të madh nga modernia drejt postmodernes, poezia arbëreshe "grithet" brenda gjuhës, të vetmit adut për mbijetimin. Mu kur na duket se është marri të profetizosh për ekzistencën dhe qëndresën në rrethanat e pozitës së shqiptarëve në Itali si minoritet, mu në kohën kur nga të gjitha anët alarmohet për fundin e poezisë, kur bëhet fjalë për poezinë nën trysinë e zhvillimit shumë dinamik të teknikës dhe të teknologjisë, që gllabëron gjithçka, madje edhe



atomet e fundit të shpirtit njerëzor, po pra mu kur substancat e fjalëve, ngjyrave dhe zërave s'reshtin së krijuari dhe së rikrijuari metabolizmin e shpirtit për qëndresë, mes kombëtares dhe altruizmit, poetët arbëreshë përngjiten dhe "grithen" edhe më shumë pas kombëtares, që u rri si mburojë e të veçantës së shpirtit të tyre për njohje dhe identitetet para të tjerëve.

Poezia s'ka si mund të vdesë para këtyre sakrificave kaq të mëdha, ndërsa ata që më së tepërmi këmbëngulin që të mos ndodhë kjo rropulli vetëglabërimi, janë poetët e çrrënjosur, janë pikërisht poetët, madje më shumë se gjithë të tjerët, janë poetët arbëreshë, *xhelozët e vetes së tyre të humbur në kohë dhe hapësirë*, siç na bie të mësojmë nga letërsitë e ndryshme të botës, jo vetëm si te kjo e jona. Poezia e tyre nuk mund të vdesë, sepse kjo do t'i ngjiste pushimit të rrahjes së zemrës së kombit, etnisë, a grupacionit kul-

turor, përfaqësues të të cilëve janë. E si mund të ndodhë vdekja e poezisë së tyre kur kjo do t'i ngjiste ngufatjes kolektive gjatë marrjes frymë të njerëzve arbëreshë?! Kjo s'mund të ndodhë as sot, edhe pas "ndarjes" dhe "shprishjes" së gjakut, sepse kjo mund t'i ngjiste këputjes së qarkullimit të gjakut, të atyre që këmbëngulin të mbijetojë arbërishtja, sado që rrethanat të jenë kundër tyre, t'ua mohojnë ekzistencën. Poezia arbëreshe është shembull se si mund t'u rezistohet këtyre "shprishjeve", "vdarjeve", "zhbërjeve" të kësaj pjese të kombit tonë. Mu kur duket se po i vjen fundi poezisë, ajo (poezia) si zë i shpirtit të rrezikuar e gjen mënyrën e mbijetesës, e gjen rrugën duke u transformuar dhe duke u zhvilluar gjithnjë e më shumë, si dhe duke krijuar zhanre të reja, tradicionale dhe moderne (postmoderne), ashtu që krijohet duke mos u "shpenzuar" dhe duke mos u zhbërë asnjëherë. Nga shembulli e poe-

zisë bashkëkohore arbëreshe i shohim proceset e evoluimit të autorëve, duke filluar nga gjeneratat më të vjetra e duke vazhduar drejt gjeneratave të reja. Gjersa tek të vjetrit poezia e lidhur fort për rrënjët e të parëve i shpreh preokupimet poetike me anë të gjuhës me fjalë dhe figura paksa të njohura tradicionalisht nga kritika, te të rinjtë, fare natyrshëm, shihen prirjet dhe orientimet kah zgjerimi i rrethit të preokupimeve të kohës sonë, kah shpërthimi i vetvetes përtej qarkut të njohur tematik, rrjedhimisht edhe kah krijimi i një fature moderne dhe postmoderne që ua sjell koha.

Një nga krijuesit më të vjetër, V. Ujko, është shembulli i një poezie të njohur si poezi e unit të fortë, poezi e shpirtit të madh, poezi e dashurisë ndaj etnisë, ngjyrave të dhembjeve historike të trashëguara thellë nga e kaluara e hidhur. Këto i shohim te poezitë e tij: *Kënga arbëreshe, Moment arbëresh, Hapma derën, zonja Mëmë* etj. Një varg figurash të njohura të këngëve popullore, siç janë *Konstantini, Garentina, pastaj ati, mëma, kali, varri, vala e detit, stina, fisi, zonja mëmë, lisat* (e De Radës) etj., flasin për një sistem unik figurativ nëpër të cilin bredh poeti, por jo vetëm ai. Nëpër të "bredhin" edhe të tjerët, të cilët ua përcjellin më të rinjve "amanetin" e gjuhës. Poeti tjetër, Zef Skiro di Maxho, që është në fokusin tonë, është poet i cili me vargjet e tij, sidomos me poemthin lirik **Mas Rushi arbëresh**, na jep shembullin e një poezie të mirëfilltë të pastër lirike, diçka me të cilën ua ka tejkaluar jo vetëm pararendësve, por edhe shumë mjeshtërve të tjerë të kohës sonë. Që në titull, lexuesi ndesh sinonimin arbëresh si "relikt" ose amanet të përkatësisë dhe shquarsisë kombëtare, që nuk "vret" substancialisht me ngushtim edhe kur duket se i ka rekuizitat e një gjuhe shprehëse tradicionale. Kjo nuk është e këtillë, sepse ajo është një poezi e pastër lirike në aspektin e faturës dhe mekanizmave artistikë, që e përbëjnë atë, me të cilët autori e dëshmon mjeshtërinë dhe kulturën e lartë, empirinë, ontologjinë, që në tekstin e hartiimit poetik të fokusohet brenda kornizës së ligjëritimit të vet poetik me një varg figurash surrealistë, të cilat na japin të drejtë t'i marrim për gjetje dhe goditje mjeshtërore të asaj që e quajmë *shtimungi* pastër poetik.

Mas Rushi, filozofi që pi duhan dhe e "farkon" poezinë mu siç e farkon farkëtari hekurin (një metaforë e njohur në letërsinë e përbotshme; shih për këtë poezinë *Gesllo* të Sh. Petëfit), gjatë leximit na kujton F. G. Lorkën dhe *cante jondot* e tij, por edhe J. Gërvallën dhe Bali Katravellën e tij, me të cilët mjeshtri e krijon unin grotesk të njeriut të

vogël, një deformim të qëllimshëm deri në grimasat më sekrecioze dhe më intime, me çka krijon protofigurën lirike, heroin lirik, i cili sikur e "farkon" shpirtin e tij në sy të tjerëve mu siç e farkon hekurin farkëtari. Edhe në poezitë e tjera, Zef Skiro Di Maxho dallohet me shprehje të parëndomta nga poezia tjetër arbëreshe, si për shembull:

1. pritja/ e të kaltërit (poezia *Ndërrim*),
2. duke kërkuar/ xixëllime të reja/ në vise të tjera (poezia *Neve, poetëve arbëreshë*),
3. qiell i rëndë (poezia *Emigrantit*),
4. këtu/ njëherë flitej arbërisht (poezia *Më parë se të ngryset*)

Në këto poezi, autorin e shohim me një profil të veçantë letrar, me gjuhë dhe shprehje figurative që dallohen dukshëm nga poetët e tjerë arbëreshë. Vini re: ç'është, për shembull, *pritja e të kaltërit* te poezia e parë, vargu: *duke kërkuar xixëllime të reja?! Në fillim na duken shprehje të rëndomta, por që menjëherë hetojmë aty një metonimi, e cila do ta alegorizonte statusin e të stërçrrenjosurit arbëresh, tani nga Italia diku gjetiu, kryesisht përtej oqeanëve. Parëndomësia e shprehjeve poetike, që duket te poezia **Mas Rushi arbëresh**, është kulminacioni, kur poeti më tepër se këto shkëndija të artit të pastër e shpreh mjeshttrin e vargut, që di ta skalisë dhe artikulojë dhembjen (po potencojmë: dhembjen dhe jo gazin jetësor; dhembjen, sepse definitivisht ajo është ndjenja që gjithmonë mund t'i rezistojnë më gjatë mbamendjes dhe kujtesës të lexuesve, që zgjat më shumë se gazi) në planin më të gjerë të fjalës, ta sendërtojë atë në një godinë më të madhe se një vjershë e thjeshtë, ta krijojë një poemë tipike shqiptare në të cilën fati i arbëreshit do të vihet në rol të një loje dhe të një vetëtaljeje qesëndisëse, edhe atë të një groteske që tipizohet, e thotë të vërtetën absolute ose, thënë ndryshe, e tipizon një gjendje angështie me qetësinë më të madhe brenda një hipertekstualiteti, për të mos thënë se ky është një sendërtim postmodern i sotëm.*

Poema është krijuar brenda 29 këngëve, nga të cilat në tri këngët e para poeti "rrëfen" në vetë të tretë, kurse të gjitha këngët tjera i përflet vetë heroin lirik, Mas Rushi, i cili ia merr fjalën autorit dhe e rrëfen fatin e vet. Që në këngën e parë lexuesi ndesh një foni a orkestrim parodik, ku zëri i ironizimit mezi hetohet nga vënia e vijave tipizuese brenda gjuhës me lojë të fjalëve. Sipas sqarimit në fund të vjershës në formë fusnote, mësojmë se Mas (Mastru, nga maestro – deminutivi Mas – variacion i arbërishtes nën ndikim të italishtes) Rushi (mbiemër personal Gjergj – deminutivi Rush në arbërisht) është Mjeshtër Gjergji.

*Mas Rushi
filozof i heshtur
me devocione të përditshme
pi duhan e tret
mendime.
Simbiozë.
Simbiozë e plotë
ai dhe llulla:
shtëllunga mendimesh
të kaluara nga kujtesa
jep pipa
dhe dashuri...*

Ky është prologu i poemthit. Dy këngët e tjera që pasojnë e përplotësojnë boshtin e "rrëfimit" lirik, i cili vetëm e segmentizon veçantinë e Unit, i cili – duke filluar nga kënga e 4-t e deri te kënga e 29-të, vetë e merr "rrëfimin" në formë të shpërthimit lirik, pastër lirik, që është një groteskë fund e krye tragjikomike, e cila e përflet fatin tragjik të arbëreshit të sotëm, i cili brenda vetes së vet e "vdes" gjeniu brenda, me tym llulle dhe me farkime të hekurit, që është fat dhe art njëkohësisht, baras me një tragjedi të gjallë moderne sot. Lexuesi shumë herë mund të pandehë se kjo poezi, në fakt, është një lloj vaji a gjëme e gjendjes sociale të njeriut të ditëve tona, të arbëreshit pra. Ajo edhe është e këtillë po të mos ishte më shumë se kaq – ajo është një mjeshtri e rrallë e identifikimit të fatit të Unit kolektiv të arbëreshit me tragjiken kolektive njerëzore pa dallim kombi dhe përkatësie tjetër. Ky është fati i të çrrënjësorisë sot në mbarë botën, i cili e "tjerr" jetën me kudhrën e çekanit i cili skalit tragjiken e vet. Këtë përjetim lexuesi nuk do ta hetojë në më shumë se dy të treta e tekstit, madje pjesa e fillimit dhe më shumë se gjysma e saj të duket sikur është një idilë mes paradoksit (tymi i llullës dhe trokitja e çekanit në kudhër), gjersa të mos "shpëtojnë" rrëketë e lotëve e të dhembjes, të cilat mund t'i lexojmë me anë të shkëndijave të metaforave të gjetura dhe të zgjedhura, që nganjëherë janë krejt abstrakte.

Le t'i përmendim disa prej këtyre shprehjeve të shkëputura sipas një kronologjie, që mbase kështu mund t'ia krijojnë lexuesit përfytyrimin e ecurisë së mendimit dhe të përjetimit (lexuesit mund të nxjerrin disa forma tjera të leximit nga ky hartim poetik, ndryshe nga ky):

- lëmshe në grykë (kënga 2),

- disa herë fladi / e kthen tymin / e pingultë të pipës / deri te sytë. (kënga 4),

- Farkatar dhe nallban/ unë qeshë. / Më pëlqente hekurin ta zbutja / dhe t'i jepja trajtë.. (kënga 5);

- bie shi mbi agimin e zbehtë / Ndonjë ia heq ironinë (kënga 7),

- Përrenj bëhen rrugët / degë lumi rrugicat // Xhamat të mjegulluar / nga tymi i pipës: / shfaqja e shiut / të pastron si rrugë/ dhe zbulon aty-këtu/ ndonjë gur. (kënga 8);

- Hapësira të ngushta/ më të ngushta akoma/ idetë... // Merr frymë / MasRushi / - puhi e duhan... (kënga 10)

- Muzikën time shënova / në hekur / Dhe jetën time // Në një kordhele liqeni/ sonte hëna krithet/ metal i ftohtë// Në tejdukshmëri / peri i tymit të pipë / kundër natës... (kënga 11),

- fjalët / i mori era. (kënga 12);

- kur vrapon mendja / me vallen e tymit// shpirti/ kundërmues i duhanit (kënga 13);

- Këngë dashurie / mbi kudhër rrihja / kur isha dashnor. / Këngë / dhe shkëndija që përhapeshin/ si trëndafila nga degë/ të zjarrta hekuri. (kënga 15)

- Orë kemi zbuluar / me sy plot dritë// dhe muzikë lëmuar // por vjershat e mia; por nuk ia recitova;/ ne jemi burra të ashpër / dhe nuk duam fjalë. (kënga 16);

- E pranverën e përjetshme? / Dhe flitë e avullshme / të pipës pa rrudha? / O hy... (kënga 17);

- E hidhët shkëputja / në këtë rrugë// mortja akoma absurde. / Por/ nuk është mortja / i vetmi mister; / misteri i vërtetë / është pohimi/ se mortja që mundur - / zoti kryepriфт. / Nënshkruar: / Mas Rushi. (kënga 20);

- Ne me tym e kundërmim / kemi jetuar! (kënga 22);

- I njoh nga hap / potkonjtë e mushqeve/ që farkëtova unë (kënga 24);

- ...do të vdesë / në kafaz kanarina.// Ashtu në kafazin e kohës / na rrimë...// (kënga 25);

- Pjatat prej tunxhi / janë kudhra dhe çekani / kur shtien shkëndija. / Kënga ime është fryma / e farkës së zjarrtë. (kënga 26).

Nga kjo që shkëputëm si gjuhë dhe shprehje poetike, si një varg metaforash abstrakte, pse jo, mund të rikonstruktohet një rrëfim i brendshëm poetik, që na e jep tipin e poezisë së pastër, i cili i këndon fatit të zi të njeriut arbëresh, i cili filozofinë e ekzistencës së vet e krijon me anë të parabolës së zejes së farkëtarit, një ironi që redukton një protestë sociale, por që në fakt është përditshmëri e epokës sonë, të vlershme për të gjithë, gjersa shndërrohet në një lloj moto e fatit njerëzor, aso çfarë e ngrit Sh. Petëfi. Pipa, tymi, farka e kuajve, potkonjtë, fijet e mendimeve dhe të gjitha fijet e

tjera të shpirtit që i nxit teksti poetik, e nxjerrin poetin tonë "tjetër" nga poetët e sotëm shqiptarë (arbëreshë, si ta doni). Në formë antiteze, madje, poeti e nxjerr në sipërfaqe edhe këtë se: *ne rrimë në kafazin e kohës*, ndërkaq përtej kësaj që e quajmë kohë loz e vërteta jonë që s'e dimë.

Kënga I: Portreti i Mas Rushit, elementet e groteskës: filozof, këndeje me profesion farkëtar, që mediton ashtu siç dridhen shtëllungat e llullës, mu ashtu si edhe Bali Katravella i J. Gërvallës, i cili i pari e ka parë aeroplanin.

Kënga II paraqet portretin, i cili zbrit në të kaluarën historike: *stinët e njëpasnjëshme... / shumëzotjë rrathët / e eshtrave*. Portreti i heroit është portret oval: figura e drejtë zgjatet prej së larti, sepse në strofën e tretë, pas mallëngjimit dhe përgjëratës, vegullohet zëri i "jashtëm", që i flet heroit në vetë të parë: pas kaq shumë kohësh *kjo pipë e mallëngjyer / heq pak ose asgjë* (ovacione groteske, sh. imi N. S.) / *ka një lëmsh në grykë* (ovacione tragjizmi, shënim imi, N. S.).

Kënga III është narracion. Aty vazhdojnë vijat e portretit të MasRushit: groteskë dhe tragjikë njëkohësisht.

Në këngën IV, në rrëfimin në vetë të parë, flet vetë MasRushi. Një ditë e jetës së MasRushit: këtu del gruaja Marie, posta (urbani) etj. Kemi një skicë jete me një referencë kthyesë në vargjet e fundit, përsëri groteske.

Kënga V: *farkëtar dhe nallban / unë qeshë...* – kadencë poetike; një portal poetik rreth punës dashurisë, jetës.

Kënga VI: është rrëfim poetik: *Dje për vend të huaj u nis / i biri i vo' Martës...*

Vazhdon rrëfimi në skenën tjetër: Shi, një personazh lirik, koliqakëndon "*O solemio...*" / *ndonjë ia heq ironinë*. Vini re: në rrëfimin e rrafshët, disonimi është fjala *ironi* që poeti e fut këtu papritur. Pse ironi këtu, vallë?! A mos është për shkak të këngës italiane që e këndon një arbëresh? Ironi dhe parodizim: *Mas Rushi / në prag të derës qëkur / bisedon me llullën*.

Tek kënga VIII përsëri ia beh shiu. *Përrenjë bëhen rrugët / degë lumi rrugicat...* Rrëkejzat e shiut sikur ofrojnë një tabloid jete të zymtë të jetës të cilës i kthehet si kadencë, tymi i pipës së Mas Rushit.

Te kënga IX përsëri kemi disonim të ri: *Sa vajze pate ti...*

Këngët e tjera fillojnë të uniformohen brenda një zëri. Ky është zëri i Mas Rushit, i cili herë në vetë të parë e herë në vetë të tretë flet për fatin e njeriut pa një përcaktim se ç'këndohet. Zëri, në



vend të parë njëjës nganjëherë shket në vetë të parë shumë, kryesisht saherë që mëton t'i sintetizojë zërat e përgjithshëm njerëzorë. Fatet e njerëzve, fatet e këputura të këtyre njerëzve, pas-taj revolucionet, janë farat narrative të këtij zëri që flet: duke u nisur nga fatet e dashnorëve dhe të dashurçkave, që të gjitha dukshëm të rralla, i shoqëron pipa dhe shtëllunga e tymit parodik. Njeriu është qenie kolektive (shih: Platon, Hegel) dhe, si i këtillë, profesioni i farkëtarit (nallbanit), ka të bëjë me një mori dramash të përditshme të jetës njerëzore. Andaj **Mas Rushi arbëresh** si nëpër lojë e krijon ngrehinën e quajtur jetë e vërtetë dhe e plotë. Janë këngë të ndryshme, në të cilat në plan të parë vjen në shprehje gazi jetësor, ekzaltimi dhe kënaqësitë e jetës që i përmbys vdekja. Këto shkëndija të jetës sociale nganjëherë qesin krye tok me tymin e pipës së Mas Rushit. Në këngën XXV poeti i lirë i këndon vetërobërimit. Shembull ka një personazh lirik, Mas Nestasin, prototipin e njeriut i cili e ngrys jetën pa liri dhe pa mendime. Pas këngës XXVI, e cila paraqet një moto poetike dhe të cilën do ta shohim pak më poshtë, kënga

Vepra letrare: Sunata (1976), Më para se të ngriset (1977), Kopica e ndryshku (1981), Gjuha e bukës (1981), Përtej maleve prapa kodrës (1985), Vjeç të tua 500 (1988), Laerti, i jati (1989), Metaforë (1990), Kosova lule (1991), Anije me vela e me motor (1992), Poezi gushtore (1995), Kopshti im me dritare (1996), Dhembje e ngrirë (1998), Gjeometri dhe ikje (1998), Sonete (1999), poezi.

XXVII është një këngë që i këndon vdekjes, kup-timësisë ose moskuptimit të saj. Poeti lutet të mos i sjellin lule të freskëta mbi varr, sepse kush mund ta ndjejë atë bukuri, ngase ai që nuk u dashurua nuk i ndjen "rrudhat" e erës!

Rrëfimi lirik në vetë të parë të **Mas Rushi arbëresh** mbyllet me tri këngët e fundit, këngët XXVII, XXVIII, XXIX, me një varg maksimash dhe parabolash përmbyllëse: gjitonia, me të cilën vazhdimisht poeti shoqërohet dhe kuvendon me të, është llulla, d.m.th. vetmia poetike. Andaj pasthirrma *secili prej nesh është poet* për vetveten e vet mbase është timoni i ideve të poetit për jetën: jeta është lojë të cilën e luan secili njeri me veten e vet dhe ajo lojë është e pambarimtë – vijnë e shkojnë fatet e bukura dhe të shëmtuara njerëzore, kurse loja nuk këputet. Pas këngëve të fillimit, të cilat janë kryesisht skica dhe vargje që e krijojnë portretin oval të Mas Rushit, në këngët e fundit, të cilat janë herë në vetë të parë njëjës e herë në vetë të parë shumës, zëri i folësit mishërohet me vetë zërin e poetit, ndërsa në fund gjithnjë është tragjizmi jetësor, i cili ngrihet në pedestal me anë

të disa figurave, të lojës me fjalë, e cila i thur himn kultit të jetës dhe punës përmbi shtrëngesa, pa marrë parasysh se vdekja i përmbys të gjitha.

Këngët e këtij poemthi sillen pandërprerë rreth disa figurave që përsëriten (*Mas Rushi, farka, llulla, tymi, shiu etj.*). Edhe kur janë në pyetje skicat e jetës së përditshme, edhe kur merr hov zëri ligjërues i heroit në vetë të parë, pra edhe kur ai më nuk filozofon (lexo: nuk e krijon figurën ovale prej vetvetes), e unifikon saktë zërin e vet me të tjerët, nuk parodizon dhe nuk parodizohet. Në "kallëzimet që e ngrenë groteskën e figurës së heroit dhe të jetës në përgjithësi, në këngët të cilat në fillim janë skicime dhe në të cilat më vonë flet heroi, nga 29 këngët në përgjithësi, disa sosh kanë *denduri narracioni* dhe pak figura, ndërsa disa të tjera kanë *denduri figurativiteti*, ku mungon narracioni. Këngët që kanë narracion i gjejmë edhe te këngët e para edhe te ato të fundit, pa marrë parasysh se disa këngë janë thjesht skica portretesh personazhesh sporadikë (psh. *Mas Nestasi etj.*), kurse disa janë këngë të pastra lirike. Ndërkaq këngët që kanë denduri figurash pa narracion ose që narracioni mbindërtohet nënkuptueshëm nga lexuesi, në brendinë e tyre në të vërtetë i reduktojmë idetë dhe mesazhet e poetit, që shprehet jo rrallë në formë të lojës me fjalë, me retorikë të fshehur ose edhe me alegorezë parodizuese të të folurit lirik.

Kënga XXVI që është një ndër këngët me denduri dhe kondensim figurash dhe zërim polifonik fsheh brenda vetes një varg mesazhesh poetike asnjëherë retorike. *Kënga ime është frymë/ e farkës së zjarrtë/ daullja është udha/ e rrahur nga patkonjtë.* Katërvargëshi i cituar më lart, i shqiptuar në formë të krahasimeve të thjeshta, në fakt paraqet dy farë metaforash jo pak të njohura në poezinë e përbotshme, që janë metafora shumë solemne për jetën e njeriut. Në një rrafsh tjetër ato mund të jenë edhe metafora të aktit krijues të poetit, veprës së tij, e cila lind nga asgjëja, si prodhim mendor dhe shqisur ndijimori njeriut. Krahasimi: *kënga ime është fryma/ e farkës së zjarrtë* është një metaforë konkrete e artit krijues të poetit, fryma (e shpirtit të poetit) që lind nga farka (hekuri i farkëtuar). Krahasimi tjetër: *daullja është udha/ e rrahur nga patkonjtë* është metaforë e dyfishuar, gjegjësisht metaforë e dubluar, abstrakte: daullja (jeta) është udha e rrahur nga potkonjtë (nga furtunat jetësore). Antitezat *hekur e zjarr, thëngjill e shkëndijë, dhembje e gëzim, muzikë prej kudhre e çekani* në të vërtetë janë një varg simbolesh të fatit njerëzor jo vetëm të kësaj poezie, por edhe të të gjithë njerëzve.

ANIJA FIKTIVE, AJO TEKONOLOGJIKE DHE MILITARJA

Në arkitekturën e romanit Ribinson Kruzo, anija ngrihet si premtim estetik, por fundoset si ligj epistemologjik. - Titaniku nuk është thjesht anije, por konstruksioni më i madh i iluzionit modern: bindja se njeriu mund të ndërtojë diçka më të fortë se fati. - USS Missouri nuk është anije lufte. Është vendndodhja e fundit të një epoke, platforma fizike ku shekulli i 20-të mbylli plagën e vet më të madhe

Ismail SYLA

1. ROBINSON KRUZO (ONTOLOGJIA E RRËNIMIT DHE MITRA E SHPËTIMIT)

Anija e Robinson Kruzos është nomadizmi zanafillor i gabimit dhe që nga botimi refuzon të jetë një aksident lundrimi. Ajo mishëron atë shtysë të errët, para-refleksive, që e dëbon trupin nga qendra e amullt e shtëpisë drejt periferive të rrezikshme të ekzistencës. Kjo anije është makineria e arratisjes nga vetvetja, e cila, ekskluzivisht përmes aktit radikal të katastrofës, shndërrohet në ediumin e vetëm të rikthimit, jo si zhvendosje gjeografike, por si një rithemelimin ontologjik mbi gjeometrinë e zhveshur të ishullit. Në arkitekturën e romanit, anija ngrihet si premtim estetik, por fundoset si ligj epistemologjik. Për sa kohë lundron, ajo nuk qeveriset nga timoni, por nga e vërteta që Kruzo refuzon ta mësojë. Ajo është zgjatimi material i rënies së tij. Megjithatë, në aktin e mbytjes, ajo nuk asgjësohet; ajo kalon në një gjendje të re transformimi me



vetë aktin suprem që e zhvesh subjektin nga bota. Mbetjet e saj pushojnë së qeni mjet transporti, për t'u ngurtësuar në themelin e qenies.

Kjo anije është matrica e paradoksit absolut: ajo ekzekuton shkakun (vdekjen e historisë së vjetër), por dorëzon lëndën nga e cila do të vetë-gjenerohet subjekti i ri, akt sublim që e armatos subjektin për t'u bërë mbinjeri. Kur Robinsonit i zë syri mbeturinat e drunjtja që oqeani i pështyn mbi rërë, ai në to nuk sheh thjesht një kolaps material, por pasqyrën e tij të fragmentuar. Ato ashkla nuk janë relikte vdekjeje, por potencia e një rindërtimi total. Rrënoja, kësisoj, nuk përfaqëson fundin e pasurisë, por depozitën e parë gjenetike të shpirtit të mbijetuar.

Ndryshe nga arketipet e tjera të lundrimit, kjo anije refuzon linearitetin. Ajo është "Jo"-ja e madhe e Fatit, një dekret metafizik që thyen iluzionin e lirisë komode në det, për ta zëvendësuar me lirinë e tmerrshme të vetmisë absolute. Liria nuk banon në horizontin e shpenguar, por në limitin e ngushtë të ishullit. Aty, njeriu mbetet pa ndërmjetës, pa dëshmitarë, pa mundësi ikjeje, i detyruar të përballlet me tmerrin e të qenit i vetmi zot i hapësirës së tij. Në këtë situatë të re metafizika e ashklave, - copëzat e drurit që i shpëtojnë shkumës - janë monada të ndërgjegjes. Çdo gozhdë e ndryshkur, çdo dërrasë e kalbur, është një fraksion i vetëdijes që refuzoi asgjësimin. Përmes kësaj lënde në dukje të vdekur, Robinsoni fillon artikulumin e botës së tij të re. Me këto mbetje, ai nuk ndërton thjesht një kasolle; ai ndërton kronometrin e parë të arsyes, moralin e tij të ri, ritmin liturgjik të ditëve. Ishulli u bë skena -hapësira neutrale, e vetë anija e thyer mbetet motori i brendshëm, zemra e dytë që rreh jashtë trupit të tij. Pa këtë vdekje materiale, nuk do të kishte zgjim të frymës.

Në instancën e fundit, ky artefakt i mbytur ngjiz metaforën e një sekreti të skajshëm ontologjik: çdo dështim i madh është një mitër. Anija nuk merr më frymë, por kthehet në ventilatorin e shpirtit të tij. Ajo është e palëvizshme, por gjeneron lëvizjen më radikale të brendshme. Nuk e dërgon më asgjëkund në hapësirë, por e detyron që hap pas hapi të ndërtojë me duart e veta një Kozmos nga Kaosi. Ajo anije nuk lundron më mbi sipërfaqen e ujërave të romanit - ajo tashmë lundron, hermetike dhe e pashkatërrueshme, në vetë strukturën thelbësore të shpirtit njerëzor. Në këtë kontekst izolimi absolut, ishulli pushon së qeni një burg natyror dhe shndërrohet në tempull të mundshëm ku njeriu i zhveshur mund të gjejë të vërtetën e tij.

2. TITANIKU (ANIJA QË U NDËRTUA SI HYJNI DHE U FUNDOS SI MËSIM)

Titaniku nuk është thjesht anije, por konstrukcioni më i madh i iluzionit modern: bindja se njeriu mund të ndërtojë diçka më të fortë se fati. Ai u quajt i papërmytshëm, siç njeriu quan shpirtin e vet "të pathyeshëm" para se koha t'ia tregojë të kundërtën. Arkitekti me Titanikun nuk ndërtoi një anije çfarëdo, por ndërtoi besimin e një epoke. Njeriu i shekullit XX nuk kishte më frikë nga deti, as nga natyra, as nga Zoti. Ai kishte druajtje dhe frikë mos po binte nga madhështia. Kështu, Titaniku ishte anije që nuk lundronte në ujë, por në bindjen e plotfuqisë njerëzore. Dhe pikërisht për këtë, ai duhej të fundosej.

Titaniku në barkun e vet kishte ndarje klasore. Në bord e tij, klasa e parë jetonte si në perandori të qetë, ndërsa klasa e tretë si hije të pafjalë. E mbi të gjitha aty banonte dhe qëndronte arroganca, ai motori i padukshëm i anijes. Titaniku ishte trup prej prodhimesh industriale (plastika, hekuri etj), por zemër prej mendjemadhësie. Dhe mendjemadhësia e ka ligjin e vet: nuk mbytet nga dallga, por nga **çarja e parë e së vërtetës**. Akulli që e qëllon nuk është fatkeqësi, por pasqyrë. Guri i ftohtë i natës, i ngritur pa qëllim, është pika ku njeriu sheh se nuk është zot, por trup që thyhet. Pra, Titaniku nuk përplaset me akullin. Titaniku përplaset me veten.

Titaniku dëshmoi se mbytja nuk është vetëm tragjedi njerëzore, por tragjedi metafizike e epokës moderne: epoka që ndërtoi gjithçka, përveç përlësisë. Uji që hyn ngadalë në barkun e Titanikut nuk është dënim, është mësim që hyn si loti i një bote të mashtruar. Aty ku Noa ndërtoi arkën për t'u shpëtuar, njeriu modern ndërtoi Titanikun për të sfiduar. Prandaj Arka shpëton, Titaniku fundoset. Jo sepse është më i dobët, por se **është më i sigurt në vetvete**. Kjo e bën Titanikun anijen më moderne të shpirtit: ajo na kujton se asgjë nuk mbytet më shpejt se një gjë që beson se nuk mund të mbytet.

Kur orkestrina vazhdon të luajë mbi kuvertë, nuk është heroizëm. Është poezia e fundit e njerëzimit, që përpiqet të mbajë formën ndërsa struktura zhytet. Është pamja më e singertë e njeriut: muzikë mbi dritë, fundosje nën këmbë. Në këtë skenë të heshtur, Titaniku pushon së qeni anije dhe bëhet shkallë mes njeriut dhe fatit, shkallë që të kujton se teknika, luksi, çeliku etj., nuk e heqin dot brishtësinë e qenies.



Titaniku është anija që nuk e vrau deti. E vrau bindja se njeriu nuk ka më nevojë për kufij. Në fund, ai fundoset jo në oqean, por në historinë morale të njeriut: aty ku iluzionet varen nën sipërfaqe si yje të rënë nga qielli i gabuar. Prandaj Titaniku është më shumë se tragjedi. Është kujtesa që i vjen njerëzimit sa herë ai beson se është hyjni. Sepse deti nuk ka asnjë arsye të vrasë anijet. Deti vret vetëm atë që tenton ta sundojë. E, Titaniku, më shumë se çdo anije në botë, ishte iluzioni i materializuar i epokës. Në këtë mënyrë, ai është anija e vetme që u ndërtua si hyjni dhe u kthye në mësim. Dhe pikërisht për këtë, nuk mungon kurrë në thellësitë tona.

3. USS MISSOURI (ANIJA KU HISTORIA ULI SHPATËN DHE KOHA NDRYSHOI RITMIN E SAJ)

USS Missouri nuk është anije lufte. Është vendndodhja e fundit të një epoke, platforma fizike ku shekulli i 20-të mbylli plagën e vet më të madhe. Kur e shikon nga larg, ajo duket si trup çeliku i

ngritur mbi ujë, një qytet lundrues i përforsuar, një mekanizëm i rëndë i ndërtuar për të mbajtur mbi vete gjithë peshën e luftës. Por në thelb, Missouri është katarsisi i fundit i dhunës, ku dhuna e madhe e historisë u detyrua të nënshkruante fundin e saj.

Missouri përfaqëson kulmin e fuqisë ushtarake të epokës industriale. Aty ku anijet e drurit u zhdukën dhe anijet e çelikut morën fjalën. Në trupin e saj prej dhjetëra mijëra tonësh, kishte një lloj mbivendosjeje të çuditshme: forcë absolute, pamundësi morale, vetëdije se çdo armë e tepërt mbart brenda vetes farën e fundosjes shpirtërore. Në barkun e saj gjigant kishte aq shumë dhëmbë çeliku, aq shumë motorë, aq shumë shpërthime të mundshme, sa njeriu kupton se Missouri nuk ishte ndërtuar për lundrim, por për dominim. Dhe megjithatë, dominimi i saj nuk u realizua kurrë përmes betejave të pafund. U realizua në një fletë letre.

Dita kur dhuna u ul në gjuhë, 2 shtator 1945, është momenti ku Missouri bëhet ikonë filozofike. Në kuvertën e saj, nën qiellin e Tokios dhe nën

HEJZA

heshtjen e një bote që priste frymën, u nënshkrua kapitullimi i Japonisë. Nuk ishin topat që fituan. Nuk ishin avionët. Nuk ishin aleancat. Ishte anija si hapësirë e nënshtrimit. Kështu, Missouri u bë tavolina më e rëndë e historisë. Një platformë e ftohtë çeliku ku njeriu më në fund pranoi sethika e luftës kishte prerë shumë thellë dhe se duhej të mbërrinte fundi. Missouri mbajti mbi vete jo vetëm oficerët e dy palëve, por dramën e një planeti të djegur. Ajo anije është dëshmia e një të vërtete të ashpër: Luftërat mbarojnë jo në fushë-beteja, por në një pikë ku njerëzimi nuk mund të përballojë më peshën e vet.

Missouri, paradoksalisht, është anija më paqësore e historisë amerikane, jo sepse nuk luftoi, por sepse mbajti në trup të saj momentin kur lufta u dorëzua. Ajo nuk është simbol i fitimit, por i përfundimit. Nuk është monument i fitores, por monument i lodhjes së botës. Ajo u bë altar i një epoke që u rrëzua përballë vetes. Mbyllje e një spirale vrasëse, fund i rrethit ku njeriu po vetë-për-typej nga mekanizmat që kishte krijuar. Missouri nuk është anije që solli shpresë. Është anije që solli kthjellim. Në thelbin e saj, ajo ngriti një pyetje që

asnjë anije tjetër lufte nuk ka bërë: Çfarë ndodh kur njeriu e kupton se fuqia e tij është më shkatërruese se vullneti i tij?

Missouri është përgjigjja materiale e kësaj pyetjeje: një anije që i tejkalon dimensionet e funksionit të vet, një anije që u bë kufi midis dhunës dhe arsyes. Ajo nuk preu detet me heroizëm homerik, ashtu si nuk luftoi me shpirt të egër si liburnat ilire, ashtu si nuk kërkoi legjenda si anijet vikinge. Missouri kërkoi një gjë tjetër: heshtjen pas zhurmës. Ajo është mjeti i madh i çlirimit nga lufta, mjeti ku njeriu e ndaloi veten për një moment dhe e pa se çfarë kishte bërë.

Mësimi i fundit i Missouri tregon se shpresa e njerëzimit nuk vjen nga forcimi i anijeve, nga armët më të rënda, nga çeliku më i trashë. Shpresa vjen kur një anije e madhe, ndërtuar për të shkatërruar, bëhet vendi ku dhuna shkruan aktin e dorëzimit. Kjo është arsyeja pse USS Missouri mbetet një monument i pazëvendësueshëm filozofik: Forca e vërtetë e njeriut nuk është fuqia për të luftuar, por fuqia për të ndalur luftën. USS Missouri nuk është anija që fitoi Luftën e Dytë Botërore. Është anija ku lufta uli kokën.



VIKTOR EFTIMIU I BOBOSHTICËS

- "Stërgjyshërit e mi janë fis i kërkimtarëve të yjeve që e ëndërronin botën" -

Nga Nehat ISLAMI

Pranë lulishtes së madhe "Qishmixhiu" në Bukuresht, gjendet një shtëpi dykatëshe e shkrimtarit shqiptar dhe rumun Viktor Eftimiu, i ardhur këtu nga Boboshtica e Korçës në moshën dyvjeçare, pra më 1891. Lulet shumëgjyreshe i bëjnë kurorë statujës së autorit, të ngritur për së gjalli, të më se 125 veprave, shumica drama, romane dhe mbi 60 mijë vargje. Disa nga ato janë me motive shqiptare, si poemti "Skënderbeu", "Dy kryqe", "Portrete dhe kujtime", eseja e njohur "Folklori shqiptar", etj. Gjatë xhirimit të një emisioni dokumentar të "Shkëndijës" për të, na zbuloi se ishte duke shkruar një vepër me motive shqiptare. Më shumë nuk na tha. Pas vdekjes së tij, më 1972, të gjitha dorëshkrimet e tij u mblodhën në arka dhe u mbyllën. Nuk di asgjë për fatin e tyre.

"Stërgjyshërit e mi janë fis i kërkimtarëve të yjeve, që ëndërronin botën, tërë jetën e tyre"-pati thënë ai në Paris gjatë Luftës së Parë Botërore, kur si kryetar i Kolonisë së pesëdhjetë mijë shqiptarëve të Rumanisë, kishte shkruar më shumë peticione të nënshkruara nga shumica për të kërkuar njohjen e Pavarësisë së Shqipërisë nga ana e fuqive të mëdha.

Fëmija i Boboshticës erdhi në Rumani vetëm me gjuhën e prindërve, shqipen, por në moshën 16 vjeçe, e mësoi aq mirë rumanishten, sa që atëherë e shkroi përmbledhjen e parë me poezi, kurse tre vjet më vonë edhe dramën e parë në gjuhën e re, pas së cilës mësoi edhe frëngjishten, gjermanishten...

Shtëpia e tij është një ekspozitë e përhershme e pikturave nga brushat më të njohura rumune dhe evropiane që nga rinia e tij. Gjithandej në mure, edhe motive të bukura të folklorit shqiptar, kurse në tavolinën e tij të punës një urnë e mbushur me dhé nga Boboshtica.



- Pranë kësaj urne e ndiej se gjendem në Boboshticë. Kur të vdes, atë dhé do ta hedhin mbi mua, që të prehem me aromën e Shqipërisë – më pati thënë gjatë qëndrimit treditor në atë shtëpi muze.

Balli i dhomës së punës së shkrimtarit i takon dashurisë së madhe të tij, bashkëshortes Axhepina Mokri, aktore e njohur rumune, së cilës, pas vdekjes, Eftimiu ia kushtoi 701 sonete. Atë e kishte bashkudhëtare edhe në lëvizjet e tij për të paraqitur çështjen shqiptare në shumë vende evropiane, si dhe në takimet e shpeshta me intelektualët dhe veprimtarët e tjerë shqiptarë të kohës. Më bie në sy një foto nga një pritje e organizuar e shqiptarëve të Rumanisë në hotelin "Bulevard" të Bukureshtit, me rastin e ardhjes nga Austria e aktorit të njohur shqiptar, Aleksadër Moisiu.

-Moisiun e njoha para se ta burgosnin francezët gjatë Luftës së Parë Botërore. Atëbotë bëra çmos për ta liruar. Arritëm ta këmbenim me një gjeneral francez, gjithashtu të zënë rob në luftë. Pastaj, kur erdhi në Bukuresht me ansamblin e vet, ai ka banuar mu në këtë shtëpi. Më kujtohet se tërë ekipit u blenë gardërobë dhe gjëra të nevojshme për shfaqjen e tyre.

Moisiun e ka dashur shumë publiku i këtushëm. Edhe sot e ndiej se theksi i tij i shqipes i jepte një muzikalitet gjuhës gjermane në skenë. Dikur kur nuk njiheshim dhe e shikoja në shfaqjet e Vjenës apo të Berlinit, nuk e dija se ishte shqiptar. Por, në takimin tonë të parë, ai më tha se është nga Durrësi dhe Kavaja. Kur i tregova se jam bobosh-ticas, mes nesh më nuk ekzistonte asnjë barrierë – rrëfen Eftimiu, i lumtur, siç thoshte që ishte duke rrefyer për një emision në gjuhën shqipe.

Njerëzit që shërbenin në atë shtëpi na thanë se shumë vite nuk kishte pranuar asnjë ekip televiziv. Vërehej një entuziazëm që gjendej me njerëzit e vet.

Gjatë xhirimit ishte i ulur në një kanape me pëlhurë mëndafshi. Sa herë që kërkonte të na sillnin diçka të pinim, thërriste në shqip, e kur nuk kishte përgjigje, kukuriste si një gjel. Ky ishte sinjal i thirrjes së fundit.

Duke qeshur rrëfente se nga Bobosh-tica e fëmijërisë së tij, i kujtohej një gjel i madh që tërë ditën kukuriste. Me gjasë dëshironte ta kthente atë atmosferë gazmore edhe 81 vjet pas.


Kur flasim për letërsinë dhe autorët shqiptarë që i pëlqen, ai pa mëdyshje përgjigjet.

-Kadare. Është i papërsëritshëm. E lexoj me ëndje dhe çmalle me atdheun tim, ndonëse ndien shumë dhembje populli im.

Disa javë para ardhjes sonë në Bukuresht, Viktor Eftimiu, ish-drejtor i Teatrit Kombëtar të Bukureshtit, u zgjodh edhe kryetar nderi i Lidhjes së Shkrimtareve të Rumanisë, porse këto më nuk i bënë përshtypje. I tëri ishte kthyer nga fëmijëria dhe vendlindja. Më linte përshtypje të rrallë kthjelltësia e kujtesës.

Kolonia shqiptare e Bukureshtit, pos organizimit politik në mbrojtje të Shqipërisë përmes ndihmave, peticioneve që i dërgonim në Paris dhe përkrahjes së njeri-tjetrit, botonim dy gazeta : "Shqipëria e re" dhe "Drita" në Konstancë. Aty botonim edhe libra me letërsi shqipe dhe libra shkollorë.

- Asdreni që gjendej në Bukuresht, ka qenë një poet dhe patriot i madh. Më kujtohet si organizonte provat në Kishën tonë në Bukuresht për



ta përgatitur Himnin e Pavarësisë. Shkonim të gjithë – më pat thënë Eftimiu.

Viktor Eftimiu shkoi në Shqipëri pas 66 vjetësh, por lidhjet me atdheun i mbajti të forta gjatë gjithë jetës.

-Kur shkova në Shqipëri, më 1971, atje takova shumë shqiptarë të Rumanisë, të kthyer në vendin e tyre dhe u çmalla. Dëshiroj të vij edhe në Prishtinë, nëse më mban forca, por para se të vij unë atje, ja një propozim për regjisorët kosovarë. Nëse kanë dëshirë, le ta realizojnë "Njeriu që pa vdekjen me sy". Është vepër e përkthyer edhe në shqip. Aty kam shtjelluar një temë që do të mbesë aktuale gjatë të gjitha kohëve. Së paku mua më duket kështu. Ky tekst kërkon angazhim maksimal të gjithë ekipit. Veçmas aktorët e rinj mund ta sprovonjë veten. Kjo shfaqje është luajtur mbi katër mijë herë në skenat evropiane dhe gjithnjë është aktuale. Nëse do të luhet në Prishtinë, do të dëshiroja ta dëgjoja si tingëllon shqip. Kam edhe një ide për një dramë me motive shqiptare. Disa maj me piqet frymëzimi. Do të dëshiroja të luhet në Prishtinë e Tiranë. Përsëritet të gjithë aktorët në Prishtinë dhe u uroj suksese, - tha në ndarje.

P.S.

Viktor Eftimiu ka vizituar edhe një herë tjetër Shqipërinë. Në Prishtinë nuk pati forcë të vinte. Ishte shumë i lodhur, por ishte gëzuar shumë kur e kishin lajmëruar për suksesin që kishte korrur në Teatrin Kombëtar të Prishtinës vepra e tij "Njeriu që e pa vdekjen me sy". Ai vdiq më 1972 në Bukuresht.

KRISTO FLOQI, MOLIERI SHQIPTAR

Kristo Floqi u arrestua nga komunistët sapo erdhën në pushtet, duke e shpallur fajtor, si autor i himnit të mbretërisë. Kristo Floqi u burgos nga vitet 1945-1950. I braktisur, i përbuzur, i vetmuar, ai vdiq në mjerim në vitin 1951

Arben ILIAZI

Drmaturgu Kristo Floqi nga kritika shqiptare është cilësuar si Moliери shqiptar. Kristo Floqi është përfshirë dhe në "Fjalorin enciklopedik shqiptar" (2008), botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, duke u renditur në radhën e autorëve të letërsisë shqiptare të periudhës '12-'39, si një ndër dramaturgët e zëshëm të kohës së vet, së bashku me Et'hëm Haxhiademin, Ndre Zadenë, Viçens Prendushin, etj. Robert Elsie të "Historia e letërsisë shqiptare", e cilëson Floqin si "dramaturgu më popullor shqiptar në gjysmën e parë të shekullit të 20-të".

K. Floqi shkroi 8 drama dhe 22 komedi me një akt: Rrogat e nëpunësve, Lojnat e studentëve, Do vras vedin, Vllazni e interes, E bij e bankierit, Dhëndër me përdhuni, Merre ta marrim, Nder e qytetari, Kundërshtarët e prikës, Pësimet-mësimet, Zi e më zi, Reklamë e bluf, E mbesa e krahinorit, Akraballëket, Ministri kandidat, Burri-burrë, Tezja e Karlit, Qerthulli politik, Monologë komikë teatrorë, Përfundimet e zilisë, Fat i papritur. Këto vepra mund të klasifikohen si farsa dhe si komedi satirike.

Floqi pasqyroi motivet që e bëjnë të dallueshëm këtë autor nga krijimtaria dramaturgjike e mëhershme. Hap pas hapi ai e krijoi një frymë të re letrare-dramatike, ku veprat dramatike fituan një karakter lëvizës dhe dialektik në dramaturgjinë e kohës. K. Floqi u bë nismëtar i komedisë së shkurtër, solli përvojë të begatë, krijoi një galeri tipash që zbërtheheshin falë situatave të çlirëta, shpesh paradoksale e me veprime të papritura, situatat e keqkuptimeve, me përdorimin e alogjiz-mave, burlleskut.



Farsat komike të Floqit shkrihen në një zhanër unik, ku humori i shfrenuar takohet me boshllëkun ekzistencial, në kundërshtitë me peshë sociale, dhe të mprehta për kohën. Këto vepra sfidojnë logjikën tradicionale dhe nxjerrin në pah absurditetin e jetës njerëzore. Ngjarjet zhvillohen në një realitet ku shkaku dhe pasoja nuk përkojnë. Në këto vepra paraqiten pamje nga jeta e përditshme e ambienteve shqiptare, duke i karikuar ato dhe duke i bërë groteske. Dramaturgu ia ka dalë që t'i arrijë qëllimet në këto vepra përmes mbështetjes së kundërthëniesve të njëra-tjetra si dhe përmes ironisë, e cila del nga kontradiktat e njohura të



jetës. Në shumë prej tyre procesi i “zbulimit të së kundërtës” kryhet nëpërmjet situatave komike, farsës ose ngjarjeve të çuditshme. Me fjalë të tjera, Floqi zbulon thelbin komik dhe atë tragjikomik të përditshmërisë.

Ajo që pritet të ndodhë zakonisht dështon, dhe zgjidhjet e problemeve janë po aq të çuditshme sa vetë problemet.

Karakteret shpesh ngecin në veprime ose dialogë që përsëriten pafundësisht, duke krijuar ndjesinë e një mekanizmi të prishur. Kjo shërben për të treguar kotësinë e përpjekjeve njerëzore. Farsat shpesh kanë edhe elemente absurdi; shpesh përfundojnë ashtu siç kanë filluar: në një kaos të organizuar. Historia nuk mbyllet me një moral tradicional, apo një përfundim të qetë, duke

lënë të kuptohet se jeta vazhdon në të njëjtin rreth vicioz. Përmes këtij kombinimi, farsat funksionojnë jo vetëm si argëtim, por edhe si një pasqyrë kritike dhe filozofike.

Në krijimtarinë e K. Floqit, farsat dhe elementet komike nuk shërbejnë thjesht për të argëtuar, por janë thelbësore për të goditur hipokrizinë dhe shtirjen. Farsat komike janë shkruar me një stil novator, që u shpëton konvencioneve të periudhës, duke treguar, nëpërmjet një stili realist, neurozat e qenieve njerëzore dhe kritikën e tij të ashpra ndaj moralit të kohës. Satira nuk kufizohet vetëm në kapjen e aspektit qesharak të zakoneve të periudhës së tij, por analizon dhe portretizon njeriun në universalitetin e tij. Floqi nuk godet individin, por defektet që gjen-

den te shumica e qenieve njerëzore, defekte që e çojnë njeriun drejt pakënaqësisë. E qeshura e provokuar nga Floqi arrin të minojë pseudosigurinë e spektatorit. Për të arritur këtë qëllim, Floqi përdor mjete komike tradicionale, të cilat përfshijnë keqkuptime dhe përdorimin e lojërave gjuhësore elegante dhe delikate. Floqi përdor edhe farsën tragjike, për të nxjerrë në pah absurditetin e jetës dhe përplasjen e dhimbshme mes realitetit dhe maskave që mbajnë njëri-tjetrit. Ajo që e bën të veçantë K. Floqin në dramaturgji, është teatraliteti i jashtëzakonshëm. Duke u nisur edhe nga pandehma, në veprën dramatike të Floqit të gjithë janë lojtarë të rastit të asaj skene, që janë në gjendje ta shfrytëzojnë akëcilin aspekt të teatrit, që ta dramatizojnë realitetin jostabil apo, edhe gati-gati, jorealën në përballje me vetë dimensionin jetësor të njeriut. Merita e dramaturgut është se ai e tregon në mënyrën më të përsosur mjedisin në të cilin një person ndihet i vogël dhe i bindur, duke jetuar nën maskë. Ky autor mund të konsiderohet risimtar në dramaturgji, posaçërisht me ndërtimin e shumë të kundërtave në jetën e zakonshme të njerëzve, në situata komike, edhe si farsë, edhe si tragjedi. Floqi dëshironte t'i pëlqente publikut, ta bënte spektatorin të vetëkorrigjohej duke qeshur. dhe për të kjo ishte rregulla e madhe e të gjitha rregullave.

Floqi mbetet një krijues i madh i ndërtimit të karaktereve. Në këtë kontekst veçojnë komedinë "E mbesa e krahinorit", 1926; abuzimi me postin zyrtar, paaftësia dhe korrupsioni, vjedhjet e fondeve publike për rregullimin e rrugëve, mashtrimet dhe hiletë e një krahinari të një fshati të largët për t'i shpëtuar ndëshkimit, të gërshe-tuara me situata të këndshme komike, të papritura, alogjizma dhe paradokse, që vënë në lojë injorancën e nëpunësve të lartë të pushtetit si dhe shkaktojnë habi me shpëtimin nga ndëshkimi të krahinorit në saje të mbesës së tij, Bajames, e cila martohet me inspektorin. Veprimi komik në veprat e tij rrjedh natyrshëm, shpejt dhe me tensionime. Kjo karakterizohet jo vetëm me situatat e freskëta komike, kthesat e papritura dhe kontrastet e ashpra, por edhe me dialogun e gjallë e shumë dinamik. Me mjeshtëri Floqi krijon atmosferë të nxehtë, të shkaktuar nga veprimet dhe pasionet e personazheve, sipas mënyrës së të folurit dhe pasioneve të tyre i nënshtrohen plotësisht idesë kryesore: përqeshja dhe demaskimi i ashpër i së keqes shoqërore dhe triumfi i drejtësisë. Floqi nuk i druhej asnjë teme, dhe shpesh vuri në lojë shtresat më të fuqishme të shoqërisë së kohës.

Kristo Floqi, avokat, gjykatës, ministër, botues, poet dhe dramaturg, atdhetar i shquar, u lind më 24 maj 1876 në Korçë. Pas kthimit në Atdhe, Kristo Floqi iu kushtua avokaturës, letërsisë dhe politikës. Më 1919 ai drejtonte të përmuajshmen "Agimi" në Shkodër, ku kishte hapur dhe zyrën e vet avokatore. Më 19 shtator 1920, për pak muaj ai është Ministër i Arsimit në kabinetin e Iliaz Vrionit. Në legjislaturën e parë, 21 prill 1921 ishte deputet në Parlament. Ushtri edhe detyrën e gjyqtarit të Diktimit.

Mësimet e para Kristo Floqi i mori në shkollën qytetëse në Korçë, ndërsa studimet e mesme dhe të larta i kreu në Greqi, ku familja e tij qe shpërngulur. U diplomua për drejtësi në Athinë, po aty nisi të ushtrojë profesionin e avokatit më 1899. Ushtri avokatinë edhe në Perandorinë Osmane. Më pas shkon në Korçë, ku hap zyrë avokature, punoi gjatë viteve 1902-1908 avokat në vendlindje, Manastir dhe anëtar i gjyqit të shkallës së parë në Dibër.

Më 1908 drejton gazetën "Dielli" në Shtetet e Bashkuara. Më 24 dhjetor 1911 drejton mbledhjen për krijimin Komisionit për Bashkimin e organizatave shqiptare në SH.B.A. Më 28 prill 1912 themelues dhe anëtar i Komisionit qendror të Federatës Vatra, të cilën e drejtoi më 1913-1915. Merr pjesë më 1913 në Kongresin e Triestes, si i dërguar së bashku me Faik Konicën.

Më 6 qershor 1913 emërohet në krye të gjykatës civile e penale, madje merr pjesë në gjyqin e Beqir Grebenesë. Më 1914 u emërua kryesekretar i ministrisë së Drejtësisë. Në maj të 1919 drejtonte botimin e të përkohshmes "Agimi", organ degës letrare i shoqërisë "Vllaznia". Më 1921 u emërua ministër Arsimi në Qeverinë e Iljaz bej Vrionit. Më 1921 qe anëtar i "Bashkimit të Shenjtë" dhe në legjislaturën 1921-1923 u zgjodh deputet i prefekturës së Dibrës, u zëvendësua më 1922. Më 8 janar, 1922 ai hapi një zyrë avokatore në Rrugën e Dibrës.

Në vitet 1925-1926 botoi gazetën "Indipendence Shqiptare", kur edhe u rizgjodh si deputet i prefekturës së Korçës gjer më 1928. Më 1929 - 1944 me ndonjë ndërprerje qe anëtar i Këshillit të Shtetit, ndërsa më 1940 zëvendësohet kryetar i tij dhe drejtor i zyrës ligjore të institucionit. Kristo Floqi u arrestua nga komunistët sapo erdhën në pushtet, duke e shpallur fajtor, si autor i himnit të mbretërisë. Kristo Floqi u burgos nga vitet 1945-1950. I braktisur, i përbuzur, i vetmuar, ai vdiq në mjerim në vitin 1951. Vepra e tij është errësuar dhe lënë në harresë, është përgojuar e përbuzur. Kjo si në kohën e monizmit, ashtu edhe më vonë.

VAJZA E PYLLIT



Kali ngriti veshët dhe ndaloi për një çast. Një cicërimë e lehtë u përhap nëpër pemë. Vajza qeshi. Ishte një e qeshur e pastër, si burim uji që del nga guri. Dhe qëndruan pak minuta duke dëgjuar. Nuk e kishin me nxitim. Në pyllin e tyre koha dukej sikur ndalonte

Zhuljeta Grabocka ÇINA

Pylli ishte i lagësht nga vesa e mëngjesit. Drita kalonte mes degëve si fije të arta që preknin tokën. Në atë heshtje të gjallë, dëgjohej zhurma e qetë e hapave mbi gjethet e rëna. Triksi ecte ngadalë nëpër shteg. Shpatullat i kishte të forta. Në ecje kishte një ritëm të butë, të mençur, që vinte nga vitet e gjata të përvojës. Ai ndiente çdo frymëmarrje të pyllit. Çdo aromë, çdo lëvizje. Mbi shpinën e tij ku binte dielli i parë i mëngjesit, rinte kaluar një vajzë e vogël gjashtëvjeçare. Duart e saj ishin lidhur fort pas qafës së kalit. Flokët i valëviteshin me erën, dhe sytë i ndizeshin sa herë që ndonjë zog fluturonte mbi ta.

-“Triks, a i dëgjon?” i pëshpëriti ajo. Zogjtë po na ndjekin.”

Kali ngriti veshët dhe ndaloi për një çast. Një cicërimë e lehtë u përhap nëpër pemë. Vajza qeshi. Ishte një e qeshur e pastër, si burim uji që del nga guri. Dhe qëndruan pak minuta duke dëgjuar. Nuk e kishin me nxitim. Në pyllin e tyre koha dukej sikur ndalonte.

Triks ndiente trupin e lehtë të vajzës mbi shpinë, me një ndjesi që i ngrohte shpirtin. Ajo ishte e vetmja që dinte t’i fliste. Kur e prekte qafën e tij, çdo lodhje që i rëndonte mbi shpatullat i zhdukej. Ata ecën më tej, midis aromës së myshkut dhe gjetheve që përgëzoheshin me erën.

Vajza u tregonte pemëve për ëndrrat e saj. Për shtëpitë që donte të ndërtonte mbi degë. Për lumin që do ta mësonte të këndonte si ajo. Trixs e dëgjonte. Ai nuk dinte të fliste, por çdo hap i tij ishte një përgjigje. Kur dielli u ngjit lart, ata ndaluan pranë një livadhi të vogël. Vajza zbriti dhe mbështeti kokën mbi qafën e tij.

"Trixs," - i tha me zë të ulët, kur të rritem, do të vij prapë këtu. Edhe nëse flokët e tu bëhen krejt të bardhë.

Kali shfryu butë, dhe ajri doli si një re e ngrohtë përpara fytyrës së saj. Ishte mënyra e tij për të thënë "Po". Ata qëndruan ashtu, nën diellin e artë, si dy miq që kishin gjetur qetësinë në mes të botës. Dhe pylli dukej sikur i përqafonte të dy, vajzën e vogël dhe ponin e urtë, në heshtjen e tij të përjetshme.

MIRUPAFSHIM LUMË

Bari ishte i mbuluar me pika vese mëngjesi që ndrisnin si margaritarë. Vajza doli nga shtëpia e mbështjellë me shallin blu dhe hapat e saj të vegjël gumëzhinin nga gëzimi. Në fund të oborrit, Trixs e priste duke tundur bishtin e gjatë.

"Gati për aventurë?" - i tha ajo me zë të lartë. Trixs shfryu lehtë, si për të thënë "Gjithmonë gati!".

Ata u nisën drejt pyllit. Rrezet e diellit praronin mbi degë. Zogjtë cicëronin dhe era sillte aromën e luleve të para të pranverës. Ajo këndonte melodi të ndryshme, ndërsa Trixs ecte ngadalë dhe hapat e tij të qetë e bënë tokën të dridhej si një tambur i butë. Papritur, vajza ngriti dorën. "Psst... Dëgjo!" - i pëshpëriti ajo.

Nga larg vinte një zhurmë e çuditshme, si një pëshpëritje që rrëshqiste mbi gurë. Ishte lumi. Ata e ndoqën zhurmën derisa mbërritën te një shtrat i pastër. Uji shkëlqente si pasqyrë në dritën e diellit e dukej sikur rridhte me ngjyra e ylberit.

"Trixs, më duket sikur po flet lumi," - i tha duke zgjatur dorën mbi ujë. Trixs e vështroi me sytë e tij të mëdhenj e të urtë. Ai kishte dëgjuar shumë pëshpëritje në jetën e tij, por kjo ishte ndryshe. Uji po tregonte histori. Vajza mbylli sytë dhe dëgjoji një zë të lehtë që i thoshte: "Mos harro të dëgjosh, o vajzë e vogël... unë mbaj mend kujtimet e pyllit. Çdo pikë e imja njih një pemë, një zog, një fëmijë që ka qeshur këtu. Ajo hapi sytë e habitur.

"Trixs! Lumi flet. Vërtet flet!"

Trixs shfryu butë dhe preku ujin me thundrën e tij. Uji u drodh dhe disa fluska u ngjitën lart, si buzëqeshje. Ata qëndruan duke dëgjuar histori. Për shiun që binte në male, për degët që notonin, për peshqit që vallëzonin poshtë sipërfaqes. Vajzës i dukej sikur po fluturonte bashkë me



HEJZA

këto kujtime. Kur dielli filloi të perëndonte, lumi pëshpëriti edhe një herë:

- "Kthehuni sërish, miq e mi sepse kam shumë histori për t'ju treguar." Ajo buzëqeshi dhe e përqafoi qafën e Trixshit.

Po do të kthehemi, të premtojmë."

Trixs e ktheu kokën drejt saj dhe i dha një puthje prej ajri. Dhe teksa ecnin, drita e perëndimit të diellit pasqyrohej nëpër ujë, si një fjalë e artë që vetëm miqtë e pyllit mund ta kuptonin:

"Mirupafshim lumë."

VALLËZIMI I GJETHEVE

Në pyll kishte filluar vjeshta. Pemët ishin veshur me lloj e lloj ngjyra. Të verdha, portokalli, të kuqe, madje edhe pak të arta. Era frynte lehtë dhe çdo fëshfëritje gjethesh sillte një kërcitje degësh të ëmbël, si në një refren kënge. Vajza dhe Trixs ecnin nëpër shteg. Gjethet u binin dalëngadalë mbi supe, rreth e për rreth tyre dhe hera-herë duke u rrotulluar në ajër.

"Shiko, Trixs!" - tha ajo me sy të ndritur. "Duken sikur po vallëzojnë!"

Trixs ngriti kokën dhe u ndal. Një gjethe e kuqe u ul mbi hundën e tij. Ai i shfryu butë, dhe ajo u ngrit sërish në ajër. Vajza qeshi aq shumë, sa edhe zogjtë u ndalën për ta parë. Ndaj qëndruan edhe për pak, për të parë gjethet që rrotulloheshin në ajër. Por më pas, era u ndal. Gjethet u qetësuan, pushuan së lëvizuri.

"Oh... mbaroi vallëzimi," - tha paksa e zhgënjyer vajza. "Sa do doja të vazhdonin akoma."

Trixs e pa me sytë e tij mendueshëm.. Ai e dinte, se në pyll gjithçka ndodh në momentin e duhur. As më herët, as më vonë. Dhe iu afrua duke ulur kokën, si për t'i thënë:

"Durim, vogëlushe. Gjërat e bukura, kthehen përsëri."

Ata u ulën pranë një peme të madhe dhe pritën. Era nuk frynte më. Vetëm tingujt e sinfonisë së pyllit dëgjoheshin. Cicërimat e zogjve, kërcitja e degëve, fryma e tokës. Vajza mbylli sytë dhe dëgjoi. Ishte kaq qetësi. Ajo e ndjeu se pylli po merrte frymë bashkë me të. Papritur, një erë e butë filloi të fryjë përsëri. Një, pastaj dy, pastaj shumë gjethe u ngritën në ajër, duke vallëzuar rreth tyre si flutura krahëshkruar. Ajo u ngrit në këmbë, qeshi dhe lodroi nëpër to.

"Ja pra, Trixs! Vallëzimi u kthye sërish!!!"

Trixs e ndoqi me hapa të ngadalta, dhe bashkë u futën në mes të gjetheve që rrotulloheshin rreth tyre si yje të vegjël. Ajo e kuptoi se vërtet duhet

pak durim e besim që bukuria të rikthehet. Ata u kthyen aq të lumtur në shtëpi, sa vajza i pëshpëriti Trixshit: - "Do ta mbaj mend shumë gjatë këtë ditë. Edhe sikur gjithçka ndalet, unë do të pres që gjethet të fillojnë sërish vallëzimin e tyre." Trixs tundi kokën, një gjethe e artë i ra mbi shpinë, si një dhuratë e vogël nga pylli, për dy miq që dinin të prisnin vallëzimin e lumturisë së gjetheve.

SHTËPIA E YJEVE

Verë. Ishte një mbrëmje e qetë. Qielli po mbushej me yje. Pylli po përgatitej për gjumin e thellë. Dëgjohej vetëm cicërima e fundit e një zogu dhe fëshfërima e lehtë e erës që përkëdhelte gjethet. Vajza kishte veshur bluzën e saj të preferuar, bluzën me ngjyrë blu. Dhe qëndronte më këmbë pranë Trixshit.

"Sonte dua t'i shoh yjet nga pylli," - thirri ajo e entuziasmuar. "Ndoshta do gjejmë ndonjë yll që flet!"

Trixs u çapit ngadalë dhe filloi të ecte nëpër shtegun e ndriçuar nga drita e hënës. Bari nën këmbët e tij shkëlqente. Aty - këtu dritat e vogla të xixëllonjave ndizeshin e shuheshin si qirinj. Për pak arritën te një lis shumë i madh. Ishte pema më e vjetër e pyllit. Degët e tij hapeshin si krahët e një gjigandi. Në trung kishte plagë të thella, të mbuluara me myshk. Por ndërsa hëna ngjitej lart e më lart, diçka e mrekullueshme dukej se po ndodhte këtu poshtë. Gjethet filluan të ndriçonin. Vajza hapi sytë me habi.

"TRIXS! ... A PO E SHIKON?! GJETHET E LISIT PO SHKËLQEJNË!"

Kafsha qëndroi i qetë. E njihte këtë sekret prej kohësh. Shfryu lehtë si zakonisht dhe filladi i butë i përkëdheli gjethet e ndritshme. Ato filluan të lëshonin shkëndijime të vogla, si yje të rënë mbi tokë. Ajo u afrua dhe vuri dorën mbi trungun e lisit. Ishte i ngrohtë, si zemra e një krijese të gjallë. Pastaj dëgjoi një pëshpëritje të lehtë, që vinte nga brenda: - "Faleminderit që erdhe. Faleminderit që kujdesesh."

Vajza pa Trixsin me sytë e përplotur. "Lisi... po flet!"

Trixs uli kokën, për t'ia pohuar. Ai e kishte ditur gjithmonë që pylli fliste. Por vetëm me një kusht. Atëherë kur e dëgjon me thellësinë e zemrës. Ajo u ul pranë tij, dhe për një çast e ndjeu se ajo, ai dhe natyra ishin bërë një. Gjithçka rreth tyre ishte veshur me dritë. Gjethet, bari, ajri. Yjet e qiellit



u pasqyruan në sytë e vajzës. Pylli dukej si një botë e magjishme ku çdo gjë merr një pamje të papërsëritshme.

"Trixs," - i pëshpëriti ajo. "Unë kur të rritem do ta mbroj pyllin që dhe fëmijët e tjerë ta ndiejnë këtë magji."

Trixs e preku me hundë. Përreth tyre një re drite e vogël si pluhur u ngrit nga bari. Ishte përqaqimi i

pyllit për ta. Mbrëmjen kaloi në heshtje të paqme. Ata qëndruan edhe pak nën lirin e ndritshëm, duke parë yjet që shkëlqenin lart, shumë lart ... Dhe në atë moment, vajza e kuptoi se pylli nuk ishte vetëm shtëpia e yjeve. Pylli ishte miku i saj dhe ajo do të kujdesej përgjithmonë për të.

DRITA E PËRNDRITËSHME E SHËJZAVE TË KOLIQIT

Dëshira editoriale për ta pasë “Dritën e Shëjzave” në një botim solid e të plotë ka qenë e kaherëshme për ne, e bashkëshoqënueme me një tis shqetësimi permanent që atë ta përcillnim tek lexuesi ynë i sotëm pa mungesa e në gjithë plotninë e vet, me autenticitetin e paprekun, ashtu siç në të vërtetë ajo asht

Franò KULLI

Ernest Koliqi, themeluesi e drejtuesi i revistës “Shkëndija” në kohën e luftës, në Tiranë, njëherësh drejtues i Institutit të studimeve shqiptare(1940-1944),i ndodhur tashma, për shkaqe të njohuna historike,larg atdheut, në mërgatë, e përvijon veprimin e vet intelektual, jo vetëm si nevojë të shpërfaqjes së të mbrendëshmes së vet ditunore e ndjesore, aq të pasuna të dyja, por ma përtej kësaj, si mision atdhedashjeje.Një shërbesë, që në rrethanat e “së ndaluemes” i ofron ndjesinë e detyrimit me u gjënd në sintoni me këto rrethana tue vendosë ekuilibrat e mprehtë midis shtysave që e kishin qitë jashtë prej atdheut dhe ndjesisë së tij të përzemërt drejt atdheut të dëshiruar...Pezmi e pengu prej atdheut që të jashtëqet i konvertuem në dashni shumëfishë për atdheun që e ke limfë të gjallësisë sate. E me ç’mjete tjera përveç se me dije e me zemër. Tue synue rezonimin e vehtjes te të tjerë e të tjerë bashkëkombas, të qitun përdhunshëm prej dheut amë edhe ata. Te arbëreshët e “gjakut të shprishur” ma së pari, po edhe te bashkëkohës e bashkëvuajtës të së njëjtës rrethanë. E nis kështu botimin e revistës së tij “Shejzat”. Për shqipen e bartësit e përdoruesit e saj kudo ndodhen, jashtë vendit amë.

Dëshira editoriale për ta pasë “Dritën e Shëjzave” në një botim solid e të plotë ka qenë e kaherëshme për ne, e bashkëshoqënueme me një tis shqetësimi permanent që atë ta përcillnim tek lexuesi ynë i sotëm pa mungesa e në gjithë plotninë e vet, me autenticitetin e paprekun, ashtu siç në të vërtetë ajo asht; përfaqësuese e dëjë e zanit të një kohe pezull të shqiptarisë. Sidomos asaj të mërgatës.Siç do ta përcillte vetë Koliqi themeluesi e përvijuesi deri në frymën e fundme i revistës albanologjike në numrin nistor të saj, në vitin e largët 1957, të titulluar: Mbas udhëhek-

jes së Shëjzave, shpalos synimin dhe platformen afatgjatë: *“Botimi i kësaj të përkohëshme ka për qëllim të kryemit e një detyre intelektuale kundrejt atdheut shi në kohë kur në kuadrantin e historisë grepat po shënjojnë një ças rreziku jetëshues”.*

Kjo arritje për ne u bâ e mundun me ofrimin plot dëshirë të mbështetjes së studiuesit , publicistit e filozofit, profesorit të Urbaniana-s në Romë, Ardian Ndreca, përvijuesit të botimit permanent të “Shejzave” tash e në vijim. Mirënjohje e shumë rrespekt dedikatës së Tij.


“Kjo e përkohëshme don të jët tryezë e lirë kuvëndi burrnor,të mbajtur mbrenda caqeve t’urtis e të njerzís. Çdo shqiptar qi ka një mendim fryt-dhânës për të shfaqun dhe din t’a shfaqti në shqipe të pastër, çdo intelektual qi lakmon të rrahi një çashtje ditunore ose don të paraqesi prodhimet e veta letrare, ka me gjetun vënd në këto fletë tona, mjaft qi të frymëzohetnë xhixhillí të Shëjzave, hyllsí virtytesh arbnore.

E, Ernest Koliqi e kish kalue si pak kush sproven e dyfishtë;ditunar i pakundshoq e misionar i sprovuem...

Koliqi, njëri prej shkrimtarëve dhe intelektualëve më në zëtë Shqipërisë së kohës u përfshi në një qeveri “të përbërë nga njerëz pa vlera të veçanta”, pohon studiuesi dhe historiani Berndt Fischer (R. Gurakuqi: Shqipëria dhe tokat e lirueme 1939- 1946, fq.177).

Sikurse ende kujtohete, unë e kam përmendë shpesh,si e dhanë gojore edhe një bisedë e Koliqit , rrethanë e momentit kur ai ftohet në Tiranë për t’i propozue postin e ministrit.

Asht viti 1939 ai kishte pak kohë që ishte emnuer titullar i Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin “La Sapienza” në Romë. Simbas gojëdhanës, Koliqi nuk e jep përnji-



herë pëlqimin, por kërkon pak ditë kohë. Prejat-
jekthennë Shkoder e takon... At Gjergj Fishten.

- Më kanë propozue me u bâ ministër i arsimit,
pader...

- Me u bâ ministër - ia kthen pader Gjergji, pa
prit spjegime ma të gjata prej bashkëfolësit.

- Po, unë s'kam mujt me e dhanë fjalën, për pa
u pá e me fol me ty, pader - kërkon të shtjellojë
kërkesen e vet Koliqi, ma parë se me ia marrë
mendimin e matun tëatij që e çmonte aq shumë.

- Po pra po, me u bâ ministër - ia kthen me
të shpejtë e me kambëngulje pader Gjergji e i

thotë premë argumentin e vet, pa i lënë shtjellë për arsytimit të tjera: - me u bâ se të tanë tjerët e bâjnë ma keq se ti... (O Zot ç'farë kut vlerësmi për vlerat kishin njerëzit si ata. Me një ekzigjencë shembullore për dijet e për punët në dobi të saj e të kombit).

Dhe, Ernest Koliqi kështu u bë ministër i shtetit për Arsimin. Ministri me gjurmën më të dukëshme e të dobishme në arsimin e shqiptarëve...

Sapo filloi punën në këtë detyrë, ai mblodhi rreth vetes njerëzit e kulturës, shkrimtarët ma të shquem dhe filloi përpilimin dhe botimin e teksteve shkollore. Si ministër i Arsimit, në shtatorin e vitit 1941 mundësoi me një vendim që mbi 200 arsimtarë normalistë të shkonin në Kosovë dhe në trojet shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi. Pa u caktue ende formula me të cilën Kosova do t'i kthehej Shqipërisë dhe pa ardhë ende udhëzimet nga Roma, nën përgjegjësinë personale, ministri i Arsimit, profesori Ernest Koliqi nisi drejt "tokave të lirueme" 200 mësues e profesorë me synimin e qartë të vendosjes së themeleve të arsimit shqiptar. Një akt i tillë ka qenë dhe mbetet përjetësisht një nga aktet ma sublimë edhe sepse ai dha frutet e veta në hapjen e shkollave shqipe, në rranjosjen e dëshirës për të mësue shqipen në të gjithë trojet shqiptare.

Prej shtetit të brishtë shqiptar, ende pa u formësue mirë si i tillë shkoi ndër mend dhe e bani punë të kryeme dërgimin te vëlleznit e një gjaku atë për çfarë ishte më e nevojëshme atje. Dërgoi mësues për të dhanë dije, duke plotësue kështu të nxanit e të mësuesit shqip si nevojë jetikë për ruajtjen e identitetit kombëtar të shqiptarëve të atjeshëm, të cilët historia e padrejtë i kishte shkëputë prej trungut të kombit e dheut âmë.

Në vijim të asaj ç'ka nisi ministri Koliqi, "në vitin 1943, pa u mbushur dy vjet, në Kosovë dhe në vise të tjera shqiptare në Maqedoni dhe Mal të Zi u hapën dhe punonin 511 shkolla fillore shqipe me 19 121 nxënës, të cilët i mësonin dhe edukonin drejt kombëtarisht 487 mësues (prej tyre 78 mësuese)... Ernest Koliqi kontribuoi edhe në hapjen e Normales së plotë në Prishtinë, në hapjen e Liceut në Prizren dhe Tetovë, në hapjen e Shkollës Normale në Gjakovë, të Institutit Teknik Bujqësor dhe Gjymnazit në Pejë" (Abdylaziz Veseli, Shkollat dhe Arsimi Shqip në Prefekturën e Prishtinës gjatë periudhës 1941- 1944, II, Gjilan 2003, fq 101.) (Romeo Gurakuqi: Gazeta Metropol).

Në një letër dërgue më 16 tetor 1941 konsullit shqiptar Kolë Rrota në Vjenë nga ministri i Arsimit të Qeverisë së atëhershme shqiptare, Ernest

Koliqi thuhet se ka angazhuar Norbert Joklin si organizator të bibliotekave të Shqipërisë me një rrogë mujore prej 600 frangash ari... Edhe si arsye madhore për ta shpëtue albanologun e shkëlqyeshem hebrë nga kthetrat e nazistave...

E gjithë ajo çfarë përfshin caku kohor i gati tri dekadave të pandërpreme, që përmbledhen në këtë libër të vëllimshëm asht "prozë poetike" e tija, siç e emërton me të drejtëpërgatitësi i librit, prof. Ndreca, aq moderne në stilistikë sa e gjithë proza e tij e shkurtëartistike, që, siç asht e njoftun u shenjue që në fillosat e veta si avantgardë e shkrimtarisë shqiptare të viteve '30 tëshekullit që shkoi. Po ka aty edhe shkrime ma të herëshme, *fletë të shkëputuna të një ditari të vjetër*, që ribotohen te "Shejzat". Ose shkrime të tjera që ishin botue ma parëte gazetata e fletoret e Tiranës, atyne viteve o te "Gazeta shqiptare" që delte në Bari të Italisë si, bie fjala, "Mëngjes në Kaninë" me 1935-en. Sikurse pena e njohësit me themel edhe të letërsisë së bashkëkombasve të vet, ndalë e i analizon me stimë e pa u kursye në qortime kur e sheh të nevojëshme; Mustafa Kruja, Medi Frashëri, Ndoc Nikaj, Fishta, Noli, Anton Harapi, Petrota e arbëreshë të tjerë. Ndalë përimitë në "Dy shkollat letrare të Shkodrës", ajo e françeskanëve dhe ajo e Jezuitëve Bashkë me rrespektin për gjithçka të vlerat, nuk ngurron me marrë n'dorë fshikullën e qortimit: *Mos të qitët Zoti me ta, sepse pingul u asht mbushë mëndja qi vetëm një pash u mbesin mbrapa Patër Gjergjit e Faikut në stil.*

E masandej te Migjeni në shkrimin përmbyllës të vëllimit: "Migjeni dhe unë", talentin e të cilit e kishte njoftë dhe përkrahë qysh në fillësë. Duke qenë pjesë e rëndësishme e redaksisë, Koliqi i boton për së pari poezinë "Të lindet njeriu..." në Fletoren "Iliria", në faqen e tretë, aty ku botoheshin firmat ma të njohuna letrare të viteve '30. Porse ai nuk e ndalë qortimin për ata të tjerë që e mitizojnë poetin e ri të talentuem. "Migjeni zën një vend të spikatun në radhët e shkrimtarëve tonë, por ia damtojnë nâmin ata qi hiperbolikisht e ngjisin në majen e Parnasit, ku mbretnon me dy-tre shokë të tjerë Fishta."

E kështu, e gjithë fasha e "Dritës së Shëjzave" vjen si një ylber shkrimor e stilistik që përshkon me dritën e yllësisë shpirtin e shkrimtarit të përpjestuem në dysh, në pezullinë që i diktoi përdhunshëm koha kur ai jetoi, andej e këndeje brigjeve të Adriatikut.

NGA "SHEKULLI I SHKURTËR" TE "KOHA E GJATË"

(Fragment nga vepra "Vreshti i Shopenhauerit në mushtin e "valleve" të Lasgushit)

Gersa RRUDHA

"Është shumë më e lehtë të dëshmosh defektet dhe gabimet e veprës së një shpirti të madh, se sa të mos japësh një shpjegim të qartë e të plotë të vlerës së tij. E kjo për shkak se defektet janë diçka e veçantë dhe e fundme, që mund të sundohen përsosmërisht. Ndërkohë që vula që gjeniu iu vendos veprave të veta, qëndron në faktin se madhështia e tyre është e papërshkueshme dhe e pamatshme. Për këtë arsye, edhe vetë këto vepra bëhen si ata mjeshtërit që nuk plaken për shekuj me radhë" (Shopenhauer; 801). Kështu e nis filozofi kritikën e tij mbi filozofinë kantiane, njërën nga shtyllat mbajtëse të gjithë sistemit të vet.

Vepra e Lasgushit po mbush një shekull jetë dhe duket se është më e gjallë e më me jetë se kurrë ndonjëherë tjetër. E megjithatë, asnjë poet si ai nuk ka krijuar një debat e një kontrast aq të madh idesh e pikëpamjesh sa vepra e tij. Ndodhi kjo në polemikën mes Kutelit dhe Malokit, vijoi me ato të Qosjes dhe Hamitit, ndonëse me kahe krejt të kundërta nga debati i viteve 30-të, për të mos përmendur më pas shumë kritikë shqiptarë të realizmit socialist. Këta të fundit, duke mos dashur t'i nxjerrin në pah vlerat, që t'i shkëlqejnë me më shumë siguri e qartësi, pjesa më e madhe u përqendrua më tepër te të metat dhe dobësitë.

I gjithë ky punim, përgjatë rrugëtimit të tij, arriti të na spikasë një anë shumë të debatuar dhe të kritikuar të tij: mungesën e prirjes sociale të poezive lasgushiane. Efektet dhe cilësitë artistike të përfaqësimit estetik të botës që ai krijoi në veprën e vet, ishin një përgjigje e vendosur ndaj kësaj qasje. Po kështu, traktati i dashurisë dhe



erotizmit, që në poezinë e poetit merr dimensionet e një projekti socio-psikologjik, janë një tjetër përgjigje e dhënë në këtë drejtim. Vetëm se po të hulumtojmë disa letra të rëndësishme nga epistolari i tij me Çabejin, do të kuptojmë se e gjitha kjo ishte pjesë e një projekti të mirë-menduar, gati të një programi, të një lëvizjeje të vërtetë. Në një letër të 3 tetorit të vitit 1927, poeti shkruan: "Së pari, duhet filluar sa më shpejt edukimi kulturalo-estetik i popullit shqiptar përpara se t'i japim atij vepra të fuqishme (të cilat më vonë do të ishte vetë poeti që do t'ia dhuronte letërsisë shqipe). Ky



edukim duhet të jetë më i fortë se ai i Europës. Kultura e kombeve evropiane qëndron në bazë nacionaliteti. Ne le të bëjmë që nacionaliteti i popullit tonë të qëndrojë në bazë të kulturës" (Moikom Zeqo;110).

Puqen në këtë pikë të parë, dy koncepte themelore të lëvizjes neoshqiptare që do të shpallte më 1928 Branko Merxhani nga shtyllat e gazetës "Demokratia" të Gjirokastrës. Vështirë të hamendësohet se këta dy korifej të kulturës shqiptare të mund të kenë komunikuar me njëri tjetrin, por domosdoshmëria e kohës shqiptare, gjenialiteti i tyre në rrokjen e ideve superiore dhe ndjenja e thellë e përgjegjësisë për fatet e kombit, i ka bërë që në dy kahe të ndryshme të mbërrijnë në të njëjtin përfundim. "Politikë s'ka, vetëm kulturë", kjo ishte thirrje-sfida apo motoja që Merxhani i vendosi lëvizjes së tij. Më pas, duke i shtjelluar këto koncepte, shpjegoi në një sërë artikujsh, nevojën jetike që kishte shoqëria shqiptare për të formuar kombin, pra për të kaluar nga popull në nacion.

Është sa befasuese aq edhe e mrekullueshme të gjesh në një tjetër letër të Lasgushit, parësinë e formimit të nacionit mbi bazat e formimit shpirtëror. Ja se si shprehet ai: "Kur ke tradicion, je Nacion, je Komb, jo popull, jo popullsi, jo popullatë. Një pjesë

e njerëzisë (që s'ka traditë), një grup njerëzor (që s'ka traditë) është masë, është turmë, është popull po nuk është komb, nuk është Nacion. Njerëzit, kur janë grup (pa traditë), s'janë Nacion (me traditë). Grupi s'ka fuqi shpirtërore dhe spirituale dhe materiale, është amorf. S'ka ekspresion special, s'ka zhvillim, evoluim, përparim, perfeksionim gjatë jetës së tij. Ay nuk mbush dot, nuk përmbush dot, nuk realizon dot veten e tij, vetëveten, për të vajtur drejt përsosjes. Domethënë ay nuk e jeton dot destinin e tij, misionin e tij për të cilin është lindur në këtë botë. Ay s'ka zhvillim, mbetet në vënd, në vënd nëmëro! Ay e fi llon jetën gjithnjë nga fillimi. Ay s'është njeri. Ay s'është, s'është fare, nuk ekziston" (Marie Poradeci; Korrespondenca).

Duket, pra, e shfaqur në mënyrë esklamative, prirja komb-formuese lasgushiane nëpërmjet ndjekjes së secili individ i kombit duhet t'i bëjë destinin të tij. Është sall kjo që realizoi poeti me veprën e vet. Megjithatë, e veçanta origjinale, autentike, proverbiale e gjithë këtij projekti që poeti kishte projektuar në mendje e pastaj në vepër, qëndron në komponentin e panderuar të edukimit estetik, që ai propozon menjëherë në pikën e dytë të këtij programi kur shpjegon: "Për edukimin e shijes estetike, duhet të marrim parasysht tri gjëra: rasën d.m.th. farë e fisin e popullit shqiptar, shoqërinë d.m.th. natyrën rreth e përçark, dhe influencën e saj mi rasën shqiptare, momentin, d.m.th. shkallën e zhvillimit në të cilën ka mbërritur populli i shqipes në kohën e sotme" (po aty). Është pikërisht dimensionin tridimensional i edukimit të shijes estetike shqiptare në rasë, në natyrë dhe në moment, përfundimi i natyrshëm i projektit më të madh që ciklet lasgushiane të poezive mund të kenë, aty ku përfaqësimi estetik shopenhauerian i botës lundron përmes së bukurës dhe sublimes natyrore të liqenit dhe të bukurës e sublimes shpirtërore "të vashës dhe trimit", të nositit dhe përjetësisë, të gjeniut dhe valles së yjeve. Ja, të gjitha këto ai kërkon t'ia mësojë brezave përmes shijes estetike që edukon vepra e tij. Aq më tepër që prej pikës së tretë të cilësorit të edukimit, ai arrin të nxjerrë një parim të tretë akoma dhe më impresionues. "Nuk na duhen poetët lokalë, që këndojnë epikë me frymë të ngushtë dhe partikulare (duke përmendur Fishtën). Këto kufij, kjo frymë duhet çarë dhe duhen përhapur me krijimin e një epeje monumentale, me horizontete të paanshëm dhe me gjenialitet universal" (po aty).

Është pikërisht ky përkufizimi më i lartë i idesë që Shopenhaueri e ka emërtuar si "përfaqësimi i



idesë së njerëzimit që kanos dhe i rri gjithnjë mbi krye gjenit” (Shopenhauer; 495). Po nëse se gjen te poetët e kohës së tij, ku vallë kërkon ta gjejë poeti këtë frymëzim kaq zenitor.

“Të fl uturojmë te Budi dhe Bogdani, ku gjejmë se qendra e botës është shumë më afër nesh se sa besojmë dhe ku shkëndijat kozmogonike përbëjnë thelbin e parë të makrokosmosit tonë, makrokosmos të varfëruar aq ligisht prej disa pseudo penda mjeshtrësh, që s’e kanë ndjerë kurrë nevojën e të ngriturit lart e më lart në regjionet e zeniteve dhe të etereve ...A e di se për çfarë kohe kanë folur Budi dhe Bogdani? Për një kohë kur në vend të shtazëve të sotme flisnin njerëz, në vend të njerëzve shenj-

torë, në vend të shenjtorëve profetë, në vend të profetëve sibila dhe në vend të sibilave fliste vetë inspirimi magjiplotë” (po aty).

Gjejmë këtu një ngjashmëri të këtij frymëzimi të magjishëm për të cilin flet poeti me atë të të parëve të tokës për të cilët flet Shopenhaueri kur trajton mos-shkuarjen me të njëjtin hap të nevojës metafizike me kapacitetin metafizik: “Duket se në kohët më të para të sipërfaqes tokësore, gjërat duhet të kenë shkuar ndryshe nga sot, dhe që ata, të cilët gjendeshin shumë më pranë nesh, në lindjen e gjinisë njerëzore dhe të burimit të parë të natyrës organike, kanë pasur, nga njëra anë, më shumë energji të aftësive intuitive, dhe nga ana

tjetër një dispozicion më të drejtë shpirtëror, duke qenë kështu të prirë ta rroknin në mënyrë më të thellë e më të drejtpërdrejtë thelbin e natyrës, për të qenë kështu në gjendje të kënaqin në mënyrë më të denjë nevojën e tyre metafizike. Kështu u formuan të moçmit e parë të brahmanëve, konceptimet gati mbinjerëzore të të cilëve u depozituan më vonë te vedat” (Shopenhauer; 1313).

Kemi të bëjmë me një paralelizëm të thekshëm të mënyrës së krijimit të dy kozmogonive, që poeti jo vetëm që i njeh thellësisht, por arrin të japë në mënyrë befasuese edhe parësinë e vet, kur thotë: “Kozmogonia e të madhit shqiptar (bëhet fjalë për tekstin e Bogdanit, që autori e ka konsultuar në Vjenë që në vitin 1924) arrin t’i bëjë ballë, me cilësitë e veta, kozmogonisë asiriane (banilonase), ashtu siç shihet në “Biblën” hebraike, por edhe kozmogonisë hindike, siç shihet në vedat e shenta” (Moikom Zeqo; 192).

Çdo popull ka një kohë në të cilën shfaqen për të njerëz të mëdhenj, që përfytyrojnë mendjen dhe shpirtin e atij kombi, njerëz që bëhen udhëheqës dhe shembull për miqtë e tyre, duke lënë gjurmën dhe vazhden e vet mbi karakterin dhe fatin e vendit. Kjo kohë në çdo vend quhet “shekulli i madh. Një term të tillë, në lëmin e mendimit dhe intelektualitetit shqiptar, do të përdorim edhe ne për veprën, idetë dhe projektin e shqiptarizms moderne, që hapën mendimtarët dhe letrarët e mëdhenj të viteve 30-të për zhvillimin kulturor-shoqëror dhe emancipueso-edukativ të gjithë shoqërisë shqiptare. Dhe një nga yjet e mesit në konstalacionin e gjithë yjeve të këtij shekulli të shkurtër, shfaqet me një projekt të tillë edhe Lasgush Poradeci. Veprimi i tij për gjatë gjithë jetës kah destinin që mendonte që i ish caktuar, bazohej në krijimin e traditës si bazën kryesore të komb-bërjes. Për të, “tradita, ky potencial kolosal i brumosjes së nacionit, ka një kusht: të jetë e shkrojtur. Se fjala e shkrojtur e shumëfishon, e qindfishon veprimin e saj, e mijëfishon e milionfishon. Ajo, e shkrojtur, bëhet verb, bëhet e pushtetshme, bëhet e shentë, divine, divinisohej”.

Është pikërisht ky ai ideal transcendental që kemi shpjeguar të jetë ylli polar i gjithë projektit të tij letrar. Në letrën me temë “të jemi njerëz të vepërimit”, të shkruar në prill të vitit 1931, ai e konkretizon në mënyrë të mrekullueshme këtë mision. “Kombi jonë (si çdo komb tjetër, si çdo botë tjetër në këtë gjithësi) rron me anën e fuqive krijonjëse të tij.

Po ti o mik, a e ndjen një dritë universale në shpirtin t’ënd? Ajo dritë, është fuqia jote krijonjëse!

Ajo dritë, është fuqia ime krijonjëse! Ajo dritë, është fuqija e zotit krijonjëse! Ajo dritë, është drita e përjetësisë, malli i pasosur, i mbarsur me shkëlqim, i aktivuar me principin pozitiv, mall i cili rigjeneron botën, duke mposhtur, duke anuluar gjithë çfaqjet e saj të errëta, për të triumfuar më në fund edhe përsipër të gjithave me krijimin origjinal të mijërash e qindra mijërash posibilitetesh të reja afirmimi...jete...drite të padukshme”(Marie Poradeci; Korrespondenca).

Shfaqet kështu akoma dhe më qartë se malli i pasosur dhe drita e përjetësisë, e konceptuar në funksion të vepërimit dhe projektit të edukimit kulturor-estetik përbën besimin, idenë, filozofinë e tij, duke filluar që nga fillimi gjer në fund, që te “Parafjala” deri te “Gjeniu i anijes” apo dhe te “Vallja e përjetësisë”.

Le ta shoqërizojmë këtë konceptim me një tjetër parim të shpallur haptazi nga ana e poetit kur thotë: “Për gjërat e mëdha duhet një vleftësim në kohë të madhe. Kohës së madhe i thonë kohë e gjatë, dhe kohë e gjatë i thonë asaj që nguror, që bën prej guri, monumentet e manifestimit të vlerave shpirtërore, të cilat përbëjnë kulturën e një populli” (Marie Poradeci; Korrespondenca). Gjithë vepra e Lasgushit në vetvete si program, të gjitha traktatet e shijes estetike, të dashurisë, të trinitetit transcendental apo të përfaqësimit estetik të botës, që kemi parashtruar në këtë punim, janë një monument i atyre vlerave të popullit që për t’u manifestuar kanë nevojë për një edukim të vazhdueshëm, kurse ai vetë, ai mjeshtri i madh që ndriçon bekimisht gjithë makrokozmosin dhe mikrokozmosin shqiptar.

Se i ç’lloji është ky edukim, e rrëfen përsëri poeti me anë të këtij pohimi: “Unë nuk shkruaj për famën e momentit, të cilën e urrej, por për t’i ndihmuar emrit shqiptar. Emrit shqiptar i ndihmohet vetëm me vepra hije-rënda, të atilla që janë mbarsur me virtytin e një fuqie edukimi vazhdonjës në të ardhmen e kombit” (Lasgush Poradeci, Korrespondenca).

Ja, ky edukim i vazhdueshëm i kombit, i kapitalizuar në të gjithë veprën e tij hije-rëndë është ajo kohë e madhe, ajo kohë e gjatë që Lasgushi i dhuroi emrit shqiptar. Ai e la të shkruar me veprën e tij këtë potencial të brumosjes dhe formimit të karakterit të kombit.

Tani i mbetet kombit ta shumëfishojë, duke e mishëruar tek secili prej individëve të vet, këtë potencial, për ta milionfishuar atë tek çdo njeri që e flet dhe e shkruan këtë gjuhë.

TREGIME MALLI, KUJTIMESH DHE REFLEKTIMI

(Shënime për librin "Lotët e natës" (tregime), autori: Moisi Zaloshnja, redaktor: Halil Qendro, korrektore letrare: Neka Turkeshi, piktore: Dolli Gjinali, redaktor teknik: Adem Lita, tirazhi: 10.000 kopje, N. Sh. Botimeve "Naim Frashëri, Tiranë 1963)

Xhahid BUSHATI

Libri me tregime "Lotët e natës" i shkruarit Moisi Zaloshnja, është një vepër që pasqyron botën shpirtërore të njeriut të thjeshtë shqiptar, plagët sociale, kujtesën e fëmijërisë dhe dramën morale të individit. Tregimet mbajnë një frymë realiste, emocionale dhe shpesh lirike. Ky është një nga librat e fëmijërisë sime. Në faqen e brendshme kam shënuar emrin dhe mbiemrin (me stilolap), Nr. 3, 1964. "Lotët e natës" ka një simbolikë të thellë psikologjike dhe shoqërore. 'Lotët' simbolizojnë dhimbjen e brendshme, pendimin, mallin, ndërgjegjen njerëzore, pastrimin moral. Ndërsa 'Nata' simbolizon vetminë, vuajtjen, heshtjen shpirtërore, kohët e vështira njerëzore e shoqërore. "Lotët e natës" paraqet dhimbjet që njeriu i mban të fshehura, plagët morale që nuk duken gjatë "ditës", botën e heshtur të shpirtit njerëzor. Titulli krijon një atmosferë meditative, të trishtë, por edhe humane. Në shtatë tregimet, personazhet përjetojnë konflikte të brendshme dhe natën përballen me ndërgjegjen e tyre. Kështu, nata bëhet vendi i reflektimit dhe i së vërtetës shpirtërore. Tregimi i parë, që hapet dhe libri titullohet "Kosheret e bletëve". Paraqitet historia e dy koshereve bletësh, ku Veseli i kishte gjetur në dy zgërbonja



lisi sipër në mal. Pas bisedës me të shoqen Nazmijen, djali i tyre i vogël, Bimi, jo vetëm pyeste pa reshtur për bletët, por s'i durohej të hante dhe mjaltin e tyre. Por, shpejt ëndrrat nuk u realizuan për Bimin, motrën Lumen dhe familjen e tij, sepse erdhën armiqtë, shkatërruan kosheret dhe bllaqiteshin duke ngrënë hoje. Autori nënvizon tragjedinë e kësaj familjeje të varfër. Tregimi i dytë "Kujtime fëmijërie", ku personazh ishte Hasani i Mukes. Edhe këtu paraqitet historia e

varfërisë së Hasanit dhe e kasolles së tij. Një rrëfim real që e ndjek edhe dhimbja e shkrimtarit. Ky tregim ka dhe një linjë interesante, siç është lidhja me vendlindjen dhe familjen. Autori rikthen botën e fëmijërisë. Tregimi mbart një ton lirik dhe emocional. Kujtesa nuk është vetëm rikthim në të kaluarën, por edhe mënyrë për të kuptuar identitetin njerëzor. "Lotët e natës" është tregimi i tretë, por, edhe që mbart titullin e librit me tregime. Përralla që tregon babagyshi vjen si kohë nga legjenda, ku një nënë kishte dy vajza Ditën dhe Natën. Në fund të përrallës-legjendë, optimizmi mbetet funksional për të shpëtuar dhimbjen e nënës. Mbase, ky tregim është ndër më psikologjikët. Duke ruajtur simbolikën "rreth vatrës", gjyshi, duke marrë shkas nga një gabim i të sjellët keq me nënën, gjyshi tregon një përrallë (histori) të një plaku, që mbeti i vetmuar dhe e vetmoi edhe më shumë i biri. Pas shumë vitesh, i biri (mbret) dërgon ushtarët e tij për të marrë babain e tij. Edhe, tani, ai sillet keq, shumë keq! Dhe është ky dialog:


- "A më njeh, o plak?"

- Jo, nuk të njoh, - përgjigjet plaku.


- Unë jam yt bir, jam ai djali që t'i i thoshje gjithmonë: "Ti nuk je njeri! Ti nuk je njeri!" A e sheh se tani qenkam njeri e u bëra mbret?

"I jati e njohur të birin, e vështroi drejt në syve, i ngriti shkopin e kërcënoi dhe iu përgjigj: - Mbret je bërë, or bir, por njeri nuk je bërë edhe! Jo, bir, ti nuk je njeri! Se po të ishe njeri, do ta nderoje tët at dhe nuk do ta sillje këtu kështu si e solle! - Dhe i tregoi këmbët që i kullonin gjak."

Veçanërisht me disa tregime te fundit, shkrimtari Zaloshnja analizon emocionet, konfliktet Kaq i foli plaku, - vazhdoi gjyshi, - e asnjë gjysmë fjale më shumë. Pastaj brofi më këmbë e fryu në kasollen e tij, ashtu këmbë e zbatshur siç pat ardhur". Një tregim plot emocione për familjen, traditat, ngrohtësinë njerëzore e komunikim brezash. Në tregim shfaqet rëndësia e rrëfimit, respektit për të moshuarit, ruajtjes së lidhjeve familjare. Te tregimi "Pendimi" është historia e hartimit të Dëfrimit. Kemi të bëjmë me një "bisedë" në ndërgjegjen e tij, për një gabim të tij, më pas me falje dhe rikthim të dinjitetit, kur mësuesja i thotë:



"- Ti ke bërë një hartim të bukur se ke ndjenja të pastra." Me personazhin kryesor, Dëfrimin, autori do të na thotë se njeriu mbetet njerëzor vetëm kur arrin të pranojë fajin. Kurse në tregimin "Ah, Nënë, moj" kemi tre personazhe: xha Lushi, nipi i tij, Agimi dhe sentenca "Ah, nënë, moj!" Autori na rrëfen historinë e xha Lushit, dashurinë e tij për nënën, mallin, sakrificën e saj prindërore dhe dhimbjen familjare. Figura e nënës paraqitet e dhembshur, sakrifikuere, morale, mbrojtëse. Tregimi mbart nota elegjiake dhe prekëse. Nëna bëhet simbol i dashurisë së pakushtëzuar, i qëndrueshmërisë shpirtërore. Ndaj dhe shprehja universale e xha Lushit mbetet e pavdekshme: "Ah, nënë, moj!" Kurse tregimi i fundit është me titull: "Njolla e zezë". Është historia e Ilirit, historia e njollës së zezë, e cila edhe pse kanë kaluar disa vite, ai nuk e ka harruar. Është një faj moral, turpi, është gabimi që ndjek fëmijën dhe bren ndërgjegjen e tij, ndërgjegje që nuk e lë rehat. "Njolla e zezë" është simbol i mëkatit, i turpit moral, i së shkuarës që nuk harrohet. Tregimi ka karakter psikologjik dhe




moralizues. Personazhi përpiqet të çlirohet nga barra e së kaluarës morale, ndërgjegjen njerëzore. Personazhet nuk janë heroikë në mënyrë të jashtme; drama e tyre zhvillohet brenda shpirtit. Autori përdor fjali të qarta, dialog jete, përshkrime të ndjera. Kjo e bën tregimin të afërt e njerëzor. Në shumë tregime ka nostalgji, mall, meditim, ndjeshmëri poetike. Peizazhi dhe nata shpesh lidhen me gjendjen shpirtërore të personazheve. Autori beson te përmirësimi moral i individit. Tregimet zakonisht ndërtohen në tri pjesë: a) Paraqitet ambienti, shfaqet kujtimi ose nis konflikti fillestar. b) Zhvillimi, ku shtohet tensioni emocional, e personazhi përballet me problemin moral ose shpirtëror. c) Mbyllja vjen me reflektim, me një përfundim emocional ose moral, shpesh me ton meditativ. Fundet nuk janë gjithmonë të lumtura, por zakonisht lënë pas një mësim, një ndjesi humane, një reflektim moral. Kurse teknikat e vizatimit të personazheve kryesorë janë të prirë drejt përshkrimit psikologjik, drejt dialogut, drejt kujtesës dhe monologut të brendshëm (Shpesh personazhet rikujtojnë, reflektojnë, flasin me veten. Kjo e afron prozën me analizën psikologjike.

Ka çaste kur njeriu hesht para botës, por brenda vetes shpërthen si stuhi. Pikërisht këto momente sjell libri "Lotët e natës" i Moisi Zaloshnjës, një vepër që depërton në shpirtin njerëzor dhe zbulon plagët e fshehta të jetës. Nata në këtë vepër nuk

është vetëm errësirë fizike. Ajo është koha e mendimit, e vetmisë dhe e përballjes me ndërgjegjen. Në heshtjen e natës, personazhet kujtojnë të kaluarën, ndjejnë mall për njerëzit e dashur dhe vuajnë për gabimet e bëra. Lotët e tyre janë të heshur, por të rëndë sa vetë jeta. Moisi Zaloshnja krijon personazhe të thjeshta, por shumë njerëzore. Ata nuk janë heronj të mëdhenj; janë njerëz që gabojnë, pendohen, duan dhe vuajnë. Pikërisht kjo i bën të afërt për lexuesin. Në tregime, si "Pendimi" apo "Njolla e zezë", autori tregon se njeriu nuk mund të shpëtojë nga ndërgjegjja e vet. Gabimi mbetet një njollë që vetëm pendesa mund ta zbusë. Ndërsa në tregime si "Ah, nënë, moj!" dhe "Rreth vatrës", shfaqet dashuria familjare dhe ngrohtësia e shtëpisë shqiptare. Figura e nënës dhe e vatrës bëhen simbole të dashurisë, kujtesës dhe mbijetesës shpirtërore. Gjuha e autorit është e thjeshtë, por e mbushur me ndjenjë. Ai nuk kërkon madhështi artificiale; fuqia e tij qëndron te sinqeriteti emocional dhe te vëzhgimi i shpirtit njerëzor.

"Lotët e natës" mbetet një libër me vlera humane e psikologjike, sepse flet për dhimbjet që i përkasin çdo kohe: mallin, fajin, dashurinë dhe nevojën e njeriut për mirësi. Nëpërmjet lotëve të natës, lexuesi kupton se zemra njerëzore mbetet gjithmonë vendi ku ruhen e vërteta dhe kujtesa më e thellë e jetës.

POETI NË VORBULLAT E NJË KOHE



Natyra e tij ishte e prirë për pikëllim dhe dhembshuri. Kishte ngjarë që ai duke ecur rrugës, të ndalej papritmas para ndonjë fëmije dhe, duke e përkëdhelur, t'i thoshte prindit të fëmijës: Keni kujdes për vogëlushin, ku lutem, mbajeni për dore

Armend BEKAJ

NJË TAKIM I PAVETËDIJSHËM ME XHAXHIN MIRKO

A i ishte një fëmijë krejt i vogël, kur gjatë një shëtitje me babin e vet nëpër rrugët e qytetit të betontë, të qytetit pa lum, u takua për herë të parë me Mirkon. Pasi që babai foli me Mirkon, si shok që e kishte, ai i prezantoi fëmijën. Para vogëlushit po qëndronte një njeri i veshur i tëri me të zeza dhe, si për ta bërë pothuaj të padurueshme atë paraqitje të ashpër për fëmijën, ai kishte edhe një mjekër të gjatë, të hatashme. Vogëlushin e frikë-

soi paksa pamja e jashtme e atij njeriu. Por, ai u qetësua menjëherë kur xhaxhai iu afrua dhe e përqafoi...

Atëbotë vogëlushi e mori vesh nga babai i tij se ai xhaxha (emrin e të cilit fëmija aty për aty nuk mundi ta mbante mend) ishte poet, se ai shkruante poezi, ishte aq i vetëdijshëm për domethënien e fjalës "poet", saqë mezi e konceptonte si të tillë në mendjen e tij ferishte. Më pas, kujtimi për atë xhaxha shpesh i përzihej me skena të tjera të fëmijërisë, i mjegullohej, si çdo kujtim që ngulitet në mendje si i veçantë, të cilin largësia e viteve e shtreson me mjegull. Megjithatë, nga kujtimet e shquante gjithnjë në bazë të pamjes së

tij të ashpër dhe ndjeshmërisë së tij të lartë, tipare këto që i mbetën në kujtesë. Ishin këto tipare të çuditshme dhe kundërthënëse njëra me tjetrën, të cilat pikërisht për shkak të kundërshtisë së tyre të pazakonshme e bënë vogëlushin ta veçonte takimin me atë njeri, si një ngjarje e madhe e fëmijërisë së tij, dhe ta ruante në imagjinatën e tij të ndezur kujtimin për personin e xhaxhit Mirko.

PIKËLLIMI GRACIOZ I POETIT

Natyra e tij ishte e prirë për pikëllim dhe dhembshuri. Kishte ngjarë që ai duke ecur rrugës, të ndalej papritmas para ndonjë fëmije dhe, duke e përkëdhelur, t'i thoshte prindit të fëmijës: Keni kujdes për vogëlushin, ku lutem, mbajeni për dore.

Në rrethet ku ai rrinte janë të njohura shumë ndodhi interesante nga jeta e tij. Është bërë pothuaj proverbiale fraza e tij kur ai, me të hyrë në kafene, i thotë një vashë të re: "Zonjushë, kurrë mos u ngritni që t'i flitni mashkullit, qoftë kjo edhe për Mirko Gashin", një vashë e cila, nga respekti, po ngrihej në këmbë që të njoftohej me të. Fraza të tilla që përskoheshin nga një humor i mprehtë, i përzier shpesh me një pikëllim gracioz, ishin karakteristike për të, dhe mbeteshin në vetëdijen e njerëzve. Ishte një rast tejet interesant, kur ai i uron fejesën një të riu me një fjalë të vetme "Ngushëllime", me ç'rast nuk linte vend për hidhërim të çonte peshë tërë qenien tënde për të kuptuar nëntekstin e frazës dhe ti mund të kalojë shumë vite me mendimin e asaj fraze në kokë pa zgjidhur asgjë.

RROKULLISJA E JETËS SË POETIT DHE E GOTËS SË VERËS


Është i njohur fakti që në jetën e Mirkos vend të veçantë rezervohej për kafenetë e Prishtinës, me gotën e verës pranë. Aty shpesh do t'i vinte frymëzimi i përpunuar gjatë në mendje për ta bërë një vjershë që do të rëndonte qëndrueshëm. Jeta e tij nuk ishte e rregullt, e rehatshme, jo, ai në një jetesë të tillë, shkurt, nuk e ndiente veten komfort edhe nuk mundte, sepse ishin disa plagë në shpirt të tij, disa shqetësime që e ngisnin vazhdimisht. "E ti urith humbe rrugën në plagë, është varg i tij që mbase e ka menduar pranë gotës së verës, ku disponimi ndërrohej shpejt dhe në mënyrë jo të zakonshme. Ai mund të ishte qetë dhe aty për aty te qante, apo e kundërta, krejt kjo brenda disa çasteve, që japin një pasqyrë reale të vorbullave dhe te kaosit të tij shpirtëror. Ai sikur

në shpirt të kish pasur një brengë, një dhimbje të vazhdueshme, kaotike dhe të mjegulluar, që nuk e linte të çonte një jetë normale. Sepse ai çrregullim kaotik përcillej me pas edhe në jetën e tij. Dhe si rezultat i kësaj mjegulline, te ai mbarsej dhe pille vargu që kishte domethënie dhe që peshonte. Këtë shqetësim të tij shpirtëror, ai sikur e thotë edhe vetë. "Mori tingujsh/ Të parregullt melodie e prishin". Si fryt i mjegullinës së tij dilnin pastaj kuajt e Apokalipsës (frika, uria, murtaja, lufta, vdekja) dhe vraponin në formën e vargjeve për të treguar atë shkreti që bëjnë ata mbi njerëzimin

Jeta e tij e përvuajtur, vetëflijimi prej artisti të njëmendtë, që kupton se arti është i vërtetë nëse "Çdo gjë që bën vdekjes përngjan/Çerdhe syne e ke/ Shpezët zogjtë i ushqejnë në të". është admirim sidomos për te rinjtë. Për arsye se të rinjtë janë ata që i përkrahin dhe i kuptojnë më së miri lotët e tij të pikëllimit, që aq shpesh e përnjëhershëm i rrokulliseshin faqeve e që sikur demonstrosnin rrokullisjen e tij në jetë (një vetësakrificim i tmerrshëm, ekstrem). Se gjersa të rinjtë, nga dëshira që të kenë një art të këtushëm të mirëfilltë, hasin shpesh vetëm në dëshpërim dhe në zhgënjim total ndaj tij, ata gjejnë një rehabilitim të këtij arti të pikëllimit i lëngshëm i Mirkos. Shkaku i zhgënjimit të të rinjve nga arti i këtushëm nuk qëndron ndoshta aq te fakti se a jenë me vlerë ato vepra apo jo, sa është në atë që ajo nuk ngjan aq fort me artistiken, është disi falso. Mirkoja bën mbushjen e këtij boshllëku te ne. Sepse ky e posedonte disponimin e artistit të sotëm modern. Dhe kjo u duhej të rinjve, një poeti mirëfilltë bashkëkohor evropian. Si duket, ky ishte njëfarë qëllimi i tij më i lartë: një poezi, thënë metaforikisht e ngjyer me gjakun e tij, qëllim që sa që gjallë nuk ia kuptuan, si ndodh tekefundit me çdo artist te veçantë. Sepse ai gjakonte vargun e vet: "Është drenusha e fjetur kaheër/ Që e zgjon/ Për t'ia falur gjumin.

PËRZIERJA LASGUSHIANE DHE PREVERIANE

Si duket, në jetën e tij ndikim kishin Lasgush Poradeci me vetëmohimin e tij dhe bohemi francez, Zhak Prever. Ata që e kanë njohur mirë, thonë se jo se ai ishte krejt origjinal. E nëse edhe ka pasur farë ndikimi, atëherë ai ndikim vetëm do të gjente vendin e përshtatshëm në artin e Mirkos, duke u adaptuar, asimiluar dhe shtjelluar si një gjë autoktone e tij. Sepse këto gjëra i përputheshin dhe i shkonin për shtati natyrës së Mirkos. Mbase edhe ka qenë krejt origjinal, kurse këto cilësi të



Mirko Gashi

EPITAF

Në kohë kur të vërshon gëzimi
në vorbullën e tij është pikëllimi.

tij, si vetëflijimi i bohemia, të gjetura edhe te artistë tjerë, s'janë veçse pika të përbashkëta apo dalluese për artistin e mirëfilltë.

Një thirrje "Ave Mirko" do t'i shkonte për shtati, sepse poezia e tij e matur që rëndon si shkëmb, e mbrojtur nga vetëflijimi lasgushian dhe bohemia preveriane, sillet zhurmshëm vorbullave në kohën kur arti i këtushëm sikur është në fikje në ca raste, që anon edhe kah mediokriteti.

NOKTURNO

Sidomos në vitin e fundit të jetës së vet, ai do të ketë ndier perëndimin e tij të shpejtë dhe boshllëkun që do të linte në shoqëri, sepse shpesh kur do të fliste me të njohurit, do të pikëlluhej, duke thënë se së shpejti do të mbeteni pa mua. Për ata që nuk e pëlqenin mënyrën e jetesës së Mirkos, ai tani që nga varri prapë mund t'u hedhë shikime të ndjeshme dhe pikëlluese (sikur u thotë ende i

përfillni paragjykimet meskine për jetën time?"), dhe t'u tregojë vargjet:

në shëmti

në bukuri

lajmëron lindje e vdekje njëherit.

Sepse vdekja sikur e paralajmëron jetën e tij të serishme, rilindjen e tij me anë të veprës. Vargjet e lartuara shërbejnë njëherësh çuditërisht edhe si profeci për fatin e veprës që la Mirkoja. Sa me larg jetës së tij të çrregullt, e cila për shumë ke ishte pengesë dhe vello që të mos dilte në pah poezia e tij, aq më zëshëm gurgullon ajo vorbullave të saj, ashtu e pastër, pa paragjykime për jetën e tij.

Dhe Mirkoja tani sikur thërret, duke deklamuar:

Gëzohu ujë, këtë mrekulli të çmendur ti e ke krijuar

(Bota e Re, 1990)

NË SHIRITIN E KOHËS

NIKOS ENGONOPOULOS DHE ELBASANI



Nikos Engonopoulos (1907-1985), shkrimtari dhe piktori surrealist grek i viteve 1930, ka shkruar për Elbasanin. Ai dhe disa shkrimtarë të tjerë të brezit të viteve 1930, kanë shkruar për Shqipërinë, sepse kanë qenë të mobilizuar në frontin e luftës nacionalçlirimtare

Nga Prof. assoc. dr Maklena NIKA

Sot do të rrëfej përshtypjet e mia nga Shqipëria. Dhe mbi të gjitha, më duhet të deklaroj se nuk ka gjë më të thjeshtë se të shkosh në këtë vend. Por, për këtë qëllim, dikujt i duhet të presë festën e Shën Janit në verë. Vetëm atëkohë, ndërsa erret, nostalgjiku i vendeve të largëta, duke kër-

cyer mbi zjarre, mund ta gjejë veten në çdo qytet që ka dëshiruar.

Unë dikur, në një ditë vetmie të dhimbshme, një ditë të cilën e kisha jetuar larg zogjve, kapërceva, ndërsa muzgu ra, zjarret e ndezur në një fqinjësi të Athinës, me pasionin e thellë të Shqipërisë brenda zemrës sime. Kapërceva një, dy zjarre. Asgjë. Herën e tretë, papritmas u gjenda në Elbasan.

Elbasani është një qytet i madh dhe mund ta përshkruaj me shumë hollësi nëpërmjet një kënge - sigurisht me një gjuhë të panjohur - mbi tri nota muzikore të njëpasnjëshme, monotone, të pandryshueshme, që lypësi i verbër i luante me në fyell në cep të rrugës, nga mëngjesi deri në mbrëmje.

Sokakët - në Elbasan - janë tmerrësisht të ngushtë, dhe nga çdo anë lartësohen mure të zhveshur, të lartë, që duken sikur prekin qiellin. Kurrkund nuk sheh asnjë degë peme.

Këtë qytetërim e vështroja me kërshtëri të madhe. Brenda zemrës sime mbizotëronte qetësia dhe ndër dhëmbë këndoja një këngë vegjëlie.

Njerëzit që takoja gjatë rrugëtimit tim, ishin të veshur me fustanella që preknin tokën. Hapi i tyre ishte i ngadaltë, madhështor, siç është gjithmonë në Lindje. Disa kishin qeleshe të bardha në kokë, dhe të tjerë kapele tragjike të mëdha femërore, me krahë.

Por papritmas, një ankth i pashpjegueshëm më kaploi zemrën. Këta njerëz nuk kishin sy! I kisha parë me vëmendje: tashmë më shqetësonte vështrimi i tyre! Frika më ndali në vend, më gozhdoi për njëfarë kohe, mbeta pa fjalë. Dhe kur munda disi të lëvizja, të vrapoja, të kuptoja fundja, pashë i tmerruar, ndërsa rendja pas tyre, se ndërsa ata merrnin kthesën, humbnin si ëndërr... Humbnin për t'u shfaqur sërish, në cepin tjetër, aty ku kishin qënë më parë, për të vazhduar të qetë shëtitjen e tyre të neveritshme.


Nuk kishte më asgjë të dyshimtë. Një tradhti e padëgjuar më parë po më mashtronte. Kuptova se kisha rënë viktimë e mjerë e një kurthi të tmerrshëm dhe të turpshëm. Pa e kuptuar përmasën e të gjithë gabimit tim, u ula menjëherë përtokë dhe shpërtheva në dënësë.

Kjo është një pjesë e përzgjedhur dhe e përkthyer nga proza poetike e titulluar *Udhëtim në Elbasan* që Nikos Engonopoulos (1907-1985), shkrimtari dhe piktori surrealist grek i viteve 1930, ka shkruar për Elbasanin, por jo e vetmja. Ai dhe disa shkrimtarë të tjerë të brezit të viteve 1930, kanë shkruar për Shqipërinë, sepse kanë qënë të mobilizuar në frontin e luftës nacionalçlirimtare. Mund të themi pa frikë, se Nikos Engonopoulos, poeti surrealist i pasionit dhe i poezisë, si e karakterizon Nanos Valaoritit, krijon një panoramë të re dhe të diferencuar, sigurisht me ngjyrimë të forta surrealistë për qytetin në zemër të Shqipërisë, që në atë kohë nuk ishte një qytet i thjeshtë, i padëgjuar, por ku vloi përhapja e dijes

dhe e gjuhës së sotme shqipe nga themeluesit e Normales së Elbasanit.

Nikos Engonopoulos është një rast i veçantë në letrat greke. Ai nuk imitoi asnjë poet bashkohës të tij, përvetësoi me mënyrën e tij origjinale dhe e shprehu po me këtë ritëm surrealistin dhe doktrinën e tij, të ndikuar nga praktikatat e *Guillaume Apollinaire*, por dhe të romantikëve *Charles Cros* dhe *Xavier Forneret*. Ai të krijon përshtypjen se vjen nga një traditë e largët e shekullit të 18-të, dhe këtë e përcjell me artin e tij krijues në letërsi dhe pikturë. Ai konsiderohet si piktori i figurave mashkullore antike, si Orfeu, Hermes, Odisea, etj., por që pas këtyre maskave fshihet vetë "poeti mistik", format femërore të të cilave shprehin besimin e tij të thellë te koncepti "femër". Madje, elementi femër ndryshon dhe rrjedhën e vetë rrëfimit në këtë prozë poetike. Kthesa është e menjëhershme dhe e papritur për këndvështrimin e poetit të gjendur në Elbasan, kur ai konstaton trishtueshëm se kapelat mashkullore ishin me trajta femërore dhe me krahë, imagjinata e tij kthehet në tragjike për vazhdimësinë e rrëfimit. Papritmas, burrat me fustanellat që preknin tokën, nuk kanë sy, dhe krijohet kështu një sfond i frikshëm për lexuesin.

Ai kishte një frymë të thellë surrealistë brenda tij, dhe jetonte sipas filozofisë së saj. Ai kombinon në mënyrë të veçantë eksperiencën e tij si lexues me atë të vetë jetës së tij dhe prodhon një fjalë poetike të përcaktuar mirë për qëllimin e shprehjes së tij surrealistë. Imagjinata e tij, edhe pse në frontin shqiptar të luftës, e çonte shumë larg ekzistencën e tij, deri në vdekje imagjinare. Dhe kësaj panorame, i shtohet sërish Elbasani dhe domethënia e tij për poetin. Në një prozë tjetër poetike, me titull *Maria e natës* ai shkruan: "...ditën tjetër pas vdekjes sime, mora të lexoja gazetën për të mësuar më shumë mbi hollësitë e ceremonisë së varrimit tim. Kufomën time e kishin hedhur larg. Në atë kohë unë gjendesha në Amerikën e Jugut, në Pire, thjesht ndodhesha në Elbasan në Shqipërinë...". Pse ky poet grek identifikon vdekjen e tij pikërisht me këtë qytet? Jo më kot, poeti surrealist dhe psikoanalisti grek *Andreas Embeirikos*, e cilëson poetin si mrekullinë e Elbasanit dhe të Bosforit. Ai përfaqëson poetin e helenizmit që ka gjetur strehë në skenën kozmopolite. Kur *Andreas Embeirikos* shkruante në 1945 te *Vendi i shkretë*, titulli i së cilës është përkthim *mot à moti* veprës me të njëjtin titull të *Thomas Eliot*, për transatlantikun e madh që do të nisej për udhëtimin e çlirimit të



botës së brendshme të njeriut, dhe *Engonopoulos* si me magji, ndërtoi qytetërimin e tij ideal në malet shqiptare, një qytetërim surrealist. Por, mund të gjejmë dhe pak realizëm brenda këtij rrëfimi, duke iu referuar lidhjeve të tij me Shqipërinë, nga nëna. Ai madje, nuk do të ngurrojë që të paraqesë në pikturat e tij dhe panoramën elbasanllie të kohës, dhe figurën e të madhit Skënderbe. Te poema e tij shumëvargëshe *Bolivar, një poemë greke*, që konsiderohet si poema moderne e lirisë, brenda atmosferës së skllavërisë, shpallset përpara nesh një teatër i zgjeruar jete - me qendër statujën e lirisë, dhe në vijim, përshkallëzimet e realiteteve dhe surrealtiteteve, të paraqitura dhe të skalitura intuitivisht, bregdetet greke, Maqedonia, Shqipëria etj...

Ndoshta ishte rastësi si mijëra rastësi të tjera, që ai vizitoi Elbasanin me të njëjtin sy nostalgjik dhe ngashërim të përmbajtur që i shkaktonte kujtimi i *Hans Sachs* dhe *Schumacer*, dhe u impresionua kaq shumë nga ky qytet, nga njerëzit dhe kuadri i tyre natyror. "*Kërcimtarë shqiptarë mendojnë t'i kthejnë energjitë e tyre në drejtime të reja, në mënyrë të tillë që fëmijët të mos kuptojnë asgjë nga hidhërimet dhe nga zhgënjimet*

e jetës. Të mos kuptojnë asgjë përpara se t'u vijë koha!". Kjo është fjalia që fillon poezia *Lugina me njerëz* e përmbledhjes së tij të parë poetike *Mos i flisni shoferit* (1938). Përshkrimi i tyre në prozë të kujton figurën e të gjithë shqiptarëve në çdo zonë të Shqipërisë. Për autorin, Elbasani i përket peizazheve të vdekura dhe fatit të endacakut, dhe jo heroizmit të Heshtjes së Pedaleve, jo ekzotizmit të *Marakambos* dhe absolutisht jo nderimit që kishte për *André Breton*, *Pablo Picasso* etj.

Në sokaket e Elbasanit, poeti nuk mbart me vete mohimin e vdekjes. Qyteti është vetë vdekja për poetin grek, sepse ai arrin të prishë dhe logjikën dialektike të tij. Ai e gozhdon dhe i vjedh fjalët, prodhon marifete fishekzjarrësh, fjalë fosforeshente dhe idhuj në pasqyrë ku ideja e kufomës mund t'a qetësonte, pas drithërimeve ekzistencialiste dhe pas konstatimeve se kufoma e tij ndodhej diku larg në kënetë... Sokakët e Elbasanit e deformojnë dialektikën e poetit, ashtu si deformon dhe nostalgjia marshin kumbues të së ardhmes dhe poezia të lumturin. Frika e Elbasanit është një ditë e një vetmie të dhimbshme, një ditë larg zogjve dhe larg mikut të tij të zemrës *Guillermo Cixi*. Sokakët e Elbasanit janë të ngushta

dhe nga çdo anë lartësohen mure lakuriq, të lartë, që arrijnë deri në qiell. Nuk sheh askund pemë ose degë pemësh, shkretëtirë shpirti, e paraqitur me dhimbje që ndihet deri në palcë.

Në mes të këtyre sokakëve mbytëse, ai duket se harron artin e tij verbues. Dhe kjo ndodh vërtet, sepse klaustrofobia dhe paniku topisin qelizat e tij. I vdekuri nuk është i bukur, kur e vajtojnë në krevatin e tij të vdekjes. Dhe zërat e tyre tronditin natën dhe nuk shoqërohen nga violina, piano apo flauti. Duhet theksuar fakti se poeti i drejtohet muzikës duke ndjekur dhe një orientim simbolik, misterin e natyrës, tejkalinimin e vdekjes, lumturinë erotike, bukurinë, melankolinë, gëzimin e jetës, *Engonopoulos* i shikon të bashkëjetojnë me muzikën dhe të shkëmbejnë me njëra – tjetrën thelbin e tyre. Si pjesë e ekzistencës së tij dhe njëkohësisht pjesë e pandashme e poezisë së tij, muzika e bren dhe e torturon poetin së brendshmi si një “violinë mishngrënëse”.

Për vrojtuesin surrealist krijohet një situatë paniku për shkak të vështrimit panikues të elbasanllinjve. Poeti duket se ka nostalgji për këtë ndjenjë, e cila parapërgatitet nga qetësia që mbretëron në zemrën e tij, kur këndon me vete një këngë fëmijërie. Ndoshta, nostalgjiku i vendeve të largëta, nuk mund të kujtojë asgjë tjetër

përveç Elbasanit, tmerrit dhe panikut që ai ndjell. Ndoshta ai ndjen dhimbje kur përshkruan qytetin me vegime surrealistë. Ai flet sikur ky qytet t’i ketë ngritur një kurth dhe t’i ketë thurur një intrigë.

*...Nuk kishte më asgjë të dyshimtë. Një tradhti e padëgjuar më parë po më mashtronte. Kuptova se kisha rënë viktimë e një kurthi të tmerrshëm dhe të turpshëm...Vërtet të jetë viktimë ky udhëtar i fatit? Në sokakët e Elbasanit, makthi pret rastin, vdekja dhe palëvizshmëria e saj janë në gatishmëri, kur njerëzit që nuk kanë sy, vazhdojnë ritualin e zakonshëm të shëtitjes së neveritshme. Banorët nuk vështrojnë, nuk nxjerrin tinguj, buzët e tyre nuk artikulojnë fjalë. Por *Engonopoulos*, diçka do të transmetojë nëpërmjet Elbasanit të vdekur. Vallë është keqardhje apo egoizëm artisti për të deformuar disi shkrimin e tij surrealist? Edhe nëse është formë halucinacioni, teknikë e akrobacive surrealistë të fatit, është e sigurt se dhe këto do të fshihen nga vetë paniku, duke e lënë formën bosh, si një enë të zbrazët që nuk mund të mbushet me shoqërimi heteroklite fjalësh. Atëherë, çfarë ndodh me shkrimin e tij? Kur paniku dhe kujtimi i tij nuk arrijnë të fshijnë këtë vegim lakuriqësie të Elbasanit në sokakët e tij, por pa dyshim vetëm ngjyrat e purpurta dhe tunikët e tij...*



“STACIONI”, DRAMË MBI ANKTHIN EKZISTENCIAL TË INTEGRIMIT

Rreth dramës **STACIONI**, Shkëlzen Halimi, (Konica, 2021, Shkup)

Arben ILIAZI

Një dramë që zbulon mirëfilli thellësinë e shtypjes që ushtron qytetërimi mbi njeriun. Konflikti dramatik zbulon rrënjët e përbashkëta të “palumturisë” së përgjithshme, e asaj neurotike, në një thellësi shumë më të thellë se çdo eksperiencë tjetër njerëzore. Dramaturgu e shpirtëzton lirinë si orientim i një qytetërimi drejt arritjes së lumturisë. Por në një pseudodemokraci, ajo konsiderohet një katastrofë dhe si fundi i çdo qytetërimi. Në këtë vepër lirinë dhe lumturinë reale i ndan një humnerë e madhe prej pseudolirisë dhe pseudolumturisë, që praktikohen në qytetërimin shtypës. Pikërisht nën dritën e kësaj kontradikte ngrihet konflikti dramatik në këtë vepër. Paradoksalisht gjumi, kur koha humbet pushtetin, mund të bëhet shenjë lirie. Ai nuk e kundërshton mundësinë e një çlirimi përfundimtar, ndaj pranohet si një sakrificë e madhe, si një fatalitet, si një element kapitullimi dhe nënshtrimi. Duke transformuar një fakt biologjik në esencë ontologjike, autori u jep personazheve bekimin e tij transcendent, duke nënkuptuar se faji i njerëzimit përsëritet falë kontributit të tyre, duke tradhtuar premtimin që i kanë bërë utopisë.

Në këtë situatë dramaturgu i rekomandon publikut të jetë vetvetja e për vetveten. Në vepër flitet për një shoqëri të “stacionuar”, që nuk kapërcehet dot historikisht, pasi “treni” i pritshëm i integritimit nuk vjen kurrë, pasi është i lidhur me idenë e ripushtimit të kohës. Jetojmë në një shoqëri që zien nga ankthi, rebelimi, impulset lipidike dhe rilindja anakronike e idealizmit, ku dalin në pah rrënjët dhe dinamika e instinkteve shoqërore. Demokracia nuk është një armë reale, nëse nuk shndërrohet në aksion historik. Sublimimi joshtypës nuk mund të imagjinohet, nëse



nuk çlirohet nga përmbajtja e shtypur e kujtesës, nëse nuk lirohet fuqia e saj çliruese.

“Stacioni” është një dramë absurdiste mbi eksplorimin filozofik të ankthit ekzistencial të integritimit, të cilën do t’ia rekomandoja çdo regjisor në teatrot shqiptare.

Ja pra, kemi drama kombëtare cilësore, që nuk kanë ndonjë një distancë të largët me ato botërore. Publiku ka nevojë të madhe për repertor skenik tonin. Atëherë si shpjegohet paradoksi i përbuzjes së dramës shqipe, problem që ngre, me të drejtë, edhe autori i kësaj vepre, Sh. Halimi, në një refleksion, botuar në profilin e tij.

SHPËTIMI NË ERRËSIRË



“Mos e vrit veten as këtë natë” është më shumë se një thirrje për mbijetesë; është një meditacion mbi vetminë, dhimbjen dhe fuqinë shpëtuese të fjalës. Rita Petro shndërron errësirën dhe pasiguritë e brendshme në material poetik, ku secili varg është një akt reflektimi dhe krijimi

Avni HALIMI

Poezia “Mos e vrit veten as këtë natë” e Rita Petro (Filipi) është një krijim që sfidon të zakonshmen, një mision artistik i rrallë në peizazhin e poezisë bashkëkohore shqiptare. Kjo poezi nuk është thjesht një lutje për të mbijetuar, por një hulumtim i thellë mbi kufijtë e shpirtit dhe vetmisë, mbi momentet e tensionuara kur ekzistenca duket se mund të shkatërrohet në heshtje.

Çdo varg është një rrjedhje intensive e vetëdijes, që rrjedh, siç thotë Xhojsi “nga përroi i ndërrijes”, ku subjektiviteti i poetit nuk qëndron në vetmi të izoluar, por lidh individualitetin me universin e përbashkët të përjetimeve të njerëzimit, ku dhimbja dhe dëshira për të mbijetuar ndërthuren në një ritëm të veçantë poetik.

Përmes figurave të forta dhe vizualiteve surreale, Rita Petro i jep trup dhe hapësirë

errësirës që çdo lexues e njeh si pjesë të përvojës njerëzore: "Ku e zeza dhe drita pikturojnë / Imazhet e tua surreale". Këtu nuk kemi thjesht një përshkrim vizual, por një meditim mbi tensionin midis jetës dhe vdekjes, realitetit dhe deliriumit, ku çdo ndjesi, qoftë ajo e dhimbjes, qeshjes apo mallit, merr peshë të barabartë dhe krijon një hapësirë ekzistenciale që është e përjetshme në përjetim. Truri, eksitimi, varësitë, gjithçka që duket e përkohshme ose e prishur, shndërrohet në një material krijues, në një substrat poetik nga i cili lind domethënia dhe shpëtimi i vetvetes.

Subjekti i kësaj poezie nuk është i ligësht, është vetëdija e brendshme që sfidon vdekjen dhe heshtjen, një aktor në botën e tij të trazuar, ku vetmia boheme bëhet më e fuqishme se çdo gënjeshtër, çdo pushtet i jashtëm, çdo makth që pret për të shkatërruar jetën. Kjo vetmi nuk është izolim i pafuqishëm, por hapësirë për t'u përballur me veten, për të kuptuar trupin, emocionet dhe mendimet e veta si një horizont të gjallë, një laborator ku shkatërrimi shndërrohet në krijim.

Poezia ndërthur realitetin banal, elementet e përditshme dhe detajet sensuale me metaforat ekzistenciale: saksit, klithmat e seksit, celularët, gotat me kokteje, gjithçka shërben si kontrapunkt për të shpërfaqur tensionin midis dëshirës për zhdukje dhe nevojës për të qëndruar. Këto detaje nuk janë triviale; ato bëhen simbol i jetës që vazhdon, edhe kur të gjitha mundësitë për t'u shuar duken reale, dhe tregojnë aftësinë e poetit të lidhë përjetimin personal me universin kolektiv të përjetimeve njerëzore.

Teksti nuk është vetëm thirrje për mbijetesë; ai është një dëshmi poetike e luftës për ekzistencë, ku poeti dhe lexuesi përballen me errësirën dhe gjejnë mënyra për ta përkthyer dhimbjen në krijim, mungesën e shpresës në akt të gjallë. Mes vargjeve, zgjedhjeve stilistike dhe ritmit, Rita Petro krijon një arkitekturë të brendshme të shpëtimit, një hapësirë ku ekzistenca dhe vetmia nuk janë kundërtënie, por bashkëveprim i domosdoshëm për të kuptuar jetën dhe për të ruajtur vetëdijen.

Në këtë kuptim, edhe përmes kësaj poezie monumentale të letërsisë bashkëkohore shqiptare Rita na shpërfaqet në një krijuese unike që sfidon çdo përvojë të zakonshme, një zë që ngrihet mbi banalitetin dhe dhimbjen për të treguar se edhe në errësirë ekziston mundësia e shpëtimit, dhe se vetmia e vetëdija janë burim i pafund krijimi dhe reflektimi. "Mos e vrit veten as këtë natë" nuk është thjesht një paralajmërim apo këshillë; është manifest poetik për jetën, një thirrje që

sfidon kufijtë e përditshmërisë dhe e ngre poezinë në nivel filozofik dhe humanist.

Rita Petro (Filipi)

MOS E VRIT VETEN AS KËTË NATË

Mos e vrit veten as këtë natë

Ti

Që çdo mesnatë e gjen shtëpinë

Zhytur në errësirë...

Ku e zeza dhe drita pikturojnë

Imazhet e tua surreale,

Lindur prej një truri të eksituar

Nikotine-alkoole-drogash...

Mos e vrit veten as këtë natë

Duaje vetminë tënde

Madhështore, të shurdhët,

Zhurme-tingujsh dhe aromë-masturbimesh

delirante.

Mos

Mos e vrit veten as këtë natë!

Vetmia jote boheme është më e mirë

Se gënjeshtër që mban në një krevat

burrin dhe gruan,

Se pagjumësia e "liderit" pervers

Që ëndërron të shembë çdo ditë

nga një ëndërr tonën,

Se makthi i atij që fle

Mbi dyshek parash erëndyrë,

Spërkatur me Pure White Cologne.

Prit!

Para se ta pish dhe pikën e fundit të helmit,

Dëgjoje qarjen e saksit që vjen nga lokali poshtë

Klithmën e mbytur të seksit

Pas murit në të majtë,

Drithmën e celularit dritëmekur,

Kur vizatohet një zemër në ekran.

Asnjëherë s'je vetëm o Ti mik,

Që kërkon të shpëtosh veten nga errësira!

Jam dhe Unë këtu.

Jemi të Tjerë aty-këtu

Që vrasim natën me një gotë kokteji,

Ku pikëllimi përzihet

Me pak ëndërr

Pak shpresë

Dhe pak gjak cherry.

Mos e vrit veten, as këtë natë!

PAZARI I SHPIRTRAVE



Është esenciale, sot, përbrenda globalizmit mitoman dhe revolucionit informativ, të përkufizohet imanenca objektive reale – shkolla, libri, leximi, dija, arti, specializimi, zbulimi shkencor – karshi fetishizimeve e silogjizmave të zbrazët

Nga Bujar MEHOLLI

Duket sikur deviza e sotme e jetesës në multiversitetin modern është shërbimi në vend të vlerës. Medoemos duhet t'i shërbesh dikujt, siç do të shkruante Bob Dylan-i. Dhe duke qenë se të gjithë janë shërbestarë të diçkaje, pak-kush ndalet e veneron më gjatë: a ia vlen ai shërbim? Çfarë vlere ka? Kush e përcakton vlerën kur vorbulli i madh teknokratik i shkrinë kufijtë e *demokratizon* gjithçka? Me hapjen enorme të shoqërisë, stadi më i lartë i globalizmit, informacioni është bërë simptomatik në varësinë ekzistenciale të entitetit, *natura naturans*. Mbingar-kesa e informacionit që ravijëzon itinerarin e intelektit njerëzor katapulton vlerën në kuptimin e pikasjes së vëmendjes dhe thellimit. Në konfliktin midis inteligjencës dhe inertes, shquhen instinktet (*mohaniya*) që e pengojnë zhvillimin e aftësive njerëzore duke e çuar refleksionin në zgrip të konvencionalitetit dhe përshtatjes obskure; ky s'është veçse inercion që plekset me fasadën e dukshmërisë prapa së cilës operojnë algoritmet, platformat merkantile e metrikat e *trendit*, makroantropusi i ekzistimit & vegjetimit në kushtet e shoqërisë së sotme është konsumerizmi sa më i madh dhe i pandërprerë duke absorbuar krejt

natyrshëm kundërthëniet paradoksale që ai pleks. Këto kundërthënie do t'i shpërfaqnim përmes përmbyesjes së *funksionalizimit strukturor* të sociologut amerikan Talcott Parsons i cili shoqërinë e shihte si organizëm biologjik ku institucionet e krijonin harmoninë. Në mënyrën se si funksionon shoqëria sot, do t'i përmendnim disa antinomi që *koekzistojnë* me njëra-tjetrën për ta privuar harmoninë. Duke jetuar në epokën e tepricës së dijes kemi padituri të theksuar, gati-gati tribale; duke qenë se kemi qasje krejt të lehtë në informacion, në libra, në udhëtime e liri veprimi, kemi përherë e më shumë theksim të paaftësisë së mendimit të pavarur, kritikës e prodhimit intelektual. Duke qenë se njeriu sot mund të jetojë i lumtur, në rehati e qetësi, ai përkundrazi, mendon si të shkatërrojë, si t'i përmbushë instinktet (shtazarake) dhe si ta dominojë tjetrin... tipare të përjetshme këto që nuk i ndryshon e rregullon as kompjuteri, as telefoni i mençur... lumturia, megjithatë, kurrë s'ka qenë më e paktë dhe më e largët, dhe ky *manifest lumturie* (siç do ta quante Stefano Bartolini) duket ka dështuar në efikasitetin e tij.

Këto antinomi të etabluara në indin e zhvillimit të hovshëm shoqëror globalist e shprishin funksionalitetin strukturor të Parsons-it, ngase

parakushtet e tij kryesore të mbijetesës shoqërore: përshtatja, qëllimi, integrimi dhe përfitimi i modelit pësojnë ndryshime drastike-kolosale. Qëllimi megjulohet ndjeshëm, spiritualiteti blihet në *paazar*. Tani homo-digitalis është i vetëburgosur në supermarketin e pafundmë të zgjedhjeve që ia determinojnë kualitetin (*guna*). S'është qenësore mbijetesë dhe integrimi ngase ai ka zgjidhje të pakufishme, është zot i botës me një klik; megjithatë duket i jetuar, ndodhur në hapësirën e paanë ku s'ka vullnet për asgjë më të lartë sesa përthithja e informacionit, konsumimi e përshtatja. Idealet bjerren. Lehtësirat e bëjnë të ndihet mirë dhe i integruar, ta shmangë atë që duhet ikur si djallit - vetminë. Ai nuk është kurrë i vetëm në zgjedhje e kënaqësi të shkurtra anipse steril në revoltë e shprishje të status-quo-së. Pse njeriu i sotëm bindet fare lehtë? Jo ngase detyrohet por i duhet ta mbysë vetminë, të merret parasysh e të vlerësohet; kjo e komprometon atributin e inteligjencës (*jiva* nga doktrina gjainiste) në manifestimin dhe njohjen e botës përmes një vizioni gjithëpërfshirës e vetëkrijues, autentik. Mu për këto arsye Ivan Illich-i e trumbetonte *deshkollimin e shoqërisë* ngase shkolla ka prirje të shndërrohet në prototip të burokratizmit e komformizmit duke e penguar dijen e vërtetë e cila, s'do mend, fitohet edhe pa kontrollin arbitrar dhe *përgatitjen* për tregun e punës që e aspiron shkolla si strumbullare e nënshtrimit konsumerist. Rëndon shkolla si promotore e konformizmit me përcaktimin e dijes përmes letrës së diplomës i meh aftësitë kritike të njeriut, dallimin e profanes nga e vërteta, ndërtimin e kuptimit dhe pavarësinë intelektuale-dijetare. Në sensin e konfliktit midis inteligjencës dhe inercionit po përmendim Vilfredo Pareton dhe teorinë e tij të rezidumeve dhe derivacioneve. Njeriu modern kërkon të shihet, të shquhet, të jetë në ballë të zhvillimeve; veprimet e tij impulsive, instinktive, Pareto i quan rezidume. Shpjegimet e veprimeve, justifikimet logjiko-morale i quan derivacione. Kur njeriu vepron, arsyeja e vërtetë pse nxitet ta bëjë aksh veprimin është rezidumi, kundrejt derivacionit që është, të themi, *tisi racional* i atij veprimi. Inteligjenca e shpirtit si dritë e pastër (*sadā-prakāśa*) cytet nga derivacionet të cilat i ravijëzojnë funksionimin *normal* në shoqëri përmes përshtatjes dhe ndjekjes së turmës. Studenti s'rreket për ta marrë diplomën pse beson thelbësisht te dija e përfutur sesa për të zotëruar status, siguri, prestigj, njohje e përkatësi. Pra, siç do të thoshte Ivan Illich-i, gatitet për ta pranuar apriori shërbimin në vend të vlerës. Këtu vimë të

problemi fundamental hajdegerian: ç'po ngjet me qenien tonë? A është sall kjo mënyra si e konceptojmë ekzistencën? A mendojmë se mendojmë apo se kështu mendohet? A zgjedhim lirshëm apo ndjekim zgjedhjet? A jetojmë prej vërteti apo shkrihem në *jetesën e modeluar* që qarkullon bri nesh?

Në një intervistë të viteve '60, Erich Fromm-i flet mbi shëndetin mendor, crucial për formimin e individit në një shoqëri që ndërtohet mbi klishe e mekanizma konformistë. Ja, përmbledhur, ç'thotë dr. Fromm-i: "Kultura jonë ofron shumësi mundësisish dhe rrugë *shpëtimi*; nëse njerëzit do të qëndronin veç tri ditë pa radio, pa pije alkoolike, pa cigare ose gjëra tjera kësajsoj... do të kishim njëqind mijë kriza nervore, por ja që kultura i ofron popullatës - nën emrin zulmëmadh të argëtimit - kënaqësinë e konsumit dhe kohës së lirë... këto s'janë veçse rrugë të arratisjes nga vetmia; shumë njerëz kështu e harrojnë veten, harrojnë se janë njerëz në një kuptim më të thelluar. Shëndetin mendor do ta përkufizoja si mirëqenie, diçka që sot haset mjaft rrallë; njerëzit shpesh e ngatërrojnë atë me mungesë sëmundjeje, por shëndeti mendor është të jetosh plotësisht me energji, interes e pasion për jetën dhe aftësi për dashuri, me qëndrimin vetëm kur është nevoja, me aftësinë për ta përjetuar si lumturinë ashtu dhe trishtin krejt natyrshëm."

Njeriu është tamam i shëndetshëm kur nuk është lehtë i adaptueshëm me masën, shoqërinë; përkundrazi, shëndeti i tij konsiston në forcën guximtare dhe në autenticitetin si entitet edhe kur krijohen stimujt shoqërorë të konformizmit dhe konsumit artificial, ndaj konstatimet e Erich Fromm-it janë universale dhe shtrihen në interval të gjatë kohor, përshtaten veçan në shoqërinë tonë konfuze e mjaft komplekse digjmoderniste. Ngase humbja e autenticitetit në një shoqëri tejet të hapur është trandës, jeta priret drejt *atyre* që monopolizojnë funksionimin dhe integrimin. Dhe pyetja mund të shtrohet: kur do të mund të fillohet të jetohej? Edhe sa? Kjo ta ndërmend vargun e famshëm të Pink Floyd *And then one day you find ten years have got behind you* si refleksion për diçka qenësore: kohën. Ajo rrëshqet pandërprerë... individi ngelet përbrenda derivacioneve, i ngujuar në trajektoren e gatitur, pa e gjetë veten dhe pa e jetuar tamam jetën/kohën e tij, por i përshtatur, i shkrirë në turmë, me superegon moraliste. Një alienim lucid e humbje soji të vetes në vorbullën masive, Pink Floyd e skalitë në këngën *Welcome to the Machine* së cilës mund t'i bëhet një interpretim ekzistencialist. Heidegger-i e kri-

tikonte modernizmin nga prizmi i ndikimit në venerimin e botës; njeriu modern futet në sistem, *Welcome my son, welcome to the machine*, krejt rëndom si tjerët para dhe pas tij; kjo është vërtetë diabolike sepse *hedhja* në botën moderne presupozon komprometimin e vetes në sajë të përshtatjes dhe vazhdimit të status-quo-së. *What did you dream? It's alright, we told you what to dream* thonë djemtë e Pink Floyd në prapavijë... ata sipër teje t'i tregojnë kushtet, normat, ti thjesht duhet t'i ndjekësh, t'u përshtatesh me mendimet e dëshirat tua. Sartre do të pyeste: tekefundit, pse e lejon veten të bëhesh pjesë e kësaj makinerie në vend se ta gjurmosh lirinë tënde?...

Gani Bobi në artikullin për kontekstin shprehës të vetëkulturës, te *modelet e shpëtimit*, e spikattë iluminizmin si periudhë ku njeriu bën përpjekje për të mos e humbur veten dhe për ta harmonizuar jetën; komfor këtyre objektivave, Bobi precizon tri koncepte kryesore: Modal, mënyrat e jetës për realizimin e individit. Intencional, pragmatizmi drejt fisnikërimit dhe çlirimit të njeriut. Postulativ, kultura sjell lirinë, lumturinë dhe shpëtimin e njeriut, një *summum bonum*, synuar përherë. Nga ky këndvështrim, implikimet teologjiko-religjioze janë krejt evidente, ato ravigjohet në emancipimin, shpresën dhe çlirimin si ideal i amshuar i gjinisë njerëzore. Por kritikë sociale, të Shkollës së Frankfurtit, si Horkheimer & Adorno, veçan, e panë transformimin shoqëror post-iluminist drejt një mjaftueshmërie akute post-religjioze. Shpresat e mëdha për një njerëzim ideal u mehën; u krijua njeriu-automat i gatshëm për t'u përshtatur, lehtë i kontrollueshëm brenda manovrave të ndryshme hierarkike - ndaj ata e panë iluminizmin si një uzdajë të shfytëruar

në indin e revolucionit radikal industrial. Në artikullin *Prodhimi ynë* Albin Kurti e vendos fokusin te konsumatori shqiptar dhe pozicioni i tij shoqëror, te njeriu që s'është në gjendje të prodhojë pse aparati shtetëror nuk rreket në krijimin e operimit prodhimtar progresiv, fokusohet krye kreje në atë konsumator-neoliberalist. Pjesa e fundit me të cilën Kurti e mbyll artikullin është veçanërisht domethënëse: "Qytetarët në Kosovë janë individë të ndarë e të përçarë për shkak se janë konsumatorë që nuk prodhojnë asgjë. Mungesa e prodhimit në përgjithësi është shkak i copëtimeve të trupit social të popullit tonë. Konsumi i ka individualizuar qytetarët duke e atomizuar shoqërinë. Secili konsumon për vete; në Kosovë qytetarët nuk janë më shumë sesa konsumatorë. Janë njerëz me gojë, ama disi pa duar..." Ky postulat e derivon kritikën substanciale të integritetit në shoqëri përmes proaktivitetit dhe prodhimtarisë, është në linjën e Ivan Illich-it që kërkon krijim të vetes, dije aktive përmes socializimit demokratik-pragmatist dhe jo të burokratizuar e kontrolluar. Siç pata shkruar në një ese: është esenciale, sot, përbrenda globalizmit mitoman dhe *revolucionit informativ*, të përkufizohet imanenca objektive reale - shkolla, libri, leximi, dija, arti, specializimi, zbulimi shkencor - karshi fetishizimeve e silogjizmave të zbrazët, *kulminativë*, plagjiatëve e imitacioneve të pafundmë që po mbijnë andej-kënde duke e shndërruar shoqërinë, përditë, në njëfarë sanatoriumi bizar (poshtë klepsidrës) që përmban varacione kurash hysterike për shpirtra pneumatikë... Në vend të shërbimit duhet rrekur në gjurmimin e vlerave, kjo është nevojë imediate e arealit tonë sociokulturor e politik.



Poezi/ Ndoc Gjetja



EJA TË IKIM NGA KJO BOTË LANETE!

Mjaft ndejtëm shtrirë këtu në bar!
Mjaft u puthëm e dhamë përkëdhelje!
Eja te hipim mbi atë re të bardhë
edhe të ikim nga kjo botë-lanete.

Do zbresim në planetin më të afërt
nuk prish punë pse je shtatzënë
atje do lindim dy binjakë
një djalë-yll e një vajzë-hënë.

Le të jetë planeti pa një frymor!
Të ketë veç ujëra, pyje, lëndina
Me puthjet tona do krijojmë
një popull të madh sa Kina.

KA HESHTJE...

Ka heshtje që na thonë gjëra të bukura,
si për shembull fytyra e gruas
në orët e vona të natës
kur e pagjumë numëron me vete
ditët e fundit të barrës.

Ec e thuaj po munde këtë heshtje
ti, muzikant, me nota
ti, piktor, me ngjyra
ti poet me vjersha
dhe ti, aktore e famshme
me gjeste dhe fjalë !

Për ta thënë duhet të jesh
nje grua shtatzënë
domethënë
dyfish e gjallë.

HEJZA

PLEQËRISHTE

Më në fund u plakëm grua,
siç e sheh dhe vetë
me thinja të bardha e rrudha
na mbushi kohë e sertë.

Dhe shëtitjet i rralluam
nëpër dhomë vijmë përquark,
dhe në vend të tyre shtuam
kollën dhe kafënë me pak.
Sa më ka marrë malli, grua
të zemërohem qoftë dhe kot,
si dikur atje tek udha
kur të shihja me një shok.

Ne kemi vite që pasqyrën
e përdorim shumë rrallë
se kemi sytë e njëri-tjetrit
fytyrat tona për t'i parë.

LUTJE

O Zot që fatet tona në dorë i mban!
Na ruaj nga shëndeti trashaman,
na ruaj nga orekset e SançoPançës,
na ruaj nga hija e rëndë e famës,
na ruaj nga faqeputhjet helmuese të Judës,
na ruaj nga orteku rrëmintar i turmës,
na ruaj nga prejardhja prej shimpanzesë,
na ruaj nga thyerja e timonit të kresë,
na ruaj nga putra pushtetore e Njëshit,
na ruaj nga engjëjt, na ruaj nga dreqërit,
na ruaj përditë nga ftohjet e miqësive,
na ruaj, o Zot, secilin prej të gjithëve!

KUR FILLOVA NGAPAK TË VDISJA

Kur fillova nga pak të vdisja
mbaj mend, ka qenë e enjte
vetëm ty pranë të kisha
rrije në këmbë dhe heshtje.


Në sytë e tu binte borë,
në fytyrë të fryu Veriu,
unë te brinjët vura dorën
ndjeva zemrën që mërdhiu.

Mbaj mend si e hape derën
si e tërhoqe pas dhe ike,
në palcë të ëndrrës ndjeva therrje
që më vonë m'u bë kronike.


Që ta marr pakëz veten,
vazhdimisht më sjellin njerëzit
reçel të ëmbël buzëqeshjesh
dhe ca pako me ngushëllime.

Përherë i lë në tryezë pa hapur
kompostot me lëng entuziazmi,
e nuk i prek me dorë fare
pjatat plot me optimizëm.

Ah, e humba krejt oreksin
nga ky virus shpirtëror i dhembjes,
me zor flas e me zor qeshi
më kot rri në tryezë të jetës.



Poezi / Raymond CARVER



TI NUK E DI SE Ç'ËSHTË DASHURIA

(Një mbrëmje me Charles Bukowskin)

Ti nuk e di se ç'është dashuria tha Bukowski
Jam 51 vjeç shikomë
Jam i dashuruar në këtë zogëz
E kam hëngër keq ama edhe asaj po i pëlqen
Paj çdo gjë është në rregull o njeri kështu edhe do
të duhej të ishte
Iu hyj në gjak dhe ato s'mund të më përzënë
Bëjnë çmos që të ikin prej meje
ama prapë se prapë më kthehen
Që të gjitha më kthehen përpos
njërës që e kam varrosur
kam qarë për të
ama qaja kollaj atyre ditëve
Mos më lejo të futem në gjëra të sërta o njeri
Se atëherë bëhem i keq
Do të mund rrija ulur këtu e të pija birra
me ju hipitë gjithë natën e lume
Do të mund të pija më shumë se dhjetë litra të
kësaj birre
Dhe s'ma lë shenjë bash sikur uji
Ama lërmë të futem në gjëra të sërta
Dhe do t'ia nis t'i hedh njerëzit nga dritarja
Do t'i hedh të gjithë nga dritarja
Këtë e kam bërë edhe më parë
Ama ti nuk e di se ç'është dashuria
Ti nuk e di ngase kurrë nuk
ke qenë i dashuruar është aq thjeshtë

E kam këtë zogëz e sheh është e bukur
Ajo më thërret Bukowski
Bukowski thotë ajo me zë të ulët
e unë i them Çka
Ama ti nuk e di se ç'është dashuria
Unë po të tregoj se ç'është
ama ti s'po dëgjon
Asnjëri prej jush në këtë sallë
*s'do të mund ta njihite dashurinë sikur ajo të
ngritej*
dhe t'ua fuste shqelm bythëve
kujtoja se të lexuarit e poezisë para publikut ishte
pretekst
Shiko unë jam 51 vjeç dhe e di këtë punë goxha
mirë
E di se ato gjëra bëhen sa për sy e faqe
ama i pata thënë vetes Bukowski
edhe të vdekurit urie është pretekst
Prandaj ja ku je dhe asgjë s'është si do të duhej të
ishte
ai shoku si e pat emrin Galway Kinnell
E kam parë fotografinë e tij në një magazinë
Kishte surrat të bukur
por ai është profesor
O zot a mund ta paramendosh
Ama edhe ti je profesor
Tash veç po të fyej
Jo nuk kam dëgjuar gjë për të
dhe as nga ai
Që të gjithë janë termitë
Ndoshta egoja e bën të veten dhe më nuk lexoj aq

ama këta njerëz që ndërtojnë
 reputacion mbi katër apo pesë libra
 janë termite
 Bukowski thotë ajo
 Përse dëgjon muzikë klasike gjithë ditën e lume
 A mund ta dëgjosh atë si e thotë këtë
**Bukowski përse dëgjon muzikë klasike gjithë
 ditën e lume**
 Kjo të befason apo jo
 Ty s'të shkon mendja se një bastard i pagdhendur
 bash si unë
 do të mund të dëgjonte muzikë klasike gjithë
 ditën e lume
 Brahmsin Rachmaninoffin Bartokun Telemanin
 Epo në pidh të s'amës s'do të mund të shkruaja
 gjë këtu lart
 Këtu është tepër qetë ka shumë drunj
 Mua më pëlqen qyteti është vend bash për mua
 E lëshoj muzikën klasike për çdo mëngjes
 dhe ulem pranë makinës sime të shkrimit
 E ndez një puro dhe e pi kësisoj a e sheh
 dhe them Bukowski ti je njeri fatbardhë
 Bukowski ke kaluar nëpër të gjitha
 dhe je njeri fatbardhë
 dhe tymi i kaltër noton nëpër tavolinë
 dhe shikoj nga dritarja në Delongpre Avenue
 dhe shoh njerëzit duke ecur poshtë lart trotuarit
 dhe pufoj puron kësisoj
 dhe pastaj e lë puron në shpuzore kësisoj
 dhe marr frymë thellë
 dhe zë të shkruaj
 Bukowski kjo është jetë se jo mahi them
 mirë është të jesh i varfër mirë është të kesh
 hemorroide
 mirë është të jesh i dashuruar
 Ama ti nuk e di se si është
 Ti nuk e di se si është të jesh i dashuruar
 Po të mund ta shihnit atë do ta kishit të qartë se
 për çfarë e kam fjalën
 Ajo kujtonte se do të vij këtu e do të çmendem
 Ajo bash mirë e dinte
 Ajo më tha se e dinte
 Mutsihane jam 51 vjeç e ajo sall 25 vjeç
 dhe ne jemi të dashuruar dhe ajo është xheloze
 O zot sa mirë është
 ajo tha se do të mi nxjerrë sytë po qe se vij këtu
 dhe çbendem
 Ja pra se ç'është dashuria për ty
 Çka di ndonjëri prej jush rreth kësaj pune
 Lërmëni t'ju them diç
 Kam takuar njerëz në burg që kishin më shumë
 stil
 se sa njerëzit që sillen nëpër kolegje
 dhe që ndjekin të lexuarit e poezisë para publikut
 Ata janë gjakpirës që vijnë të shohin

nëse çorapat e poetit janë të ndyra
 ose nëse i vie erë e keqe nën sqetulla
 Besomë nuk do t'i zhgënjej
 Ama dua që këtë ta mbash mend
 sonte është sall një poet në këtë sallë
 sonte është sall një poet në këtë qytet
 sonte ndoshta i vetmi has poet në këtë shtet
 jam bash unë
 Cili mes jush ka lidhje me jetën
 Cili mes jush ka lidhje me ndonjë gjë
Cili prej jush ka qenë i përzënë nga puna
 apo e ka rrahur gruan e vet
 apo ka qenë i rrahur nga gruaja e vet
 Më kanë përzënë pesë herë nga Sears dhe Roe-
 buck
 Më përzinin dhe pastaj sërish më pranenin
 Kam qenë magazinier tek ata kur isha 35 vjeç
 dhe pastaj më burgosën ngase vidhja biskota
 E di se si është kam qenë atje
 Tash jam 51 vjeç dhe jam i dashuruar
 Kjo zogëz thotë
 Bukowski
 e unë pyes Çka e ajo thotë
 Kujtoj se je rrenc i madh
 e unë i them shpirtkë ti më kupton
 Ajo është e vetmja krijesë në botë
 qoftë mashkull a femër
 që do t'ia duroja një gjë të tillë
 Ama ti nuk e di se ç'është dashuria
 Në fund të gjitha m'u kthyen
 secila prej tyre m'u kthye
 përveç asaj për të cilën të kam treguar
 atë të cilën e kam futur në dhe
 Së bashku ishim shtatë vjet
 Kishim zakon të pinim shumë
 Në këtë sallë po i shoh disa skribomana ama
 s'po e shoh asnjë poet
 nuk jam i befasuar
 Duhet të kesh qenë i dashuruar për të shkruar
 poezi
 dhe ti nuk e di se si është të jesh i dashuruar
 dhe ky është halli yt
 Më jep pak nga ajo gjë
 Bash njashtu pa akull për bukuri
 Shumë mirë bash ashtu më pëlqen
 Ta vazhdojmë këtë shfaqje në rrugë
 E di se çka kam thënë ama do ta pi sall një
 Që ka shije të mrekullueshme
 Ani de po shkojmë ta përfundojmë këtë lexim
 poezie
 Vetëm se mbasandaj mos të rrijë askush afër
 dritares së hapur

Përktheu: Fadil BAJRAJ

RËNIA E LIRË E MBRËMJES



Një ditë dikush më tha se ne jemi nga gjeografia e vendeve ku jetojmë dhe m'u desh të tundja kokën pa folur asnjë fjalë. Pastaj gjatë natës fryu një erë që shkundi hala pishash dhe gjithë ketrat erdhën të bujnë në shtëpinë time.

E zhytur në leximet e enciklopedisë së botës, unë s'munda t'ua uroja aspak mirëseardhjen dhe kjo ngjalli shumë keqkuptime. Ishte herë e parë që përballesh me një zemërim ketrash dhe akoma më keq me mbretin e tyre të vështirë. Ç'ishte vallë kjo zemëratë dhe për çfarë?

Atdheu i ketrave nënkupton portretin e një peme dhe statutin e mbretërimit të tyre. S'po të kërkoj të tundësh kokën, por të më shohësh në sy dhe kjo mund ta mbrojë nga rënia e lirë mbrëmjen time varur në skajin më të errët të syrit tënd.

LARGËSITË

Të kisha thënë çdo agim, unë dhe ky peizazh veshim bluzat e njeri-tjetrit. Sa herë që fryjnë erërat e jugut, pemët nisin të vallëzojnë ca tango

të çuditshme vjeshtore. Pylli i përrallave të Andersonit bëhet imi dhe miliona gjethe prej dielli bëhen fustani im. Atë çast Eva hyn brenda meje dhe rrugicat e pyllit mbushen plot me Adamë të përzënë nga parajsja. Pylli dhe nimfat shkojnë të pinë ujë liqeni dhe më marrin edhe mua me vete. Oh, vetëm të më shikosh, sa e bukur që bëhem. Por ti je larg, i përmalluari im i përhershëm. Je larg! Largësitë më rëndojnë si mall ndaj dhe të kam lënë të hapur përgjithmonë një derë përralle, ku mund të hysh...Mjafton të më sjellësh një fërshëllimë dhe një erashkë gjetesh nga thellësitë e asgjësë, aty ku je dëshirë!

TË VJEDHËSH NJË LIBËR

Më zuri dhe mua mallkimi i librit mbrëmë, ndërsa i vidhja vetes një të tillë të sapo shkruar dhe kisha nisur kapitullin e tretë të një libri tjetër.

Nisa të shihja në ëndërr faqe dhe vargje poezish kthyer përmbys; Sanço Panço dhe Don Kishotë të zemëruar që flisnin si në jerm dhe një Ana Kare-



ininë të plakur që mblidhte hirin e saj nga krematoriumi për të ribërë veten.

Dy murgj etruskë zunë të jepnin alarmin, duke iu rënë borive prej lëkurë shelgjesh. Klithte ajri dhe unë e mbushur gjithë mesjetë kërkoja veten me duar mes territ. Dhe më thanë: tashmë do mbetesh pa sy.

Një tabelë e vogël zu të vërtitej ballë meje dhe më pas s'më kujtohet asgjë, se me kishte kapluar gjumi. Isha bërë pjesë e mallkimit mesjetar dhe unë krejt pa dashje isha mbuluar me germa dhe vargjet tashmë ishin shndërruar në gjykatës dhe unë në një e pandehur. Të vjedhësh një libër, do të thotë të mbetesh pa bekimin e Zotit, thotë një nga nenet e mallkimit. Ndërsa unë që kam gllabëruar mijëra e mijëra libra në kujtesën time, do të thotë që kam mbetur vetëm me bekimin tënd. E po mirë shkrimtari im profet, më mjafton bekimi yt sepse sërish ndihem e mbrojtur nga një dashuri e madhe.

VARG MËNGJESI

Për çdo ditë ia afrohem brigjeve tua. Varka ime shket pa zhurmë, dalëngadalë. Nuk mund të më shohësh. Jam bërë e padukshme, siç janë bërë gjithë sirenat që janë krijuar me valë dhe me kostume të përmalltë. Të jap leje të më shikosh. Por, mos më fol asnjë fjalë se çasti vdes. E kaltra thërrmohet. Dhe tingujt e fjalës shndërrohen në xham. Unë jam dënuar në jetë të të strehoj brenda syve dhe të shndërrohem për ty në një varg poetik.

Do te vijë ai çast kur çdo rrugë të jetë mbyllur. Librat e shenjtë nuk e kanë parashikuar takimin tonë, pos hijeve që për çdo natë ia kanë frikën hapave të maces së zezë dhe shkundin nga ballkonet germa papirusesh në det. E sapo kthyer nga një vis i panjohur legjendash, hedh një bluzë prej algash në sup. Dhe thërras kamerierin, librat

dhe një varg. Unë ende s'ta kam thënë se janë një mëngjes shumë i mirë.

PORTAT E ËNDRRAVE TË VJETRA

Në çastin kur gishtat e lodhjes m'i mbyllin qepallat, duke më kthyer në një udhëtare gjumi, unë hyj në rrugicat e heshtura të pyllit të ëndrrave të takohem me të shkuarën, me vitet e pafajësisë dhe naivitetit tim, me sekretet intime që ne atëherë ia rrëfenim hënës, me imazhin tënd që më ngrinte në qiell dhe më pëshpëriste kaq fjalë të panjohura stinësh për puthjen e parë që ti ma dhe mbas një peme në ditën e festës së tokës.

Fëshfërinin kaq ëmbël degët e pemës dhe unë që drithërohesh me shume se ajo nga lumturia. Tre ditë me radhë kam vëzhguar në pasqyrë buzët me shpresë se bashkë me to mund të riktheja edhe njëherë magjinë e atij çasti. Tre ditë duke i folur lumturisë që e mbaja ngërthyer në gjoks me fjalë zogjsh.


Të kujtohet sa shumë jemi argëtuar atëherë vetvetja ime dhe sa herë kemi ndërtuar me fantazinë tonë një varkë prej resh si të Piter Panit për të përshkuar qiejt tanë të ëndërrimit ani se ato na mbyteshin gjatë rrugës nga gjylet e zemërimit të anijes së piratëve.

Ne përsëri buzëqeshnim dhe ishim kaq të lumtur. Dhe a e di psenë? Ne ishim arratisur nga moshja, duke refuzuar mendimet. Në fakt, mendimet janë thasë me rërë në balonat e fluturimeve të çdo kujt dhe ne ishim gatuar për të fluturuar. Ky është dhe shkaku që adresat tona janë si të zogjve pa adresë.

Në çastin kur gishtat e gjumit m'i mbyllin sytë, unë nis të hap portat e ëndrrave të vjetra dhe udhëtoj me to gjer kur bien boritë e mëngjesit. Pastaj bëhem përsëri kjo që jam, kjo që njihni ju prej kaq shekujsh.

PROFILE: HENRIK IBSEN

ANATOMISTI I SHPIRTIT NJERËZOR



Në pranverën e vitit 1906, në një Europë që po hynte me ankth në shekullin e trazimeve moderne, pushoi së rrahuri zemra e Henrik Ibsen. Ishe 23 maj, ai ishte 78 vjeç dhe prej kohësh ishte kthyer në një monument të gjallë të kulturës europiane...

Leonard VEIZI

Në rrugët e Oslos njerëzit e shikonin me një respekt pothuaj ceremonial: një burrë i heshtur, me cilindër të zi, mjekër të bardhë të prerë me kujdes dhe sy të ftohtë që dukeshin sikur depërtonin përtej fytyrës së bashkëbiseduesit. Dukej si një patriark i dramës moderne, por pas asaj pamjeje të ngrirë fshihej një shpërthyes

i madh idesh që kishte tronditur themelet morale të shoqërisë borgjeze europiane.

Për Ibsenin, skena nuk ishte vend zbatimje, por një sallë gjyqi, laborator psikologjik dhe pasqyrë sociale njëkohësisht. Ai i zhveshi personazhet nga heroizmi romantik dhe i futi në konfliktin brutal të jetës reale: martesat e kalbura nga gënjeshtria, pushteti shtypës i moralit publik, egoizmi i fshehur pas respektabilitetit dhe ankthi i indi-



vidit që kërkon lirinë. Në një epokë kur publiku ishte mësuar me melodrama dhe idealizime sentimentale, Ibseni solli heshtjet e rënda të familjes, krizën e ndërgjegjes dhe hipokrizinë e qytetërimit modern.

Ai u bë kështu "anatomisti" i shpirtit njerëzor. Nuk e interesonte vetëm ajo që personazhi thoshte, por ajo që fshihte. Drama e tij lëvizte në sipërfaqe, në tensionin e heshtur mes dëshirës dhe detyrimit, mes së vërtetës dhe maskës sociale. Në veprat e Ibsenit, shtëpia borgjeze - simbol i rendit dhe moralit - shfaqet shpesh si një burg elegant ku individi humbet identitetin.

Kjo filozofi dramatike shpërtheu fuqishëm në "Shtëpia e kukullës", vepra që shkaktoi skandal në gjithë Europën. Kur Nora Helmer mbyll derën pas vetes dhe braktis burrin e fëmijët për të kërkuar identitetin e saj si njeri, publiku i kohës e përjetoi si një akt tronditës rebelimi moral. Ajo derë që për-

plasat në fund të dramës u bë një nga tingujt më të famshëm në historinë e teatrit modern — tingulli i gruas që refuzon të jetojë si "kukull" brenda një bote patriarkale.

Ndërsa në "Heda Gabler", ai krijoi një nga figurat më komplekse femërore të dramaturgjisë botërore: një grua inteligjente, krenare, e burgosur nga monotonia dhe normat sociale, e cila shkatërron veten sepse nuk arrin të gjejë kuptim apo liri. Heda nuk është viktimitë klasike; ajo është një shpirt i copëtuar nga konflikti mes dëshirës për kontroll dhe boshllëkut ekzistencial.

Në "Armiku i popullit", Ibseni sulmoi drejtpërdrejt turmën, korrupsionin dhe manipulimin politik. Doktor Stokmn, që zbulon ndotjen e ujërave të qytetit dhe përfundon i izoluar nga opinioni publik, mbetet një nga figurat më aktuale të njeriut që ndëshkohet sepse thotë të vërtetën. Drama tingëllon ende moderne në një botë ku propaganda dhe interesi ekonomik shpesh mposhtin faktin.

Ndërsa "Perandori dhe galileasi" dëshmon ambicien e tij filozofike dhe historike: një reflektim monumental mbi pushtetin, besimin dhe përplasjen mes paganizmit e krishterimit në Perandorinë Romake. Ishte një vepër që vetë Ibseni e konsideronte ndër më të rëndësishmet e krijimtarisë së tij.


Por, madhështia e Ibsenit nuk qëndron vetëm te temat. Ajo që e bëri revolucionar ishte mënyra si ai e transformoi vetë strukturën e teatrit. Dialogët e tij nuk janë deklarata heroike; janë përplasje psikologjike. Konflikti nuk shpërthen vetëm në skenë - ai gërren nga brenda. Personazhet e Ibsenit jetojnë me sekrete, me turp, me kujtime që rikthehen si fantazma morale. Ai e ktheu dramën në analizë të ndërgjegjes njerëzore.

Pikërisht për këtë, ndikimi i tij u bë i jashtëzakonshëm. Nga Anton Chekhov te George Bernard Shaw, nga August Strindberg te Arthur Miller, breza të tërë dramaturgësh ndërtuan teatrin modern mbi themelet që hodhi Ibseni. Ai i dha skenës europiane një funksion të ri: jo vetëm të tregojë histori, por të sfidojë shoqërinë.

Pas William Shakespeare, ai mbetet dramaturgu më i interpretuar në teatrot e botës. Dhe kjo ndodh sepse dramati e tij nuk i përkasin vetëm shekullit XIX. Ato flasin ende për njeriun bashkëkohor: për vetminë, kompromisin moral, shtypjen sociale, nevojën për liri dhe frikën nga e vërteta. Në thelb, Ibseni nuk shkroi vetëm drama; ai hapi plagët e qytetërimit modern dhe i la ato të ekspozuara nën dritën e skenës.

NË SHIRITIN E KOHËS

TOMAS TRANSTRÖMER, POEZIA DHE PSIKOLOGJIA



Poeti dhe psikologu Tomas Tranströmer ka mbushur së fundmi 80 vjet dhe ka botuar librin "Poezi dhe prozë 1954-2004." Revista Psykologtidningen i kërkoi atij një poezi të preferuar për lexuesit e saj. Poezia që zgjodhi është "Galeria" dhe bën fjalë për jetën e Tomasit si psikolog, shpjegon bashkëshortja e tij, Monica Tranströmer

Eva Brita JARNEFORS

Vëmendja rreth ditëlindjes së Tomas Tranströmerit ka qenë e madhe. Kur telefonoj për të pyetur nëse redaksia e revistës *Psykologtidningen* mund të bëjë një intervistë me autorin,

gruaja e tij, Monica Tranströmer, më përgjigjet se kjo nuk është e mundur. Në pyetjen nëse Tomas Tranströmeri dëshiron t'u rekomandojë lexuesve të revistës sonë një poezi, ajo përgjigjet menjëherë: "Galeria".

-Do të flas me Tomasin, shton ajo dhe mbyll telefonin. Në sfond, një shkëmbim i shkurtër fjalësh, dhe Monica Tranströmer kthehet dhe konfirmon: Po, ai sugjeron poezinë "Galeria". Bën fjalë për jetën e Tomasi si psikolog. Ishte një poezi e vështirë për t'u shkruar. Tomasi u mor me të për gati dhjetë vite. Është e gjatë. E shkroi pikërisht në vitet 70-ta, kur ishte ende i punësuar si psikolog.

Poezia *Galeria* është përfshirë në përmbledhjen, *Barrierat e së vërtetës (1987)*. Kjo poezi është përfshirë edhe në librin "*Poezia dhe proza 1954-2004*". Lexoj poezinë. Rrëfimi poetik përqendrohet në një motel pranë autostradës E3 - një rrugë evropiane që në atë kohë kalonte përmes Lisbonës - Parisit - Fredrikshavnit - Gothenburgut - Stockholmit - Helsinforsit - Leningradit. Në dhomën e tij të motelit, ku ndihet era e një muzeu me koleksione maskash aziatike dhe dëgjohen zhurmat e autostradës, fillimisht poetit i shfaqen para sysh maskat, pastaj fytyrat, të cilat janë reale dhe "që shpojnë murin e bardhë të harresës". Një galeri ku shfaqen copëzat e fateve njerëzore. Janë njerëzit që Tranströmeri i ka takuar në punën e tij si psikolog dhe që i kujtohen në këtë vend të shkretë. Ata përpiqen të "marrin frymë", "të thonë diçka" dhe të cilët "i sheh duke luftuar". "Këtu është një trishtim që nuk e quan veten ashtu," përmbledh autori.

TOMAS TRANSTRÖMERI ishte psikolog klinik gjatë pjesës më të madhe të karrierës së tij profesionale. Pas përfundimit të studimeve universitare, ai u punësua në vitin 1957 në Departamentin Psikometrik të Universitetit të Stokholmit dhe në vitin 1960 në Burgun - Roxtuna në periferi të Linköpingut. Pesë vjet më vonë u punësua në Këshillin për Çështjet e Personelit dhe Jetës së Punës, Këshillin e AP, në Västerås dhe në vitin 1980 kaloi në Institutin e Tregut të Punës, Ami në Västerås. Qëndroi atje deri pak para Krishtlindjeve të vitit 1990 kur pësoi një goditje në tru.

Tomas Tranströmer ishte gjithashtu një psikolog-emergjent për zyrat e punës në qytetet Surahammar dhe Hallstahammar. Në atë kohë kishte presion të madh nga industrinë e zonës për të ndërmjetësuar rreth fuqisë punëtore. Në një intervistë të zhvilluar nga Inger Raune më 1998 për revistën *Psykologtidningen*, ai thotë:

-Por në këtë rast ata nuk mund të llogarisin tek ne. Shumica e rasteve që kemi janë pikërisht persona që vijnë nga sëmundje të gjata për shkak të lëndimeve të ndryshme dhe sfiliteve në punë. Ata nuk duan të kuptojnë se ne duhet të punojmë

me njerëzit në periudha afatgjate. Vetëm sasia është ajo që ka rëndësi në këtë botë të drejtuar nga statistikat. Cilësia nuk ekziston. Edhe nëse do të nxitonim me çështjet tona më shumë se sa bëjmë tani, kjo nuk do t'i ndihmonte agjencitë e punësimin. Në planin afatgjatë do të jetë e kundërta.

Detyrat e tij në Ami ishin të ndryshme dhe Tomas Tranströmeri bënte biseda profesionale në grup dhe individuale, megjithëse nga intervista del se ai preferonte bisedat individuale.

-Këtu ndihem mirë, si me detyrat e punës, ashtu edhe me kolegët, thotë ai në intervistë. Ekzistojnë të gjitha mundësitë për të përdorur të gjithë regjistrin e aftësive tua dhe për të marrë iniciativa vetanake.

Një psikolog shfaqet para nesh me përkushtim të madh ndaj punës dhe klientëve të tij. Në faqen e kulturës të *Aftonbladet*, kritiku letrar Magnus Ringgren, shkruan në prag ditëlindjes së 80-të të Tomas Tranströmerit se "ai nuk kishte pacientë". Një keqkuptim që ndoshta duhet vënë në dukje. Kjo më sjell një kujtim nga një festë në kopsht në vitet "70 në Vällingby. Një burrë që erdhi për vizitë dhe mori pjesë në festë, dhe që kishte dalë nga një varësi, më thotë me krenari: "Kam pasur një bisedë me Tomas Tranströmerin!"

Edhe gjatë viteve të punës në burgun e të rinjve në Roxtuna jashtë Linköpingut, Tomas Tranströmeri u mor me bisedat psikologjike. Roxtuna ishte një burg i ri për të rinjtë. "Krahas trajnimit praktik profesional dhe një rutine të disiplinuar të përditshme, çdo i burgosur ndiqte një program individual trajtimi dhe pikërisht këtu kërkohej puna e një psikologu," shkruan Staffan Bergsteni në një libër të sapo-botuar për Tomas Tranströmerin.

Staffan Bergsteni i referohet një deklaratë të vitit 1979 të shefit të Këshillit të Psikologëve në lidhje me kontributin e Tranströmerit. Aty tregohet për gjithanshmërinë e tij në punë, që konsistonte në diagnostikim, këshillim psikologjik, biseda mbështetëse, trajnime të mëtejshme të nëpunësve civilë, aktivitete këshilluese për autoritetet dhe kompanitë industriale, menaxhimin e përbashkët të institutit etj. Në libër është edhe një vizatim që ka bërë Tranströmeri, në të cilin interpreton me humor një takim në Ami (Institutin e Tregut të Punës).

Në përmbledhjen me poezi, *Tinguj dhe gjurmë (1966)*, Tomas Tranströmeri përshekruan kohën në Roxtuna në disa poezi; jetën, natyrën dhe situatën në punë. Ai shpjegon në një shkrim: "Për më tepër, besoj se angazhimi në profesion ndikon aq shumë në përvojën e përgjithshme të njeriut, saqë edhe

poezitë ndikohen prej tij". Ai përmend tre poezi që pasqyrojnë veçanërisht jetën në Roxtuna: *Muzikë e ngadalshme*, *Formulat e dimrit* dhe *Nën presion*. Në poezinë *Muzikë e ngadalshme*, Tranströmeri shkruan në strofën e parë:

*Ndërtesa e mbyllur
Dielli depërton nëpër xhamat e dritareve
dhe ngroh pjesën e sipërme të tavolinave
që janë mjaft të forta për të mbajtur
peshën e fateve njerëzore*

Për të pasur kohë me punën e tij letrare dhe aktivitetet e jashtme si lexime, intervista dhe kërkesa për deklarata, Tomas Tranströmeri aplikoi për një punë me gjysmë orari në Këshillin e AP-së dhe në të njëjtën kohë vazhdoi të mbante pjesërisht punën në Ami. Edhe atëherë ishte shumë i kërkuar, si në Suedi ashtu edhe jashtë shtetit. Për revistën *Psykologtidningen* të vitit 1989 ka thënë se ai shpesh ndihet "si një kamerier që ka shumë porosi në të njëjtën kohë".

POEZIA DHE PSIKOLOGJIA e gjejnë njëra-tjetrën një në shkrimet e Tranströmerit. Ai njihet si mjeshtër i imazheve poetike, krahasimeve dhe metaforave. Ëndrrat me mesazhe janë gjithashtu një element i rëndësishëm. Këto elemente janë të pranishme që në librin e tij debutues, *17 poezi* (1954), që në vargun e parë të poezisë hyrëse *Preludium*:

"ZGJIMI ËSHTË NJË KËRCIM ME PARASHUTË NGA ËNDRRA"

Shkrimtari Per Wästberg tregon në memoaret e tij për një vizitë në vitet 1960 të familjes Tranströmer në Roxtuna. Ai jep një portret të Tomas Tranströmerit si jashtëzakonisht të angazhuar në çështjet sociale dhe politikën e jashtme. Por, kur është fjala për poezinë, ai ishte i orientuar "më shumë për të shpjeguar botën se sa për ta ndryshonte atë", shkruan ai: "E vetmja polemikë e vlefshme - thoshte ai - është krijimi i veprave të mëdha artistike, në mënyrë që ato të mbesin në zemrat e njerëzve".

Per Wästbergu shkruan më tej: "Ai nuk kërkonte larg realitetit, por poshtë tij - sikur zhytësi që ekzaminon pjesën e poshtme të një anijeje. Ai na dha mundësinë të perceptojmë sinjalet e mëngjesit nga gjysma tjetër e shpirtit njerëzor."

Tomas Tranströmer ka treguar për revistën *Psykologtidningen* të vitit 1998 se ai mbanë gjithmonë një fletore me vete.



- Procesi i shkrimit është mjaft i gjatë për mua, thotë ai. Faza e parë janë shënime në librin tim të vogël të shënimeve. Aty shkruaj idetë dhe imazhet e brendshme që më shfaqen. Është një fluks i tërë. Në një fazë të mëvonshme, organizohem më shumë. Përpiqem të formuloj imazhet që kam krijuar më parë në mënyrë që t'i qartësoj ato më shumë. Pikërisht atëherë shqyrtoj gjithë materialin dhe e lexoj në mënyrë kritike.

NË PROZËN POETIKE "MINUS GRADË" të vëllimit poetik, *Barrierat e së vërtetës* (1978), ka imazhe nga puna e tij si psikolog në Västerås. Kjo poezi është botuar në revistë *Psykologtidningen* numër 24 më 1989. Tomas Tranströmeri thotë në një intervistë se poezia "flet për Suedinë". Në *Minus gradë* ai flet për një mjerim, i cili nuk do që të shfaqet, por që ekziston. Poeti lë të nënkuptohet se të gjithë njerëzit janë kontradiktorë, por me kushte shumë të ndryshme jetësore.

"Në fund festa heq maskën dhe shfaqet me fytyrën e sa të vërtetë, një kopsht ku ndërrohen grupet muzikore", shkruan ai dhe vazhdon: "Nuk duhet përmendur, por këtu ka shumë dhunë të ndrydhur. Prandaj detajet janë kaq të rënda". Klientët janë aty si "fytyra vezulluese". Ai u ofron atyre një fjalë biblike "që s' është shkruar kurrë". Dhe kjo tingëllon: "Eja tek unë, se jam po aq kundërthënëses njësoj si ti"

Megjithatë puna e Tranströmerit si psikolog pasqyrohet më së shumti në poezinë *Galeria*.

HEJZA

Kur telefonoj Monica Tranströmerin për të pyetur për të drejtat e botimit të poezisë, ajo thotë:

- E kemi diskutuar tashmë. Tomasi i ka të drejtat e botimit dhe dëshiron ta publikojë këtë poezi edhe këtu në revistën *Psykologtidningen*, si falënderim që u bë anëtar nderi i Shoqatës së Psikologëve (Psykologförbundet)

Në Kongresin e vitit 2004 Tomas Tranströmeri u zgjidh anëtar nderi i kësaj shoqate . A mund të më thoni pse iu deshën gati dhjetë vjet për të shkruar poezinë *Galeria*?

-Nuk ka asnjë poezi tjetër që i ka marrë atij kaq shumë kohë. Nuk mund të them pse, por ishte e vështirë ta shkruante , thotë ajo.

-A i shtron Tomasi kërkesa të mëdha vetes, pasi puna e tij i merr shumë kohë?

-Kërkesa të mëdha - po, deri në masën që krijimi të tingëllojë i vërtetë. Por, kjo nuk e ka penguar që të shkruajë edhe poezi të çastit.

Po botojmë kështu poezinë "Galeria", me sugjerim të autorit Tomas Tranströmer. Një falënderim i veçantë për redaktorët e revistës *Psykologtidningen*!

GALERIA

*Isha shtrirë në një motel përballë rrugës E3.
Në dhomën time vinte një aromë që e kisha
ndjerë më parë
nëpër koleksionet e muzeve aziatike:*

maska tibetiane japoneze në një mur të ndriçuar.

Por tani nuk janë maska por fytyra

*që shfaqen përmes murit të bardhë të harresës
për të marrë frymë, për të pyetur për diçka.
Unë rri zgjuar dhe i shoh tek shfaqen ,
zhduken dhe rishfaqen.*

*Disa huazojnë tipare të njëri-tjetrit, ndërrojnë
fytyrat
thellë në mua
ku harresa dhe kujtesa bëjnë pazaret e tyre.*

*Shfaqen përmes ripikturimit të harresës
murit të bardhë
zhduken dhe rishfaqen.*

Këtu ka një dhembje që nuk emërtohet si e tillë.

*Mirë se vjen në galerinë autentike!
Mirë se vjen në galerat autentike!*

Grilat autentikë!

*Djaloshi i karatesë që goditi një njeri qengj
ëndërron akoma për fitore të shpejta.*

*Kjo grua blenë dhe vetëm blenë gjëra
për t' i hedhur në hendekun e boshllëkut
që e ndjek pas në fshehtësi.*

*Zotëriu X nuk guxon ta lë dhomën.
Një gardh i errët njerëzish të gjithanshëm
qëndrojnë midis tij
dhe horizontit që vazhdimisht largohet .*

*Ajo që dikur kishte ikur nga Karela
ajo që mund të qeshte...
tani shfaqet
por memece, e ngurtësuar, një statujë nga
Sumeri.*

*Sikur atëherë kur isha dhjetë vjeç dhe kthehesha
vonë në shtëpi.*

*Shkallëve lartë fikej drita
por ashensori ku qëndroja ndriçonte, dhe
ashensori ngrihej
si ora e dorës e një zhytësi nëpër thellësinë e zezë
kat pas kati derisa mirazhi i fytyrave
i shtynte drejt kangjeleve...*

*Por tani nuk janë mirazhe fytyrash por janë
fytyra reale.*

Unë kam shtrirë gjymtyrët si një udhëkryq.

*Shumë veta dalin nga ëndrra e bardhë.
Ne prekëm njëri-tjetrin një herë, vërtetë!*

*Një korridor i gjatë i ndritshëm që i vjen era fenol.
Karroca. Vajza adoleshente
që mëson të flasë pas aksidentit.*

*Ai që përpiqej të thërras nën ujë
dhe sasia e ftohtë e botës që depërtonte brenda
në gojë dhe hundë.*

*Zëra nga mikrofonat thanë: Shpejtësia është
pushtet
shpejtësia është pushtet!
Luaje lojën, the show must go on!*

*Në karrierë ne lëvizim ngathët hap pas hapi
sikur në një no-lojë
me maska, me buçitje kënge: Unë, jam Unë!*

Ajo që u mposht
nga një batanije e mbledhur.

Një piktor tha: Dikur isha një planet
me një atmosferë timen.
Rrezet nga jashtë thyheshin në ylbere.
Shira të vazhdueshëm binin mbi të, mbi të

Tani jam i shuar, i thatë dhe i hapur.
Tani më mungon energjia fëmijërore.
Unë kam një anë të nxehtë dhe një anë të ftohtë.

Pa ylbere.

Unë isha shtrirë në shtëpinë e ndjeshme.
Shumë veta donin të hynin brenda përmes
mureve
por shumica nuk arrinin deri aty:

ata mbivotohen nga kumbimi i bardhë i harresës.

Kënga anonime vërshon mureve.
Trokitje të ndrojtura që nuk duan të dëgjojnë
psherëtima të gjata
replikat e mia të vjetra pastrehë që tkurren.

Dëgjoj vetëqortimet mekanike të shoqërisë
zërin e freskores së madhe
era artificiale korridoreve të zgafelleve
gjashtëqind metra poshtë.

Sytë tanë rrinë hapur nën banderolë.

Të paktën të mund t'i bëja ata ta ndjejnë
që kjo lëkundje përfundi nesh
do të thotë që ne jemi mbi një urë...

Më duhet të qëndroj shpesh pa lëvizur.
Jam ndihmësi i gjuajtësit me thikë në cirk!
Pyetjet që kam hedhur me zemërim
më kthehen triumfuese

nuk qëllonjë por gozhdohen në siluetën time
në vija të trasha
qëndrojnë edhe kur unë largohem nga aty.

Në të shumtën më duhet të hesht. Vullnetshëm!
Sepse "fjala e fundit" thuhet vazhdimisht.
Sepse mirëdita dhe mirupafshim...
Sepse një ditë si sot është e ...

Sepse margjinat më në fund
dalin nga shtrati i tyre



dhe vërshojnë tekstin.

Unë qëndroja shtrirë në hotelin e somnambulëve.
Shumë fytyra këtu janë të zhgënjyera
të tjerat të zbutura,
të gjitha duan të arrijnë ikonën e drejtësisë.

Ata frymojnë zhduken përpiqen të kthehen
Më shikojnë kalimthi
të gjithë duan të arrijnë tek ikona e drejtësisë.

Ngjanë, por rrallë
që ndonjëri nga ne vërtetë ta shoh atë tjetrin:

në një çast njeriu shfaqet
si një fotografi por më e qartë
dhe në sfond
diç më e madhe se hija e tij.

Ai qëndron si një figurë e plotë përballë një
shkëmbi.

Është më tepër një guaskë kërmilli sesa një
shkëmb.

Është më tepër një shtëpi sesa një guaskë
kërmilli.

Nuk është shtëpi por ka shumë dhoma.

Është e paqartë por mahnitëse.

Ai rritet nga kjo, dhe anasjelltas.

Është jeta e tij, është labirinti i tij.

(Artikull i revistës psikologjike
Psikologitidningen, 2011)

Përktheu: Qerim RAQI

NUMRI I ARDHSHEM ME 30 QERSHOR

HEJZA

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Rruga e Kaçanikut nr.208, Shkup, 1000